

SUPLEMENTI "RILINDASI" ► Page 13-20



Poema e fundit e Perikli Jorgonit para aksidentit

Elida: E shkroi për Llukë Kaçajn, Kujtimet e Roland Gjözës dhe të Suzana Varvaricës

ZGJEDHJET 2013

Durrës, gati lista e kandidatëve të PD

Vijnë Oldashi, Pollo, Gorreja, Xhaferaj dhe Halimi. Sondazhi: Fiton PS-ja

■■■ DURRES

ARTUR KORRIKU

Ndonëse ende jo zyrtare, në mjediset politike në Durrës kanë nisur të artikulojnë emrat e parë të kandidatëve për deputetë që do të përbëjnë listën e mazhorancës në Durrës. Në listën ende të pa shpallur...

► Page 4-5



PA RRUGE DHE UJE

Selitë, banorët: Do të protestojmë sërish për dritat

Lagjia periferike e Tiranës në varfëri ekstreme: Bukë me listë

► Page 9



LISTA E VIZITAVE/ Axhenda ajrore e kryetares së Kuvendit në 2012

SHETITJET E TOPALLIT RRETH BOTES PER 12 HERE

Rreth një muaj në aeroporte, avionë dhe hotele për numrin dy të shtetit. Rekord në muajin shkurt: 11 ditë vizita në Athinë, Abu Dabi, Xhakarta, Stamboll, Berlin, Bejrut. Shpenzimet sa për 10 vite

Lajmi

Gjatë vitit që lamë pas kryeparlamentarja Jozefina Topalli qëndroi plot 26 ditë jashtë tokës Shqiptare, duke realizuar takime në 12 shtete të ndryshme të botës. Intenerari i udhëtimeve fillon nga Indonezia, Japonia e përfundon në muajin dhjetor në Francë.

■■■ TIRANE

ARTEMISA HOXHA

2012-ta duket se ishte një vit plot angazhime, takime jashtë vendit për kryeparlamentaren Jozefina Topalli lidhur me postin që mban si drejtuese e Parlamentit në Republikën e Shqipërisë, por dhe si pjesë e...

► vijon në faqe 2-3



NË FOTO: Jozefina Topalli gjatë vizitës në Indonezi

Koment



NGA AFRIM KRASNIQI

Shqipëria, BE e 23 qershori

Më 11 dhjetor cdo politikan i Tiranës, përfshirë kryeministrin, ishte në dijeni të vendimit të Ministrave të Jashtëm të BE-së për refuzimin e kërkesës së Shqipërisë për hapjen e bisedimeve të statutit kandidat. Vendimi u paralajmërua në tetor kur palët kryesore politike, PD dhe PS, refuzuan bashkëpunimin politik dhe realizimin e disa kriterëve paraprake "të vullnetit të mirë". Prej asaj dite dhe deri në dhjetor palët ecën në drejtim paralel, pa bërë asnjë hap afrimi në qëndrimet e tyre. PS shpalli kushtin e cështjes së Fierit, PD refuzoi plotësimin e këtij kushti. Gjithcka tjetër ishte retorikë dhe propagandë në përgatitje të opinionit public për vendimin e pritshëm negativ. Me në fund, Shqipëria humbi një shans tjetër afrimi me BE, i dyti brenda tre muajve të fundit dhe i pesti në tre vite të fundit.

Më 11 dhjetor PD e kishte gati fjalimin: përgjegjëse është opozita. Do të rrezojmë murin e izolimit, siç rrezuam atë të korrupsionit, -tha ajo. PS gjithashtu e kishte gati fjalimin:...

► vijon në faqe 22

SOKOL KOÇIU

► Page 8

"Ju rrëfej dhunën e policëve xhelatë të komisariatit 3"

ARRESTIMI

► Page 7

Rryshfeti 20 mijë lekë pranga pedagogut sekser

SHBA

► Page 21

Masakra, Vanesa: Policia na tha të mbyllim sytë

80 VJETORI

► Page 10-11

TINKA KURTI: PUTHJA ME NAIM FRASHËRIN

Flasin Xhepa, Ljarja, Vërria dhe çifti Agolli



NERANXI
... gjithmonë një hap përpara...
Shurupë për kokteile dhe likerëra për bare dhe restorante
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 7, Yrëhek Tiranë; Tel: 042 406 500; 042 406 501; Fax: 042 406 502; e-mail: neranxi@neranxi.com; www.neranxi.com



"Peligrinazhi"

■ ■ ■ TIRANE

ARTEMISA HOXHA

vijon nga faqja 1

VIZITAT Muaj shkurt ishte dhe muaji, ku kryeparlamentarja qëndroi vetëm 4 ditë në tokën shqiptare, pasi pjesën tjetër e kaloi me vizita jashtë Shqipërisë.

KOHËZGJATJA Vizitat që kanë zgjatur më shumë ditë janë pikërisht në Liban, Indonezi me katër ditë dhe më pas vizita tre ditore në Gjermani.

Viti 2012, Topalli i bie rreth botës për 26 ditë

Udhëtime në 12 shtete, nga Indonezia në Japoni e deri në Francë



Jozefina Topalli në Indonezi

Lobimi

Një nga qëllimet e udhëtimit jashtë vendit, përveç faktit të forcimit të bashkëpunimit të Shqipërisë me vendet e tjera, ishte dhe lobimi nga ana e Topallit për njohjen e pavarësisë së Kosovës.

Precedenti 2008

PS: Topalli "mbretëresha e ajrit"

... motos së saj për një diplomaci parlamentare. Plot 26 ditë udhëtime jashtë vendit kanë shërbyer për kryeparlamentaren Topalli për takime të shumta me qëllimin e përfqësimit të vendit tonë në organizata të ndryshme, forcimin e bashkëpunimit ekonomik, por jo vetëm, si dhe për njohjen e Kosovës si shtet i pavarur nga vendet që ende nuk e kanë realizuar një proces të tillë. Për gjithë këto ditë jashtë Shqipërisë, nuk ekziston një faturë financiare se sa kushton qëndrimi i kryeparlamentares Topalli dhe stafit të saj në këto udhëtime të stërgjatura që ajo ka bërë dhe bën jashtë vendit. Nga gjithë axhenda e saj që pati për vitin që po lëmë pas, rezultoi se shkurti ishte dhe muaji, ku kryeparlamentarja qëndroi vetëm 4 ditë në tokën shqiptare, pasi pjesën tjetër e kaloi me vizita jashtë Shqipërisë. Brenda 11 ditëve nga muaji shkurt, Topalli pati për itinerar këtë linjë ajrore: Tiranë-Athinë-Abu Dabi-Xhakarta-Stamboll-Tiranë-Berlin-Tiranë-Stamboll-Bejrut. Mungesa e madhe e kryetares së Parlamentit, në muajin shkurt në vendin tonë u denoncua edhe nga ana e Partisë Socialiste, si një neglizhencë e madhe që po bëhej situatës së vështirë ekonomike dhe varfërisë që kishte mbërthyer shumë njerëz në komunat e thella malore për shkak dhe kushteve të këqija të motit. Për vitin që lamë pas, Topalli vizitoi me misionin si kryeparlamentare plot 12 shtete në tërësi globin, ku përfqësoi Shqipërinë si dhe lloboi për njohjen e pavarësisë së Kosovës. Ndërkohë që vizitat që kanë zgjatur më shumë ditë janë pikërisht ato të realizuara në Liban, Indonezi me nga katër ditë dhe më pas vizita tre ditore në Gjermani. Por përveç këtyre tre shteteve, përmenden dhe shtetet e tjera, ku Topalli është ndalur gjatë vitit që po kalon. Bëhet fjalë për vizitat e realizuara nga kreu i Kuvendit në Maqedoni, Japoni, Slloveni, Monako, Francë, Austri, Strasburg, Kosovë etj.

1-4 SHKURT NË INDONEZI

Turi i udhëtimit për kryeparlamentaren Topalli nisi më datë 1 shkurt të vitit që po lëmë pas, me një vizitë katër ditore në Indonezi, e para vizitë kjo e një politikani të lartë nga Shqipëria. Në këtë vizitë Topalli promovoi Shqipërinë si dhe lloboi për njohjen e shtetit të ri të Kosovës. Në këtë vizitë, e cila ishte me ftesë të homologut indonezian, Topalli qëndroi plotësisht 4 ditë, ku pati axhendë të gjerë takimesh me drejtues të lartë të Indonezisë. Kryetarja e Kuvendit, Topalli shfrytëzoi vizitën e saj në Indonezi për t'u takuar me Kryetarin e Parlamentit të Arabisë Saudite, i cili pak kohë më parë bëri një vizitë në Shqipëri, si dhe Kryetarin e Parlamentit të Emirateve të Bashkuara Arabe. Ajo zhvilloi një takim me Kryetaren e Parlamentit të Pakistanit, një mike e kahershme e saj. Takime të veçanta, Topalli bëri dhe

me Kryetarin e Asamblesë së Turqisë, Xhemil Çiçek, i cili i tha zonjës Topalli se e pret atë si një mike e Turqisë. Po ashtu, Kryetarja e Kuvendit pati një takim me kryetarin e Parlamentit të Katarit, i cili pranoi me kënaqësi ftesën për të ardhur në Tiranë, jo vetëm në interes të shkëmbimeve parlamentare, por edhe me synimin për të ekspluar mundësitë për të pasur një prezencë më të madhe të biznesit dhe investitorëve të Fondit Financiar të Katarit në Shqipëri. Të gjitha takimet janë zhvilluar në kuadër të takimit të vendeve anëtare të Konferencës Islamike që mbahej në Xhakarta. Ku u kërku bashkëpunim me vendeve anëtare dhe njohja e shtetit të ri të Kosovës nga ana e qeverive të këtyre vendeve.

8-10 SHKURT 2012, NË GJERMANI

Mjaftuan vetëm 7 ditë në Shqipëri, që kryeparlamentarja të nisej për një udhëtim 3 ditor në Gjermani. Më 8 shkurt kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë Jozefina Topalli, e ftuar në Fondacionin Konrad Adenauer, promovon Shqipërinë dhe fton biznesin gjerman të rrisë investimet e tij në Shqipëri. Ky udhëtim erdhi pas ftesës nga Kryetari i Bundestagut gjerman Norbert Lamert. Gjatë kësaj vizite tre ditore, Topalli u takua edhe ministrin e shtetit të Gjermanisë, Cornelia Pieper si dhe me anëtarët e komisionit për çështjet e BE-së dhe të komisionit të ekono-

misë në Bundestagun gjerman. Ndërkohë që në 9 shkurt ajo realizoi takime me përfqësues të bordit drejtues të Dhomës Gjermane të Tregtisë, ku ftoi investorët gjermanë të investojnë në vendin tonë. Po në këtë datë, Topalli u takua me kryetarin e Parlamentit të Landit të Berlinit, Ralf VVieland.

12-15, NË LIBAN

Vetëm pas katër ditësh nga përfundimi i vizitës së punës në Gjermani, Topalli nisën në datën 13 shkurt për vizitë 4 ditore në Liban, ku u takua me krerë më të lartë drejtues të këtij shteti. Në takimin me kryetarin e Parlamentit të Libanit, Nabih Berri, dy homologët folën për

marrëdhënie më të afërta mes dy parlamenteve, përmes shkëmbimit të vizitave me delegacionesh parlamentare e deputetësh, si për për shmangien e taksimit të dyfishtë, për transportin ajror e detar, për Mbrojtjen dhe Nxitjen e Investimeve, etj. Në vizitën e parë e këtij niveli të lartë politik në këto 20 vite, Topalli gjatë takimit me Presidentin e Libanit, Michel Sleiman, kërkoi njohjen e pavarësisë së Kosovës.

4-5 PRILL NË MAQEDONI

Vetëm pas pak ditësh kryeparlamentarja Topalli do të nisej për një vizitë pune në Maqedoni, ku mori dhe titullin "Qytetare Nderi" në Komunën e Çairit. Pas shumë takimesh, ajo mbajti një fjalim të gjatë në Parlamentin e Maqedonisë, ku kryefjala ishte reforma, bashkëpunimi, integrimi mes dy vendeve. Ditën e dytë të vizitës së saj në Maqedoni, Topalli takoi Kryeministrin Nikola Grujevski, ku shprehu mbështetjen e vendit tonë në anëtarësimin e Maqedonisë në NATO. Ndërkohë që në datën 5 prill kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli takoi edhe Presidentin e Maqedonisë, George Ivanov, ku folën për një angazhim të përbashkët për një rajon, pjesë të familjes evropiane.


17-18 PRILL, JAPONI

Pas 12 ditësh nga vizita në Maqedoni, pikërisht në 17 prill, Topalli nisën për një tjetër vizitë pune jashtë Shqipërisë, drejt Japonisë. Në ditën e parë të vizitës disa ditore, Topalli u takua me Zv/guvernatorin e Prefekturës së Miagit, Masahiro VVako dhe Kryetaren e Bashkisë së Sendait, Emiko Okujama, ku shprehu interesin për shkëmbime vizitash mes dy vendeve, si në nivelin politik, atë parlamentar, biznes-



Precedenti

Në vitin 2008, në një përlogaritje të saj përpara i përket udhëtimit të saj përpara nga Topalli, PS do ta konsideronte atë si "mbretëresha e ajrit" me një axhendë të shpartalluar udhëtimesh jashtë Shqipërisë.



Itinerari i udhëtimeve të kryeparlamentares Jozefina Topalli gjatë vitit 2012

Delegacioni

Kryeparlamentarja Topalli gjatë vizitave jashtë Shqipërisë është shoqëruar nga një delegacion, për të cilët nuk ka një faturë të caktuar financiare për të gjitha shpenzimet.

in etj. Në ditën e dytë të vizitës, në 18 prill kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli takoi Zv/Ministrin Parlamentar të MPJ së Japonisë, Takujiro Hamada. Po këtë ditë, kryeparlamentarja pritet në takim nga Kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, Takahiro Yokomichi.

8-9 MAJ, SLOVENI

Në datën 8 maj, Topalli nisët për një vizitë dyditore në Slloveni, ku pritet nga Kryetari i Parlamentit, Gregor Virant. Kryeparlamentarja arriti që të marrë mbështetjen e Sllovenisë për mbështetjen në integrimin në Bashkimin Europian. Në datën 9 maj, Jozefina Topalli takohet me Presidentin e Sllovenisë, Danilo Turk, nga ku kreu më i lartë i shtetit të Sllovenisë e konsideroi Shqipërinë, një kandidatë kredibile për zhvillim ekonomik pozitiv. Ndërkohë që në po të njëjtën ditë Topalli takohet dhe me kryeministrin e Sllovenisë, Janez Jansa, ku diskutuan për progresin e Shqipërisë për në BE. Më datë 5 korrik kryeparlamentarja Topalli merr pjesë në Sesionin e 21-të të përvitshëm të Asamblesë parlamentare të OSBE në Monako, me temë "OSBE: Rajoni në ndryshim", nga ku mori dhe ftesën për organizimin e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së në Tiranë.

25-26 GUSHT AUSTRI

Pas më shumë se një muaj, kryeparlamentarja Topalli nisët më datën 25 gusht të vitit që po lëmë pas, në Austri, një vizitë kjo dy ditore ku u takua me 8 gratë kryetare

të Paramenteve në Europë të mbledhura në qytetin e Vjenës. Presidenti Fisher, si një nga personalitetet që ka vizituar Shqipërinë, që në momentet e para të demokracisë në Shqipëri, në postin e Kryetarit të Parlamentit Austriak, i bëri të ditur Kryetares Jozefina Topalli se i ndjek me vëmendje zhvillimet në Shqipëri, si dhe vuri në dukje progresin pozitiv të vendit tonë.

20-21 SHTATOR STRASBURG

Më 20 shtator kryeparlamentarja jonë udhëton drejt Strasburgut,

NEPOTIZMI I TOPALLIT

Dhëndërri i Jozefinës u emërua atashe në Francë, përvojë vetëm si këngëtar



Luiz Ejlli dhe vajza e Jozefina Topalli

Jashtme në Tiranë dhe sot e kësaj dite nuk e konfirmon nëse këngëtar shkodran Luiz Ejlli ka bërë ndonjë konkurs, apo ka konkurruar sipas rregullave të Komisionit të Shërbimit Civil. I ri, i papërvojë

në diplomaci, edhe CV-në e vetme të tij si këngëtar e ka të sfumuar tani si dhëndër i kryetares së parlamentit. Madje thuhet nën zë se dhe për të emërimi ka qënë i papritur, teksa e kanë

lajmëruar kur ishte duke kënduar live në një nga lokalet në periferi të kryeqendrës së veriut. Reagimet rreth emërimit të tij kanë të shumta, madje thuhet se dhe në Ministrinë e Jashtme ka pasur një farë hezitimi, por Meta asokohe ministër ka vendosur gjithçka e i ka lënë vetëm formalitetet Haxhinastosi që e pasoi. Ndërkohë që Topalli është zëri më i ashpër në Kuvend kundër opozitës që akuzojnë për lidhjet nepotike dhe ndoshta do t'i duhet t'i bëjë avokatit emërimit të dhëndrit të saj si diplomat pa përvojë në Paris, në një kryeqytet shumë delikat sa i përket cilësisë dhe përvojës që duhet të ketë trupi diplomatik.

nga ku u prit nga Presidenti i Asamblesë së Këshillit të Europës, Jean-Claude Mignon. Në këtë vizitë të veçantë për përfaqësimin e vendit tonë në arenën ndërkombëtare, Jozefina Topalli çeli punimet e Konferencës së Strasburgut, ku u hap në të njëjtën kohë dhe ekspozita mbi Shqipërinë, kjo në kuadër të 100 vjetorit të shpalljes së pavarësisë. Në datën 21 shtator Topalli realizoi në Strasburg disa takime të tjera, të rëndësishme për mbështetjen e Shqipërisë në BE. Në shumë takime intensive me Kryetarët e Paramenteve të vendeve të KIE, Topalli lloboi për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Kryetarja e Kuvendit njohu homologët e saj me zhvillimet politike dhe ekonomike në Shqipëri.

"Deri në fund të muajit dhjetor, nuk dihet nëse në axhendën e kryeparlamentares është përfshirë ndonjë udhëtim jashtë vendit"

Diplomacia

Mijëra milje të përshkuara nga Topalli gjatë 2012-tës kanë shërbyer dhe për zgjerimin e eksperiencës së saj në fushën diplomatike. Të gjitha takimet si kryeparlamentare do t'i shërbejnë diplomacisë.

4 TETOR, KOSOVË

Fillimi i muajit tetor e gjeti kryeparlamentaren Jozefina Topalli, në Kosovë, e ftuar mes grave lidere të botës, në Samitin Ndërkombëtar të Gruas "Partneriteti për Ndryshim: Fuqizimi i Gruas". Kryeparlamentarja Topalli ishte në panelin e hapjes së këtij Samiti, së bashku me Presidentin e Kosovës, Atifete Jahjaga dhe ish-sekretaren e shtetit të Amerikës, Madeleine Albright.

9 TETOR, 2012

Mjaftuan vetëm 4 ditë qëndrimi në tokën shqiptare për kryeparlamentaren Topalli, pasi në datën 9 tetor ajo nisët për një vizitë në Strasburg. Këtë herë e ftuar në Forumin Botëror për Demokraci, në Këshillin e Europës, Strasburg, Jozefina Topalli, si përfaqësuese e Shqipërisë, e cila mbajti presidentin e rradsës së KIE, ishte në panelin drejtues në sesionin me temë "Demokracia dhe Globalizimi", sesion që u kryesua nga Presidenti i Komisionit të Venecias, Gianni Buquichio.

5 DHJETOR, FRANCË

Krëgutimi i gjatë i fluturimeve për kryeparlamentaren Jozefina Topalli për gjithë vitin që po lëmë pas, përfundon në Francë. Kryetarja e Kuvendit Jozefina Topalli, në datën 5 dhjetor pati disa takime pune në Seantin francez dhe në Asamblesë Parlamentare të Francës. Kryetarja e Kuvendit kërkoi mbështetjen franceze për Shqipërinë në procesin e integritetit. Deri në fund të muajit dhjetor, nuk dihet nëse në axhendën e kryeparlamentares është përfshirë ndonjë udhëtim jashtë vendit.



Rama: Berisha fshehu papunësinë bastionet PD zhytur në varfëri

Kreu i PS, Edi Rama, ka akuzuar kryeministrin Berisha për fshehje të qëllimshme të nivelit të papunësisë në vend, duke iu referuar publikimit të një dite më parë të të dhënave të censusit nga INSTAT. Nga qyteti i Durrësit, ku PS prezantoi programin e saj për çështjet sociale, Rama tha se qeveria ka hequr dorë nga vlerësimet zyrtare të varfërisë që nga 2008, por shtoi se nga ky vit gjërat kanë

marrë të tatëpjetën negativisht. "U fshehu shqiptarëve të vërtetën për papunësinë. Kryeministri kërkoi heqjen e këtij kapitulli nga INSTAT. Në Shqipëri ka mbi 1 milion të papunë, qeveria ka hequr dorë nga vlerësimet zyrtare të varfërisë që nga 2008, nuk ka guxim ta vlerësojë dhe të shpallë shifra" tha Rama. Ai akuzoi PD se aty ku kjo parti ka më shumë mandate, ka dhe varfëri më të thellë. "Sot më pak se 8%

që kanë depozita bankare zotërojnë më shumë se gjysmën e pasurisë. Pa polarizimin e rajoneve dhe aty ku PD merr mandatet më të shumta, aty është edhe varfëria më e thellë. Varfëria nuk është aleate e opozitës, është një kalë mbi të cilin qeveria kalëron përmes frerëve të korrupsionit", tha ai. "Projekti ynë ka nevojë për 8 vite që të përmbushet plotësisht", deklaroi Rama në Durrës.

Sikur shqiptarët të votojnë sot, Rama kryeministër. 64% pro bashkimit Sondazhi PS fiton më 2013 PD është më keq se më '97

Supriza, AK e Spahiut ngjitet e treta, lë pas Metën e Topin

Lajmi

Në një sondazh të fondacionit "Kult" në Tetovë nxirren rezultate surprizë në lidhje me zgjedhjet në Shqipëri si dhe me mbështetjen që ka ideja e një bashkimi të të gjithë shqiptarëve në një shtet të vetëm. PS fiton zgjedhjet, PD bie në nivelin jetik, AK e treta.

TIRANE

JAKIN MARENA

Sondazhi i organizuar nga fondacioni "Kult" në Tetovë për Shqipërinë ka evidencuar shumë elementë thelbësorë, mes të cilave dëshirën e shqiptarëve për t'u bashkuar në një shtet të vetëm, dëshirën e shqiptarëve që të fitojë PS dhe rënia në nivelin zyrtar të "varfërisë" së votimit të PD dhe kërcimi i papritur i Aleancës Kuq e Zi të Kreshnik Spahiut në nivelin e partisë së tretë në vend me 14 përqind të preferencave duke lënë pas LSI e Ilir Metës dhe FRD e Bamir Topit. Të intervistuarit janë pyetur në mënyrë konkrete lidhur me zgjedhjet e 2013 se për kë do të votojnë e 36.5% e të anketuarve kanë thënë se do të votojnë për PS. Sondazhi për bashkimin e shqiptarëve do të shtrihet edhe në Kosovë e Maqedoni. Kampioni i sondazhit përbëhet prej 1200 të intervistuarve dhe u përzgjedh në dy faza: 1) Me përzgjedhje të rastësishme u përcaktuan 100 qendra votimi të shpërndara në gjithë vendin; 2) Për çdo qendër votimi u përzgjedhën rastësisht 12 shtetas të moshës madhore. Intervistat u kryen faqe më faqe në shtëpitë e të intervistuarve. Për intervistat u përzgjedhën anëtarë i familjes që kishte datwinding më të afërt me datën e intervistimit, për të arritur një kampion me

SIPAS KETIJ SONDAZHI, NGJA REZULTATET

Pyetjes: A doni që bashkimi i Shqipërisë me Kosovën të ndodhë para bashkimit me Evropën i janë përgjigjur

■ Po	64 %	■ Jo	25 %
■ Nuk e di	11 %		

Pyetjes: A mendoni se bashkimi i Shqipërisë me Kosovën do të kryhet para bashkimit me Evropën?

■ Po	43 %	■ Jo	42 %
■ Nuk e di	15 %		

Pyetjes: Cila parti po bën punën më konkrete për bashkimin sa më të shpejtë të Shqipërisë me Kosovën?

■ AK	39 %	■ PD	32 %
■ PS	19 %	■ LSI	2 %
■ PDIU	2 %	■ Nuk e di	6 %

Në qoftë se zhvillohen zgjedhjet sot, a do të votoni dhe a e keni ndarë mendjen se për cilën parti do të votoni?

■ Do të votoj dhe kam përcaktuar partinë	71 %
■ Do të votoj, por ende nuk e kam përcaktuar partinë	9 %
■ Nuk jam i sigurt nëse do të votoj	5 %
■ Nuk do të votoj	15 %

Ju që keni përcaktuar partinë, a mund të na tregoni për cilën parti do të votoni?

■ PS	36.5 %	■ PD	29.6 %
■ AK	14.1 %	■ LSI	4.7 %
■ FRD	4.1 %	■ Tjetër	3.2 %
■ Nuk tregon	7.8 %		

Kampioni

Kampioni i sondazhit u përbë prej 1200 të intervistuarve dhe u përzgjedh në dy faza: Me përzgjedhje të rastësishme u përcaktuan 100 qendra votimi të shpërndara në krejt vendin. Për çdo qendër votimi u përzgjedhën rastësisht 12 shtetas të moshës madhore.



Naim Zengu

shpërndarje sa më përfaqësues të moshave. Marzhi i gabimit statistikor për këtë kampion është +/-3.1%. Për elementin bazë për të cilin janë të interesuar gjithë shqiptarët, atë të pritshmërisë së zgjedhjeve parlamentare të verës së ardhshme, sipas sondazhin socialistë marrin 36.5 përqind të preferencave të të intervistuarve. Ndërsa

"Rreth 64 përqind e të anketuarve në një sondazh për bashkimin Shqipëri-Kosovë janë pro këtij bashkimi para anëtarësimit në Bashkimin Evropian"

PD ka rënë në nivelin "jetik" të saj në 22 vite postkomunizëm, në 29.6 përqind, niveli më i ulët që nga zgjedhjet e 31 marsit të vitit 1991, por dhe të verës së vitit 1997, ku parësisht ndëshkimit që mori për firmat piramidale dhe shembjen e shtetit me pasojë afër 5 mijë të vdekur, PD arriti ta kapërcente limitin e 30 përqind të mbështetjes së shqiptarëve. Ndërkohë që mandati i dytë me sa duket e ka konsumuar aq shumë partinë më të madhe qeverisëse sa e ka kështu fare. Por surpriza e këtij sondazhi është ngjithë e Aleancës Kuq e Zi të drejtuar nga Spahiut në afër dy vite në vendin e tretë për nga prapercencat në Shqipëri, duke prezantuar një forcë politike diçka mes Vetëvendosjes në Kosovë e Syriza në Greqi. Duke treguar se strategjia e saj nacionaliste ka ngjitur duke zbritur shumë nga votat e PD, por pa lënë pas dore dhe nga PS. Ndërsa ngjitur e

PS, Braçe:

"Sondazhi, 36.5% është pak, jemi numri një"



Mënyherë pas daljes së sondazhit të fondacionit tetovar "Kult" për pritshmërinë e zgjedhjeve në Shqipëri, ka reaguar nënkryetari i grupit të PS, Erjon Braçe. "PS 36.5% thotë ky sondazh. Parti e parë në vend. Antiregjim janë shumë më tepër. Por unë mendoj se vetëm 36.5% jemi shumë pak", tha Braçe. "Duket të kthehem në betejë, të luftojmë për të bindur njerëzit, jo që jemi më të mirë por që jemi ndryshe nga njerëzit e regjimit. T'ua tregojmë me zgjedhje konkrete e të realizueshme, t'ua tregojmë me njerëz të rinj, të ndershëm, të papërkulshëm e të pakorruptuar", thotë Braçe.



Meta: Politika të zgjidhë problemet jo t'i shtojë ato

Kryetari i LSI, Ilir Meta zhvilloi një tur të gjatë në Përmet e Gjirokastër ku në themel të qëndrimit të tij ka qënë bashkëpunimi i politikës në favor të qytetarëve dhe heqja dorë nga retorika nacionaliste.

Meta, si e gjykon faktin që Shqipëria nuk mund të fitojë sërish statusin e vendit kandidat dhe a është përgjegjësi direkte e

klasës politike në këtë rast?

Jam i bindur se asnjëherë nuk është vonë për të bashkëpunuar dhe në rastin konkret më mirë vonë sesa akoma më vonë dhe çdo refleksim për të votuar tre ligjet do të ishte përsëri një mesazh pozitiv drejtuar vendit por drejtuar edhe partnerëve tanë evropianë.

Meta ndryshe nga takimet e tjera sot keni përmendur edhe faktin se duhet

distancuar nga thirrjet nacionaliste. Çfarë nënkuptoni specifiktisht në këtë rast?

Politika duhet të zgjidhë problemet që kanë qytetarët, nuk duhet të shtojë probleme të tjera apo të rikthejë probleme të vjetra.

Kujt i referoheni në këtë rast për këto thirrje nacionaliste?

Besoj se mesazhi është shumë i qartë.

Numri dy i KQZ, Biba

Grëzohet kërkesa e dytë e PS, nuk ka të dhëna për banorët në Kukës

■ ■ ■ TIRANE

Ministria e Brendshme rrëzoi për herë të dytë kërkesën e anëtarëve të propozuar nga PS në KQZ lidhur me dyshimet që kanë për shtimin jo normal të popullsisë në Qarkun e Kukësit gjatë muajve qershor-nëntor. Për Shqiptarja.com, nënkryetari i KQZ, Denar Biba bëri të ditur se për të dytën herë radhazi Ministria e Brendshme refuzoi të japë informacione lidhur me shtimin e popullsisë në katër komunat e Qarkut të Kukësit. "Ministria e Brendshme na ka kthyer përgjigje për kërkesën e dytë që kemi depozituar lidhur me marrjen e informacioneve për mënyrën sesi është shtuar popullsia në 4 komunat e Qarkut të Kukësit, Topojan, Shishtavec, Fierzë e Tropojë,



ku përgjigja rezultoi se është e njëjtë me të parën, pra që nuk na është dhënë informacioni që ne kemi kërkuar. Në përgjigjen e saj Ministria citon edhe një herë se s'mund të nxirren të dhëna

personale të regjistrimit të popullsisë në këtë qark. Por ne kërkuam se si është shtuar numri i popullsisë në muajt qershor-nëntor në 4 komuna, kush janë këta persona që janë shtuar dhe çfarë dokumentacionesh kanë paraqitur. Kjo kërkesë u rrëzua për të dytën herë", tha Biba. Ndërsa lidhur me ngërçin që ekziston në KQZ, pikërisht me ankimin e vendimit të KQZ për shpërndarjen e mandateve, Biba shpjegoi se vetë KQZ është në kontrast me vendimet që ka marrë. "Ne jemi dakord për rishpërndarjen e mandateve po jo në atë mënyrë që është vendosur. Kryetarja e KQZ vendosi me 7 vota pro që KQZ nuk ishte kundër shpërndarjes së mandateve, u rrëzua në të njëjtën kohë vendimi për shpërndarjen sipas asaj që kishte vendosur administrata e KQZ", tha Biba.

Kandidatët

Emrat e kandidaturave për deputetë nisën të bëhen evidente pas krenimit të 100 Vjetorit të Pavarësisë kur duket se nisi edhe fushata elektorale për zgjedhjet parlamentare që do të organizohet vitin e ardhshëm.

Nisin të dalin projeksionet e para të mazhorancës për listat e deputetëve

Durrës, lista e kandidatëve të PD

Hidhen emrat e parë në tregun e politikës për listën e qarkut të Durrësit. Risia, rikthehet Olldashi, Pollo që lëviz nga Berati, Gorreja që lë Postën, Xhaferaj dhe Halimi rikandidojnë sërish

■ ■ ■ DURRES

ARTUR KORRIKU

Ndonëse ende jo zyrtare, në mjediset politike në Durrës kanë nisur të artikulohen emrat e parë të kandidatëve për deputetë që do të përbëjnë listën

e mazhorancës në Durrës. Në listën ende të pa shpallur bëjnë pjesë emra surprizë për elektoratin e djathtë në Durrës. Të tillë janë e emrat e Pollos, Xhaferajt, Gorresë e Halimit. Burime nga PD dega Durrës bëjnë me dije se kanë nisur të hidhen në tregun e politikës disa prej emrave të mazhorancës me të cilët ajo do

përfaqësohet në këtë rreth. Bëhet fjalë për personazhe të njohur të politikës jo vetëm nga Durrësi por edhe nga Tirana. Flitet se emri i parë i ardhur nga Tirana është ai i Genc Pollos aktualisht Ministër i Inovacionit, deputet në Qarkun e Beratit. Tjetër emër i njohur është ai i Ferdinand Xhaferit që pak kohë më parë

u punësua si këshilltar pranë Kryeministrit Berisha. Duket se pas humbjes së Xhaferit në garën për kreun e bashkisë së Durrësit, mes tyre gjërat po shkojnë mirë. Një tjetër emër i

përfolur është edhe ai i Arqile Gorresë, Drejtorit të Përgjithshëm të Postës Shqiptare. Emri i tij është artikuluar disa herë nga ana e Berishë që nuk ka kursyer vlerësimet për punën

e postave nën drejtimin e tij. Gorreja është nga të paktët drejtorë që s'kanë lëvizur nga ky post që nga 2005 vit kur PD erdhi në pushtet. Në mjediset politike të PD në Durrës përflitet dhe emri i Eduard Ndreut Drejtorit të Portit Detar Durrës. Fakti që ky port është hequr nga lista e zezë e porteve përpara i përket nivelit të sigurisë e bën Ndreun një ndër emrat e pëlqyer të lidershipit të PD. Edhe Ndreu e mban këtë detyrë që nga viti 2005. Një ndër emrat e lakuar si kandidat për deputet në Durrës është dhe ai i Eduard Halimit, Ministrit të Drejtësisë. Ai shihet si një ndër të preferuarit e kryeministrit në qeveri. I fundit emër i hedhur në treg është edhe ai i Sokol Olldashit një njoheje e vjetër e Durrësit, duke lëvizur nga Fieri ku është deputet. Më 2005 ai kandidoi në Durrës në zonën e Shijakut ku fitoi përballë Agron Dukës, dhe e dorëzoi dy vjet më pas teksa garoi pa sukses përballë Ramës në Tiranë për kreun e bashkisë. Duket se me këto emra do kalkulohej lista e PD në Durrës duke zbatuar formulën e përfaqësimit mes atyre që katapultohen në listë nga Tirana me emrat e vendasve.

TE SELIA E PD BIE SHKRONJA "Q" NGA EMRI I PARTISË

Në selinë e PD, bie shkronja "q". Tashmë nuk shkruhet më Partia Demokratike e Shqipërisë, por Partia Demokratike e Shqipërisë.

Duket se demokratët ose janë shumë të zënë për të pasur mendjen tek selia e Partisë Demokratike dhe për të parë rrëshqitjen e gërmës "q" të emrit të saj, ose ia kanë harruar derën selisë së kësaj partie, duke u dhënë më shumë pas qeverisjes e posteve shtetërore.



FOTOLAJM

KABINETI SALAJ

APARATE DËGJIMI

Mbi bazën e një experience 10-vjecare në fushën e vendosjes së APARATEVE të dëgjimit kabinetit "SALAJ" ju vjen në ndihmë në këto shërbime:

- Matjen e dëgjimit (audiogram) FALAS.
- Marrjen e masës si dhe përgatitjen e saj (silikon apo akrilike) në kohë rekord brënda dy ditëve.
- Përcaktimin dhe programimin e aparatit sipas shkallës së dëgjimit.
- Shërbime (servis) për të gjitha tipet e aparateve.

Adresa: Pallatet e Shallvareve,
Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, përballë Taiwan
Nd. 24, Shk. 4, Ap.5 - Tiranë
Tel: +355 4 2262 304 / Mob: 068 23 800 95
E-mail: info@salajakustik.com
Website: www.salajakustik.com

EKONOMI

Balla: Argita fiton sa zëvendëspresidenti amerikan

Sipas deputetit socialist Taulant Balla, S. vajza e kryeministrit të Shqipërisë paguhet njëlloj sa edhe zëvendëspresidenti amerikan Joe Biden. Partia Socialiste ka vijuar kështu e atë që e cilëson transparencë të deklarimit të pasurive për "bllokmenët blu". "Sipas asaj çka vetë zonja Argita Berisha deklaroi, gjatë vitit 2011, pasuria e vajzës së

kryeministrit është shtuar me 210.784.000 lekë. Sipas tij, në Shqipëri nuk mund të gjejmë një person të njëjtë të paguar me këtë shumë. "Zonja Argita Berisha, si e punësuar në arsim, deklaroi plot 12 milionë lekë rrogë në muaj. Sa janë mësuesit që paguheshin kaq sa ajo? Një drejtor shkollë paguhet rreth 600 mijë lekë në muaj. Pra, zonja Argita Berisha

paguhet çdo muaj aq sa paguheshin 20 drejtorë shkollë së bashku", tha Balla. Duke shtuar se, nga 17 milionë e gjysmë lekë fitime në muaj, 12 milionë i vijnë nga mësimdhënia universitare". Deputeti i Partisë Socialiste deklaroi se, në një kohë kur shqiptarët po varfërohen përditë, paradoksalisht pasuria e Argita Berishës pëson vetëm rritje, nga viti në vit.

Ekspertët e financave, me opinione të ndryshme

FMN: Borxhi publik rritja sjell rrezik

Sa ndikon kreditimi te rritja ekonomike

Lajmi

Një përfaqësues i lartë i Fondit Monetar Ndërkombëtar është shprehur dje në Tiranë se kalimi i borxhit publik shqiptar mbi kufi prej 60 për qind të PBB është i rrezikshëm. Kjo temë ka përfshirë në debat akademikë, politikanë dhe ish-funksionarë të administratës fiskale

■ ■ ■ TIRANE

GENC KONDI

Niveli i borxhit publik në Shqipëri është i lartë dhe i rrezikshëm. Kështu është shprehur dje ish-përfaqësuesi rezident i FMN në Tiranë, Volker Treichel, gjatë një konferencë shkencore për ekonominë. Treichel aktual-

isht është kryeekonomist dhe përgjegjës sektori pranë Fondit Monetar. Heqja e limitit, të përcaktuar deri tani më ligj, për borxhin publik të Shqipërisë ka hapur një debat mes ekonomistëve, që ka kaluar kufijtë e vendit dhe përkatësitë partiake. Ish-përfaqësuesi i FMN-së në Shqipëri u shpreh se rritja ekonomike kërkon transformimin e strukturës ekonomike, që nxjerr në pah sektorët, të cilët janë konkurrues në rajon dhe në Evropë dhe qeveria shqiptare duhet të mbështetë sektorin



Sali Berisha dhe Ridvan Bode

privat për të nxjerrë në pah këta sektorë.

Nga ana e tij, prof.dr. Anastas Angeli, akademik dhe rektor i Universitetit Mesdhetar, tha se kriza në rajon dhe vendet e eurozonës jep ndikim edhe mbi ekonominë shqiptare, pasi ajo është pak e zhvilluar, përmasat dhe struktura e saj ende nuk janë të qarta.

Këto deklarata u bënë në konferencën shkencore "Shqipëria dhe kriza, çfarë vjen më pas", organizuar nga Universiteti Mesdhetar i Tiranës. Problemi i rritjes së borx-

hit publik ka qenë në qendër të vëmendjes së opinionit të specialistëve të fushës këtë vit, kur nga një muaj tek tjetri është parë qartë se qeveria nuk do të respektonte kufirin ligjor të tij. Deri në tetor, zyrtarët nuk praninonin se do të kapërcejnë kufi limit, por ka qenë vetë kryeministri Berisha, që ka thënë më pas se për interes të sigurimit të vazhdimësisë së rritjes, në mungesë të likuiditetit prej krizës globale, qeveria nuk ka pse ta ruajë domosdoshmërisht këtë nivel borxhi. Kjo u pasua menjëherë me amendimin e ligjit për buxhetin e shtetit, ku nuk u caktua asnjë kufi i ri për borxhin, që konsiderohet si një politikë e rrezikshme kryesisht nga akademikët dhe opozitarët. Ndërkohë, mazhoranca dhe një pjesë e ekspertëve gjykojnë se është rritja e borxhit është diçka e domosdoshme për të siguruar likuiditet për ekonominë në vështirësi nga kriza globale.

FORUM

Malaj: Qeveria po keqpërdor buxhetin

Rështet thjesht rezultat i krizës globale, por shkak i keqgjerisjes, sipas ish-ministrit të Financave Arben Malaj. Ai tha dje se çdo euro më tepër që shkon për të paguar koston e borxhit është një euro më pak për zhvillimin. Nuk është e vështirë të propozoheshin politika fiskale për të dalë nga kriza. Por mazhoranca nuk dëgjon. Qeveria harxhon paratë për të bërë makijazh elektoral, ndërsa njerëzit kursejnë qindarkat. "Berisha thotë merrni shembullin e Japonisë që e ka borxhin 200%, por rasti i Japonisë përmendet se si borxhi i lartë pengon rritjen ekonomike të vendit. Ekonomia japoneze nuk zhvillohet më prej 10 vjetësh për shkak të borxheve të larta", shtoi ai.



Hida: Borxhi? OK për shpenzime investimi

Deputeti i PD, ekspert i ekonomisë, Sybi Hida shprehet kundër qeverisjeve me borxhe të larta. Por, është më efektive zgjidhja e problemit, sesa qëndrimi korrekt ndaj disa kornizave të vendosura nga vetë njerëzit, thotë ai. Borxhi ynë është i qëndrueshëm, i vlerësuar së fundmi edhe nga "Moody's", si në strukturë, ashtu edhe në madhësi. Struktura e tij është e shëndetshme, pasi mbi 20% e buxhetit shkon për investime publike, krahasuar me 7%, që është në vendet e BE-së. Pra, këto para shkojnë për shpenzime që rritin ekonominë e vendit. Qëndrimi fiksnë ndaj moskalimit të nivelit prej 60% do të thotë të shtosh goditjet ndaj ekonomisë në situatën globale, aspak të shëndoshë, deklaroi deputeti i PD.



Can: Mirëqenia nuk mund të rritet me borxhe

Ish-guvernatori i Bankës së Shqipërisë mendon se heqja e kufirit të borxhit nuk është alternativa më e mirë për të nxitur ekonominë. Në një intervistë televizive dje, Shkëlqim Cani tha se mirëqenia nuk rritet me borxhe, aq më tepër kur pjesa më e madhe e parave qarkullojnë në një numër të kufizuar njerëzish. Sipas tij, për të shmangur kostot e borxhit, një nga alternativat do të ishte lehtësimi i mëtejshëm i politikës monetare. Cani shtoi se edhe vitin e ardhshëm treguesit kryesorë të ekonomisë do të vijnë në përfaqësimin për shkak të politikave të gabuara të qeverisë. Papunësia, si dhe nga pasiguria për të ardhmen, ka bërë që shqiptarët të mos shpenzojnë, por më shumë të kursejnë.



Civici: Rritja, prognoza shumë optimiste

Rritja e borxhit publik Rnënkupton rreziqe apo situata të vështira, theksoi rektori i Universitetit Evropian Adrian Civici. Tejkalmi me 2.6% në raport me limitin 60% të PBB nuk duket i madh, por llogaritjet janë bërë mbi bazën e parashikimit për një rritje shumë optimiste. Nëse Shqipëria merr borxh, por nuk e realizon këtë rritje ekonomike, atëherë niveli i borxhit mund të rezultojë mbi 65% dhe kostoja e shërbimit të tij shumë e lartë. Rreziqet lidhen edhe me strukturën e borxhit publik që po ndryshon, duke rritur pjesën e borxhit me financim të huaj, nga 12.4% të PBB në vitin 2007, në mbi 22% të PBB në vitin 2012. Kjo potencialisht rrit edhe riskun nga kursi i këmbimit.



Berberi: Nuk përballojmë dot borxh mbi 60 %

Ekspertja e financave publike Adriana Berberi, ish-zv.ministre, theksoi se përcaktimi në ligj i nivelit maksimal të borxhit publik në nivelin 60% nuk është diçka e rastit, por lidhet me stadin e zhvillimit ekonomik të vendit, me qëndrueshmërinë dhe stabilitetin ekonomik, por edhe me vlerësimin e mundësisë së rritjes ekonomike që ekonomia e një vendi ka objektivisht. Ekonomia jonë nuk jep asnjë argument pozitiv për mundësinë e përballimit të borxhit në nivelet mbi 60%. Për të, nuk është kritike thjesht rritja, por "kori" i diriguar i qeverisë, që e quan normale ligjëritimin e rritjes. Berberi shtroi pyetjen: Përse mazhoranca nuk vendosi në ligj një nivel të ndryshëm nga ai 60%?



AKTUALITET

Durrës, arrestohet nga policia pasi vodhi shokun

Policia e Durrësit ka vënë në pranga një person, i cili në bashkëpunim me disa persona të tjera ka grabitur me dhunë një shtetas. Sipas burimeve zyrtare të policisë mësohet se është arrestuar 35-vjeçari Gentian Muça, pasi në bashkëpunim edhe me persona të tjerë, i kanë vjedhur me dhunë 45-vjeçarit K.L. xhupin ku ndodheshin 4900 euro, të marra kredi në

një bankë. "Autori i dyshuar i ngjarjes rezultoi të ketë pasur lidhje shoqërore me të dëmtuarin; të jetë shoqëruar me të përgjatë tërheqjes së shumës së kredisë si dhe përgjatë natës, si dhe të ketë njohur intenerarin e lëvizjes së këtij të fundit përpara grabitjes së kryer. I dëmtuari, shtetasi me inicialet K.L. ka marrë dëmtime të shumta në kokë e trup si pasojë e dhunës

së pësuar dhe aktualisht ndodhet jashtë rreikut për jetën në Spitalin e Durrësit", informon policia. Uniformat blu, vijojnë punën në drejtim të identifikimit të personave të tjerë të përfshirë në ngjarje. Materialet proceduriale të përpiluara për veprën penale të vjedhjes me dhunë në bashkëpunim, iu kaluan Prokurorisë së Rrethit Durrës.

Enver Qoku u arrestua pasditen e djeshme në Tiranë

Pranga për rryshfet pedagogut sekser

Mori 20 mijë lekë për provimin e kolegut të tij

Lajmi

Bie në pranga si sekser provimesh një Shef Departamenti i Gjeologjikut. Enver Qoku u arrestua pasi mori rryshfet 20 mijë lekë nga një student që i kërkoi të ndërhynte dhe ta ndihmonte për të marrë tre provime në Universitetin e Kamzës.

TIRANE

Arrestohet shefi i Departamentit të Gjeologjisë së Zbatuar dhe Mjedisit në Fakultetin Gjeologjik-Miniera, Tiranë. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në maj të këtij viti ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të shtetasit Enver Qoku, për veprën penale të "Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj funksioneve që ushtrojnë funksione publike". Pas hetimeve disa muajore, me mjete speciale të hetimit, është arrestuar në flagrancë shtetasi Enver Qoku, i cili ushtron detyrën e shefit Departamentit të Gjeologjisë së Zbatuar dhe Mjedisit në Fakultetin Gjeologjik-Miniera, Tiranë. Ky shtetas ka marrë shuma parash nga një student i Universitetit Bujqësor Kamzë, duke i premtuar atij ndërhyrjen tek disa pedagogë të këtij



Enver Qoku

universiteti për ta kaluar në disa provime në të cilat ai kishte hyrë më parë dhe nuk kishte marrë notë kaluese. Ndërkaq vijojnë hetimet për

verifikimin e rrethanave të këtij procedimi penal në lidhje me veprimet e kryera nga pedagogët tek të cilët Enver Qoku ka pohuar se ka

Marrëveshja

Qoku i ka premtuar studentit se do të mund ta kalonte vetëm në provimet e vjeshtës por i ka bërë të ditur studentit se kolegët e tij në Universitetin Bujqësor të Kamzës i kishin kërkuar të paguanë për të arritur marrëveshjen.

ndërhyrë për këtë çështje.

IMPLIKIMI

Aksioni i djeshëm është dirigjuar nga ekipi i Task-Forcës në prokurorinë e kryeqytetit. Gjithçka ka nisur në muajin Maj, kur një student i ka bërë me dije Qokut se kishte probleme në një tjetër universitet, atë të Kamzës për të marrë provimet. Qoku ka premtuar se do të interesohej por sërish në Maj studenti ka ngelur në tre provime. Më pas duket se Qoku i ka premtuar studentit se do të mund ta kalonte vetëm në provimet e vjeshtës

por i ka bërë të ditur studentit se kolegët e tij në Universitetin Bujqësor të Kamzës i kishin kërkuar të paguanë për të arritur marrëveshjen. Në këtë moment i riu ka sinjalizuar prokurorinë në lidhje me ngjarjen. Ndërsa gjithçka është finalizuar pasditen e djeshme kur në një takim studenti dhe Qoku janë ulur në një lokal në kryeqytet dhe studenti i ka dhënë Qokut 20 mijë lekë të reja si shpërblim për njërin nga provimet. Burime nga prokuroria thanë dje se janë dhe të paktën dy pedagogë në Universitetin e Kamzës që dyshohen si bashkëpunorë të Qokut, por sqaruan se nga hetimi disa muajor nuk ishte bërë i mundur dokumentimi i përfshirjes së tyre në këtë skemë rryshfeti. Sakaq Shefi i Departamentit të Gjeologjikut, Enver Qoku akuzohet për ushtrim të paligjshëm të ndikimit dhe korrupsion. Qoku mbante prej pesë vitesh pozicionin e shefit të Departamentit të Gjeologjisë së Zbatuar dhe Mjedisit në Fakultetin Gjeologjik-Miniera, Tiranë.

LAJME SHKURT

Studimi, të burgosurit me probleme

Plot 70 përqind e të dënuarve apo të burgosurve shqiptarë vuajnë nga probleme mendore. Të dhënat shqetësuese janë publikuar në një raport të hartuar në vitin 2011 gjatë një monitorimi në gjithë qendrat Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Shqipëri (IEVP). Kjo situatë që ka sjellë domosdoshmërinë e përmirësimit të kushteve të trajtimit të tyre, sidomos në pjesën e kujdesit mjekësor dhe atë psikologjik. Shërbimi i ri do t'i vijë më afër edhe të gjithë qytetarëve të tjerë, duke u shtrirë nëpër rrethe. Raporti i monitorimit në burgje sjell në vëmendje vështirësitë shëndetësore mendore për shkak të mbipopullimit të burgjeve dhe hapësirave të vogla të paajrosura mirë.

Itali, kapet trafikanti shqiptar

Një 32-vjeçar shqiptar është arrestuar në Itali, pasi akuzohet për trafikim të lëndëve narkotike. Shqiptari, i cili tentoi t'i shpëtonte kontrollit të uniformave blu, duke u fshehur pas një ndërtese, është prangosur. Gjatë kontrollit atij i është gjetur e fshehur në xhup 540 gramë marijuanë dhe në xhapat e pantallonave mbante një thikë. Më pas, policia vijoi kontrollin edhe në banesën e shqiptarit në Novoli, ku u gjet dhe sekuestrua 82 gramë lëndë narkotike, e fshehur brenda një dollapi në njërin prej dhomave të gjumit. Gjithashtu gjatë kontrollit në banesë, policia ka gjetur edhe dy peshore elektronike, të cilat përdoren për ndarjen e drogës.

Kalaja e Krutës në rrezik nga rrëshqitja

Kalaja e Krutës dhe Muzeu Historik Kombëtar "Gjergj Kastrioti" në këtë qytet janë të rrezikuara nga rrëshqitjet e dheut që ditët e fundit kanë prekur këtë zonë. Rrëshqitja e tokës është një fenomen i përsëritur prej vitesh, por gjatë ditëve të fundit, e ndihmuar dhe nga shirat e rrëmbyeshëm situata është bërë më kritike. Çarja tokës përveç këtyre dy objekteve me vlera të mëdha për historinë kombëtonë, rrezikon edhe shumë banesa aty pranë, banorët e të cilave shprehin të shqetësuar. "Është një problem i cili ka vite", shprehën banorët e zonës.

Karamelet

Kapet çifti me 2 kg marijuanë në doganën e Kakavijës

Një çift bashkëshortësh kanë fshehur mes tortës dhe karameleve një sasi prej 2 kg marijuanë, por janë zbuluar nga policia. Çifti Fatjon Hadëraj dhe Ela Malko po udhëtonin me autobusin e linjës Gjirokastër-Athinë të kompanisë "Lengo Travel". Policia ka konstatuar se në sediljen 23 dhe 24 të këtij autobusi në një çantë të zezë dore në brendësi të saj u gjetën 10 pako të vogla të mbushura me lëndë narkotike. Po gjatë kontrollit efektivat e Policisë Kufitare në pjesën ku mbahen bagazhet

e dorës mbi sediljen 23 e 24 u gjet një kuti tortë ku brenda saj kishte 4 pako të mbushura me marijuanë të mbuluar me karamele. Policia ka bërë ndalimin e dy pasagjerëve, ndërsa nga peshimi i gjithë sasisë së gjetur u konstatua se bëhej fjalë për një sasi prej 2 kg marijuanë. Policia ka kryer arrestimin e 27 vjeçarit Fatjon Hadëraj, ndërsa është lënë e lirë bashkëshortja e tij. Hetimet paraprake kanë treguar se bashkëshortja e shtetasit Fatjon Hadëraj nuk ishte e implikuar në



këtë ngjarje dhe vetë bashkëshorti i saj ka paratur se lëndën narkotike e kishte futur ai në çantën e bashkëshortes pa dënimin e saj. Gruaja shtatzanë është lënë e lirë. Lëndë narkotike ishte siguruar në Lazarat dhe do të trafikohet në Athinë.

Tragjedia

Bie në pus, vdes 10-vjeçari në Tiranë

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pasditen e djeshme në Tapizë të Tiranës, ku një fëmijë ka humbur jetën pasi ka rënë aksidentalisht në një pus me ujë. Sipas burimeve nga policia bëhet e ditur se fëmija 10-vjeçar ka rënë në një gropë të madhe me ujë, që përdorej për vaditjen e tokave dhe për pasojë ka humbur jetën. Mësohet se viktimë është 10-vjeçari me inicialet E.N. Familjarët kanë bërë të mundur nxjerrjen e trupit të pajetë nga pus, ndërkohë që policia ka mbërritur në vendngjarje. Paraprakisht policia dyshon se gjithçka ka ndodhur ak-



sidentalisht dhe se 10-vjeçari E.N ka qenë i vetëm në momentin e ngjarjes dhe dyshohet se ka humbur ekuilibrin ndërsa ishte pranë pusit.



AKTUALITET

Gjykata lë në burg dhunuesin e gruas shtatzënë

Gjykata e Faktit në qytetin e Korçës ka dhënë dje masën e sigurisë "Arrest me burg" për 34-vjeçarën, Olsi Iliazi i cili akuzohet për dhunimin e bashkëshortes së tij katër muaj shtatzënë Rudina Iliazi. Seanca gjyqësore u zhvillua në pavionin e kirurgjisë, në spitalin e qytetit juglindor, aty ku 34-vjeçari qëndron i shtruar prej dy ditësh pas tentativës për vetëvrasje në

ambientet e paraburgimit. Avokati mbrojtës i të pandehurit, si dhe prokuroria kanë kërkuar masë më të lehtë konkretisht "Arrest shtëpie" ose në spital për shkak të gjendjes të tij. Por në fund trupi gjyqësor ka vendosur masën "Arrest me burg". Ndërkohë 34-vjeçari dhe bashkëshortja e tij ndodhen në të njëjtin pavion, konkretisht Rudina Iliazi në dhomën 9-të, ndërsa Olsi në

dhomën 4-ër, shumë pranë njëri-tjetrit. Ngjarja e rëndë u regjistrua këtë të martë në lagjen 8 të qytetit të Korçës në shtëpinë e prindërve të Rudinës. Mjekët thonë se gruaja e dhunuar ka plagë në kokë. Pas dhunës policia arrestoi autorin në flagrancë. Olsi ishte emigrant në Itali dhe prej 3 muajsh ishte kthyer në shtëpinë e tij në lagjen nr 8 të qytetit të Korçës.

Kallzimi për ngjarjen te "Myslym Shyri" më 11 Dhjetor

Paditen për dhunim 5 policë në Tiranë

Policia nxori nga shtëpia Sokol Zhegun

Lajmi

Zbardhet kallëzimi penal ndaj pesë drejtuesve të komisarariatit nr.3 në kryeqytet të cilët dyshohet se janë përfshirë në dhunimin e më pas nxjerrjen forcërisht nga banesa të një qytetari në Tiranë duke i zaptuar madje dhe banesën.

■ ■ ■ TIRANË

HABJON HASANI

Pesë drejtues të komisarariatit nr.3 në kryeqytet janë denoncuar dy ditë më parë në prokurori për ushtrim dhunë dhe grabitje dhe dhunim të pronës bazuar në një episod të ndodhur më të 11 Dhjetor. Bëhet fjalë për konfliktin në lidhje me pronësinë e një banese mes Sokol Zhegun dhe Aleksandër Bregut, ndërsa Zhegun duket se është rrahur dhe më pas nxjerrë nga shtëpia nga drejtuesit e komisarariatit nr.3. Kallëzimi është bërë nga mbrojtësi i Zhegun, Sokol Koçiu, gjithashtu dhe dëshmitar okular i ngjarjes, kallëzimin e të cilit drejtuar kryeprokurorit të Republikës Shqiptarja.com e disponon të plotë dhe boton pjesët më kryesore të këtij kallëzimi

I NDERUAR Z.KRYEPROKURORI!

Më 11 Dhjetor 2012, rreth orës 8.30 qytetari Sokol Zhegun, i cili më kish zgjedhur si përfaqësues ligjor të posaçëm në lidhje me nën konflikt gjyqësor për banesën ku jetonte, më telefonon dhe më thotë që inspektori i policisë së rendit Kastriot Çuko e kishte telefonuar në celular, duke njoftuar që të paraqitej pranë shtëpisë për të kryer disa veprime procedurale. Duke qenë se personi i sipërcituar po kthehej nga Vora dhe mund të vonohej, e sigurova që do të shkoja unë si përfaqësues i tij. Në vendin e takimit pasqë Kastrioti nuk ishte vetëm por me inspektorin e krimeve Ervis Guri. Pas përsëritjes më thanë se Sokol Zhegun e kishin thirrur që të lironte menjëherë shtëpinë ku ai banonte, pasi sipas tyre i takonte një tjetri me emrin Aleksandër Bregu. I shpjegova se për këtë çështje Aleksandri ishte takuar me mua ditë më parë dhe se ai jo vetëm ishte në dijeni të gjithë procesit gjyqësor që po zhvil-

lohej, por dhe të vendimit që kish dalë në favor të Sokol Zhegun.

KOMISARIATI

Rreth orës 9-9.30, kur isha pothuajse në të hyrë të Komisarariatit pasqë në oborr Sokolin dhe u drejtova për tek ai. Por në atë moment inspektori i rendit Kastriot Çuko së bashku me dy punonjës policie me uniformë të cilët po t'i shoh i njoh, e kapën Sokolin forcërisht për krahësh dhe e tërhoqën zvarrë, për në një nga birucat e katit të parë djathtas. Për të denoncuar

ishte në dijeni të problemit dhe se për sqarime të mëtejshme do të dërgonte shefin e krimeve Ermalin, ndërkohë që para syve të mi punonjësi i policisë Kastriot Çuko dhe dy policët e tjerë të sipërcituar jo vetëm që e godisnin me sa mundeshin Sokol Zhegun, por me britma e ulërime Kastrioti çirrej duke i thënë se do ta bënte që ta lironte me një këmbë "shtëpinë e Sandrit".

LAJMËRIMI

Në kushtet e kësaj barbarie mesjetare njoftova menjëherë familjarët e Sokolit si dhe mbrojtësin e tij av.Plarent Ndreca i cili me të ardhur kërkoi takim urgent me Sokolin, por u ndalua nga oficeri i rojës pasi kishte urdhër që me Sokolin mos kontaktonte njeri. Disa çaste më vonë, kur sëbashku me një nga familjarët e Sokolit të quajtur Stela Shele po sqaroheshim nga sporteli i pritjes me oficerin e rojës, nga dera ku hyjnë punonjësit e policisë hyn Aleksandër Bregu, "kandidati për pronar" i shtëpisë së Sokol Zhegun. I çuditur që askush nuk e ndaloi, e pyes oficerin e rojës: -Ky që kaloi më duket fytyrë e parë, këtu punon? Ai m'u përgjigj: -Jo, është shoku i shefit të komisarariatit! Pas afërsisht një orë, pra rreth orës 10.45 u hap dera e birucës nga ku dolën Kastrioti dhe dy policët në fjalë që tërhoqën zvarrë Sokolin të lidhur në



atë dhunë shtazarake, si dhe për të ndërpjerrë gjendjen e paligjshme të krijuar, u paraqita menjëherë tek oficeri i rojës ku pasi u prezantova dhe i shpjegova gjithçka që pasqë me sy, kërkova një takim urgent me shefin e komisarariatit Alfred Numani ose me shefin e krimeve Ermal Lila. Oficeri i shërbimit menjëherë komunikoi në celular me shefin e komisarariatit dhe pas bisedës me të më tha që shefi

Dëshmia

Por në atë moment inspektori i rendit Kastriot Çuko së bashku me dy punonjës policie me uniformë të cilët po t'i shoh i njoh, e kapën Sokolin forcërisht për krahësh dhe e tërhoqën zvarrë, për në një nga birucat e katit të parë djathtas.

torin e rendit Kastriot Çuko, nën drejtimin e Aleksandrit filluan të shkallmojnë vetë dyert e pasme të banesës dhe duke qenë se ato nuk po hapeshin filluan të shembnin muret e banesës. Nga sa pasqë ishin më të kualifikuar si punëtorë ndërtimi, sesa si policë. Në këtë moment shefi i policisë së bashku me shefin e krimeve dolën nga bodrumet e shtëpisë dhe urdhëruan disa punonjës policie të veshur me uniformë që të merrnin shkallën dhe të hynin nga ballkoni për në banesë. Njëri prej uniformave tentoi ta kundërshtonte duke i thënë që kjo punë ishte me rrezik, pasi policët mund të binin nga ballkoni por ulërima e shefit që të zbatonte urdhërin i detyroi që të merrnin shkallën në

krahë e të niseshin me vrap. Në këto kushte ata hipën nga ballkoni, shqyen derën me një zhurmë të llahtarshme që terrorizoi shahin këtë skenë të frikshme nga larg ashtu dhe bashkëshorten e Sokolit si dhe djalin e tyre.

Por së e thënë të mbaronte me kaq. Si në kohën e gestapos, inspektori i rendit Kastriot Çuko në prani të shefit të policisë dhe atij të krimeve nxorri përballë gruas dhe djalit për shantazh "prehen e tij", Sokol Zhegun të gjakosur, lidhur me pranga, me roba të shqyra e të shpërfytyruar. Me një cinizëm xhelati ai i drejtohet bashkëshortes së Sokolit duke i thënë: "Po reagove, ti dhe djali do e pësoni si ky!"

Sokol Zhegun të gjakosur, lidhur me pranga, me roba të shqyra e të shpërfytyruar. Me një cinizëm xhelati ai i drejtohet bashkëshortes së Sokolit duke i thënë: "Po reagove, ti dhe djali do e pësoni si ky!"

policisë Mynyr Muça, ku më pas të shoqëruar me mbi 30 policë, e nisën për në banesën ku jetonte ai dhe familja. Me të ardhur tek rrugica e shtëpisë në Rugën "Myslym Shyri", shefi i policisë së rendit urdhëroi rrethimin dhe bllokimin e rrugëve që kalonin tek banesa që do të "bastisej" duke ndaluar deri dhe qarkullimin normal të mjeteve dhe njerëzve. Më pas ai sëbashku me shefin e krimeve Ermal Lila dhe inspek-

LAJME SHKURT

■ Krujë, furgoni vret kalimtarin

Një person ka humbur jetën gjatë orëve të mbrëmjes së djeshme si pasojë e një aksidenti automobilistik. Aksidenti është shënuar në aksin rrugor Tiranë-Krujë, në fshatin Arrameras. Si pasojë e aksidentit ka mbetur i vdekur Edmond Plepi nga fshati Arrameras i cili po kalonte rrugën. Kujtim Vranja, i cili ka aksidentuar për vdekje Plepin është shoqëruar në polici. Ai drejtonte një furgon me targë AA 844 BC. Mësohet se Plepi është transportuar menjëherë drejt Spitalit Usharak, por nuk ka mundur të mbijetojë. Policia në vendngjarje ka nisur hetimet dhe pritet të zbardhë shkaqet reale të aksidentit.

■ Pranga 28-vjeçares për kallëzim të rremë

Një vajzë 28-vjeçare është arrestuar nga policia e Gjirokastrës pasi akuzohet për kallëzim të rremë dhe falsifikim dokumentesh. Brunilda Goga, lindur dhe banese në Berat është ndaluar mbrëmjen e së premtes nga policia e Gjirokastrës. Ajo ishte shpallur në kërkim, pasi gjykata e Gjirokastrës e ka dënua me një vit burg për veprën penale të "Kallëzimit të rremë dhe falsifikimit të vulave, stampave, formularëve dhe pasaportave". Vendimi i gjykatës është dhënë më datën 12 nëntor 2012. Goga, në vitin 2008 ka bërë kallëzim të rremë kundrejt një qytetari nga Delvina për trafikim të saj në shtetin grek nga ky shtetas për prostitucion. Ndërsa falsifikimi i dokumenteve është bërë për të kaluar në shtetin grek.

■ Tepelenë, arrestohet i kërkuesi nga Tirana

Një person i shpallur në kërkim për tentativa vrasjeje është arrestuar paraditen e djeshme. Bledar Bilo Jaupi, 28-vjeç, i njohur ndryshe me emrin Sami Gjella, banues në Tiranë është arrestuar nga policia e Tepelenës. Jaupi është dënua me 29 mars të vitit 2011 me "arrest me burg" nga Gjykata e Tiranës. Prej disa kohësh, Jaupi fshihej në fshatin Damës të Tepelenës. Pas identifikimit të vendndodhjes së tij, policia e Tepelenës, në bashkëpunim me policinë e Tiranës ka bërë të mundur arrestimin e tij.



Komunat Frakull dhe Levan, në Fier 10 ditë pa drita

Problemet me energjinë elektrike përveç kryeqytetit vazhdojnë të kenë edhe në qytet e tjera të vendit. Në komunën Frakull dhe Levan të Fierit më shumë se 30 mijë banorë vuajnë prej dhjetë ditësh mungesën e energjisë elektrike. Shkak për këtë është bërë dëmtimi dhe rënia në tokë e një shtyllë të tensionit të lartë. Banorët furnizohen nga një linjë dytësore, por me kufizime

drastike. Kryetari i komunës Frakull, Viktor Cervanaku ka pohuar se gjendja është e vështirë. Sipas tij është njoftuar CEZ për të riparuar dëmin, por nuk ka ndërhyrë me pretendimin e mungesës së bazës materiale. Në mbështetje të banoreve të komunës Frakull dhe Levan ka qenë edhe deputeti i opozitës Arjon Mucaj, sipas të cilit, mungesa e energjisë nga CEZ-

shpërndarja po shkatërron jetën e shqiptareve. Ndërkohë, që sipas CEZ-shpërndarjes riparimi i shtyllës së tensionit të lartë nuk është bërë për shkak të terrenit shumë të vështirë në këto zona, proces i cili pritet të zgjidhet deri me 17 dhjetor. Mungesën e energjisë elektrike këto kohë të fundit është bërë problem shqetësues për shumë banorë.

Lajmi

Banorët e Selitës së Vogël, kanë 10 ditë pa drita. Kjo gjë ka bërë që banorët e kësaj zone të igrirohen derisa sa të ngrihen në protestë. Banorët shprehen shumë të shqetësuar dhe për faktin se nuk e dinë arsyen përse u kanë fikur dritat. Por, veç faktit të mos pasurit drita në këtë zonë ka edhe mungesë të infrastrukturës rrugore.



Në foto: Rrugët e pakalueshme nga balta në zonën e Selitës në Tiranë



Lagjia periferike e Tiranës në varfëri ekstreme

Selitë: Banorët do të protestojmë për dritat

Rrugë të prishura, pa ujë dhe bukë me listë

■ ■ ■ TIRANE

JONIDA LATE

Banorët e Selitës së Vogël në Tiranë, prej gati më shumë se një jave vuajnë mungesën e energjisë elektrike, e cila ka sjellë edhe mungesën e ujë në familjet e kësaj zone. Banorët e kësaj zone janë shumë të irrituar nga ky fakt. "Ne kemi 10 ditë pa drita. Një javë më parë na i ndërprisnin me shkëputje të vogla, p.sh na fiknin 15-20 minuta, pastaj na i sillnin sërish, qëndronin tre deri katër orë pastaj fikeshin përsëri. Ndërsa këto dy, tre ditët e fundit na i kanë ndërprerë edhe me orare të zgjatuar duke na i fikur 3-4 orë në ditë madje edhe më shumë. Kurse një ditë para se të ndodhte protesta nuk kemi pasur gjithë natën drita", shprehet Bardha Gega, banore e Selitës së Vogël. Por, banorët e kësaj zone janë më tepër të shqetësuar edhe për faktin se nuk e dinë përse po u ndërpritet energjia elektrike.

"Ne jemi të rregullt me faturat i kemi paguar ato. Nuk kemi lënë muaj pa paguar. Nuk e dimë pse na i ndërpresin, asnjë nuk na shpjegon ashtu si duhet arsyen e vërtet. Këta të CEZ-shpërndarjes na thonë se ka defekt. Por nuk e dimë të zgjas kaq shumë defekti, nuk është parë"-ankohet Mimoza Karaj një prej banoreve të Selitës së Vogël. E pyetur se si ja bëjnë pa drita e shqetësuar Mimoza na tregon se "E kemi shumë të vështirë pa drita, për ngrohe bëjmë si bëjmë se ngrohemi me gaz. Por edhe atë natë e nxjerrë jashtë se kam frikë nga shpërthimi, pastaj vjen edhe ere. Ndërsa të vështirë e kemi për ujë, pasi kur nuk ka drita nuk ka as ujë. Edhe ujë i ngrohet është problem, dushi nuk ka me çfarë të ngrohet. Pastaj me fëmijë të vegjël edhe me pleq në shtëpi vështirësia është më e madhe. Elektro sh-

tiëpiak nuk na janë prishur, por ç'e do i mbajmë për bukur në shtëpi". Banorët thonë se pasi kanë protestuar u erdhën dritat vetëm pak orë dhe u janë fikura sërish. Dje para se të protestonin nuk kishim drita, i sollën vetëm pak orë pas protestës dhe na i fikën sërish. Nuk e dimë përse na i fikën dhe cila është arsyeja pasi faturat e energjisë elektrike i kemi paguar rregullisht" ankohet E.D banor i Selitës së Vogël. Kurse një qytetare e tjerë na thotë: "Nuk kemi as drita as ujë, me fëmijë të vogël jam. Jemi tharë së ftohti këto ditë pa drita. Gazin nuk mund ta ndezë dot sepse e



Protesta e dy ditëve më parë në Selitë për energjinë elektrike

kam gocën e vogël dhe gazi e rëndon shumë ambientin". Banorët shprehen se nëse problemi me energjinë elek-

trike do vazhdoi të jetë ata nuk do ti ndërpresin protestat. "Nëse do vazhdojmë të kemi problem me energjinë elek-

trike ne nuk do i ndërpresim protesta. Madje do i përshkallëzojmë më shumë, sepse jemi këthyer vite pas. Jemi në vitin 2012 dhe të vuajmë ende mungesën e energjisë elektrike, i cili është kushtit më minimal për të jetuar vetëm këtu te ne ndodh" thonë banorët.

RRUGËT ME BALTË

Sa po hyn në për në zonën e Selitës së Vogël, ajo që të bie më tepër në sy janë rrugët e kësaj zone të shkatërruar me baltë që është prezente në çdo rrugicë të saj. Banorët shprehen të shqetësuar për këtë fakt "Të gjitha na mungojnë ne

këtu, drita nuk kemi, rrugë nuk kemi. Balta na ka ardhur te dera e shtëpisë. Tani në dimër kemi problem me baltën në verë me pluhurin" ankohet një banore. "Për të kaluar nëpër rrugët e Selitës duhen çizme peshkatari, se për ndryshe mbetesh në baltë, këpucët dhe atletet në dimër këtu nuk të bëjnë punë. Gjatë gjithë dimrit edhe kur nuk ka shira rruga gjithmonë këtu është me baltë. Vetëm kur pushojnë shirat në maj-qershor nuk ka baltë" na thonë banorët e Selitës së Vogël. Të pyetur nga "Shqiptarja.com", se çfarë u kanë thënë për rrugët banorët shprehen: "Na kanë thënë që do na i rregullojnë rrugët, por deri tani nuk kemi parë ndonjë ndryshim. Unë kam gati 5 vite që jetoj këtu dhe asnjë gjë nuk kam parë të rregullohet. Politikanët na thonë që do jua u rregullojmë, por deri tani nuk kemi parë asgjë. Ata vijnë këtu vetëm për para zgjedhjeve, pastaj harrojnë se cila është Selita e Vogël" thonë banorët të indinjuar.

NË VARFËRI EDHE BUKA ME LISTË

Qytetarëve të Selitës së Vogël përveç se i mungojnë dritat, uji dhe rrugët, janë të zhytur në varfëri ekstreme. Nëpër dyqanet e kësaj zone lista e borxheve është shumë e gjatë. Njerëzit aty vuajnë edhe për bukën e gojës "Lista e borxheve këtu tek unë është e gjatë. Unë kam vetëm një dyqan të vogël, me pak produkte dhe vetëm tek unë njerëzit që banojnë këtu pranë dyqani time kanë dy deri në tre milionë lekë borxhe" na tregon Bardha Gega, pronare e një dyqani të vogël. Produkte që u mungojnë më tepër këtyre banorëve janë ato të konsumit të përditshëm buka, djathi, veza, qumështi etj. "Edhe bukën vijnë edhe e marrin me listë, imagino të tjerat. Këtu njerëzit nuk kanë bukë të hanë. Më vjen keq, mos tu jap shpesh herë dërgojnë fëmijët për të marrë bukë, vezë, qumështi. A mund të lësh një fëmijë pa bukë?" na thotë shitësj. Ndonëse janë të zhytur në varfëri ata kurrë nuk harrojnë ta paguajnë borxhin që kanë edhe pse me vonesë "I paguajnë gjithmonë lekët sa herë që marrin rrogat. Marrin rrogën vijnë i paguajnë, por përsëri pasi një javë vijnë dhe i marrin ushqimet me listë. Më parë i vononin deri në 10 ditë, por këto dy tre vitet e fundit e lajnë borxhin edhe pas një muaji ose dy muaj" tregon shitësjja në një bisedë me të.

Mungesa e dritave

Banorët protestë edhe dy ditë më parë

■ ■ ■ TIRANE

Vetëm dy ditë më parë qytetarët e zonës së Selitës së Vogël në Tiranë kanë protestuar për rreth 1 orë, për mungesën e energjisë elektrike e cila u mungonte në banesat e tyre prej 10 ditësh. Qytetarët në protestë shprehen shumë të indinjuar pasi kanë më shumë se 1 javë pa energji elektrike. Ata gjatë protestës u vendosën zjarrin koshave të mbeturinave, por dogjën edhe goma duke përdorur benzinë. Në Selitën e Vogël kanë mbetura pa energji elektrike një mijë familje për më shumë se 1 javë. Gjatë protestës se të premtes në Selitën e Vogël ishte edhe deputetja e Partisë Socialiste, Eg-lantina Gjermeni, në mbështetje të qytetarëve. Kurse kompania CEZ-shpërndarja nga ana e



Protestat për energjinë elektrike

saj sqaron se ne Seliten e Vogël janë djegur dy transformatorë dhe një prej tyre i zëvendësuar te enjten, nuk ka mundur te mbaje dot ngarkesën, ndaj po shikohet për një zgjidhje tjetër. Kompania sqaron gjithashtu se 70 përqind e banoreve te kësaj zone, janë debitorë, çka e vështirëson zgjidhjen e shpejte. Ndërsa të enjten protesta për mungesën e energjisë elektrike ka pasur edhe në zonë e Laprakës dhe të rrugës së Kavajës, ku qytetarët e këtyre zonave protestuan për shkak se në banesat e tyre kishte tre ditë që mungonte energjia elektrike. Ata bllokuan rrugët dhe u vendosën flakën kanzave të plehrave. Por, problem me mungesën e energjisë elektrike nuk ka pasur vetëm në Tiranë, problem ka pasur edhe në qytete të tjera, si Kruja, Tepelena, Lushnja dhe Fieri.



80-vjetori

RRËFEHET aktorja e famshme Tinka Kurti në pragun e ditëlindjes. Udhëtimi drejt Kanadasë për të festuar me të birin dhe nipërit 80-vjetorin e lindjes

TIRANE

ZENEPE LUKA

Nderi i Kombit Tinka Kurti mbush 80 vjeç. Aktorja e madhe kalon festën tek i biri në Kanada, ndërsa përcjell emocionet e festës në këtë intervistë ekskluzive. "Unë jam aktore e Shkodrës. Atje kam dashurinë e dhimbjen, mallin dhe pengjet e mia". Kaluam një natë bashkë në shtëpinë e aktore së madhe Tinka Kurti dhe mëngjezi do të na gjente mes bisedave të pafund, kujtimesh e emocioneve, ku shpalosej jeta, karriera, pasionet, krenaria dhe brenga e njëjës prej jëve të artit shqiptar. Ishte prag ditëlindjeje dhe aktorja e famshme do të udhëtonte drejt Kanadasë, për të festuar me të birin dhe nipërit 80-vjetorin e lindjes. Nga biseda jonë e gjatë, shpallim vetëm disa momente, duke ia përcjellë lexuesit si urim artistes së madhe, duke përkujtuar ditën e 80 të lindjes së saj.

MË 17 DHJETOR TINKA KURTI MBUSH 80 VJEÇ

Aktorja e madhe shqiptare Nderi i Kombit, Tinka Kurti, më 17 dhjetor, mbush 80 vjeç. Lindi në Sarajevë, më 17 dhjetor të vitit 1932, ndërsa në skenë do të ngjete për herë të parë në moshën 14 vjeçe. Që nga vitit 1949 ajo është aktore e Teatrit "Migjeni" në Shkodër, ku interpretoi mbi 120 role. Aktorja shkëlqen në role protagoniste si tek "Gjaku i Arbërit", "Histori Irkutase", "Toka Jonë", "Fisheku në pajë", "Fejesa e Çehovit" etj. Tinka Kurti ka interpretuar mbi 35 role edhe në kinema, duke startuar me filmin e parë me metrazh të gjatë shqiptar "Tana", në vitin 1958. Rruga e saj artistike fiksoi në historinë e kinematografisë shqiptare rolet e spikatur si në "Pashako tek filmi "Yjet e netëve të gjata" në vitin 1972, Nëna tek filmi "Çifti i lumtur" në vitin 1975, Sinjorina Mancini tek "Vajzat me kordelle të kuqe" (1978), Gjyshja tek "Zemra e nënës" etj. Gjatë karrierës së saj ka marrë një varg çmimesh. Është bërë Artiste e Popullit në një moshë fare të re, ndërsa mori titullin e lartë "Nderi i Kombit" në prag të 80-vjetorit të lindjes, akorduar nga ish Presidenti i Republikës prof. Bimir Topi. Tinka Kurti është edhe një veprimtare e shquar shoqërore, e cila përgjatë 10 vjetëve ka dhënë kontribute të shquara në Fondacionin Kulturor Mbarëkombëtar "Nermin Vlora Falaschi"

Cila është fëmijëria e Tinkës?

-Kam kujtime pafund, si çdo njeri që vjen në këtë shifër të jetës së tij. Rri e mendoj dhe kujtoj parkun, rrugicën me kalldrëm dhe ndjej në çdo çast shtrëngimin e dorës së nënës sime të shtrenjtë. Mbushem me emocione të mëdha, kur kujtoj gastet e dhimbshme, portën e shtëpisë, nga e cila dola kur isha vetëm 5 vjeç dhe u riktheva kur mbusha 65 vjeç. Shkova në dhomën për të cilën më kishte folur nëna, hungarezja Elisabetë, e cila pas lindjes kishte dalluar mes yjesh një gërmë T, dhe për këtë shkak vendosi ta quante vajzën Tinka.

Mendoni se kjo gërma kishte lidhje me të ardhmen tënde, që do të ishte një nga yjet e artit shqiptar?

-Faleminderit për cilësimin që më bëni, por

TINKA KURTI

"Nën një pemë i dhashë puthjen Naim Frashërit"

Intervista: 330 rolet, kujtime për 60 vitet në skenë dhe sheshet e xhirimit



Foto Tinka Kurti me flamurin dhe qylafin në ditën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës

Luftar Paja:

"Është një aktore me përmasa hollivudiane, pse është artistja e parë shqiptare që në filmin e parë shqiptar theu një tabu: realizoi puthjen e parë në film. Kjo tregon që i është dashur të përballojë sfidat nga më të vështirat. Për mua, Luftar Pajën, Tinka Kurti mbetet e dashura e zemrës, e tillë ka qenë dhe do të mbetet deri sa të dy bashkë të mbyllim sytë. Siç e do zakoni, një puthje dhe një buqetë lule me rastin e 80-vjetorit të lindjes, mikes sime të shtrenjtë".

ja shfaqje liberale dhe kurrë nuk e mora diplomën e aktrimit. Ishte talenti, dhuntia që më jepte natyra, që unë të bëhesha aktore. Unë jam dhe mbeten aktore e Shkodrës. Atje kam dashurinë e dhimbjen, mallin dhe pengjet e mia. Atje hodhi hapat karriera, që nisi me "Dasmën shkodrane", kur isha vetëm 16 vjeçe. Më parë kisha kënduar në kor, por regjizori kuptoi se kish të bënte me një aktore dhe nuk gaboi. Hapi i parë do të hidhej me filmin "Tana" dhe pas kësaj, jeta ime do t'i kushtohej skenës dhe filmit.

Sa role keni interpretuar gjatë gjithë jetës?

-Ju vini shpesh në shtëpinë time dhe e dini arkivin, që vazhdon të pasurohet, sepse sikurse e dini mua nuk më lënë të qetë regjizorët, më marrin edhe tani. Kam interpretuar rreth 330 role, shumica janë në dramë, por edhe në filma. Janë sëpaku 60 vite të jetës sime, që ia kam kushtuar skenës, pra e gjithë jeta. Kemi bërë një punë të madhe.

I kujtoni rolet që keni interpretuar?

-Kurrësesi nuk mund të rradhitet të gjitha,

Foto e parë: Kujtimi i vyer nga filmi i parë artistik shqiptar, duke realizuar puthjen me aktorin e famshëm Naim Frashëri tek filmi "Tana", 1958



sidoqë unë i kam të shtrenjta njësoj. Kujtoj rolet në dramën "Fejesa e Çehovit", pasuar me rolin e Files në "Fisheku në pajë", më pas të Lokes tek "Toka Jonë". Pasioni dhe dashuria për skenën më detyronte që brenda vitit të mund të realizoja 4 role. Lëvizja nga Shkodra në Vig ku xhiroheshin "5 heronjtë", nga skena në xhirim. Sfiltesha, por ndjehesha edhe e lumtur.

Cilat do të konsideroni role më të spikatura, role "të mëdhenj"?

-Unë kam pasur fatin të kem tërë kohën role parësore në skenë dhe filma, por veçoj rolin e Lokes tek "Toka Jonë", nënë Pashakoj tek "Yjet e netëve të gjata", rolin e nënës tek "Gjaku i Arbërit" dhe kështu do të përmendja një varg rolesh deri tek ky i fundit, tek "Streha e të Harruarve" shkruar nga Rruzdi Pula-ha, që u xhirua edhe film para pak muajsh.

Margarita Xhepa

Në këtë datë të shënuar Tinka vjen me një galeri rolesh të mëdha, jo vetëm nga sasia, por edhe nga cilësia. Ajo mbetet një thesar me personazhet e saj në teatër dhe kinematografi. Është një aktore me një temperament shpërthyes, sa edhe konkrete dhe e vërtetë. Tinka mbetet një artiste e palodhur, gjithmonë me kërkesa në rritje ndaj vetes, për të sjellë figura të bukura, të paharruara, duke u shndruar në një vlerë të pallogaritshme për artin shqiptar. Tinka Kurti është aktore e madhe e groteskut dhe unë ndjehem krenare që jemi një brez me të.



Rikard Ljaria

"I uroj nga zemra ime 80 vjetorin e lindjes dhe shqyr që e arriti këtë ditë. Tinka Kurti me vullnetin e saj, ka arritur të krijojë një figurë kombëtare në teatër dhe në kinema, duke u shndruar në një vlerë për artin shqiptar. Tinka është ndarë nga Shkodra prej vitesh, por ajo me inteligjencën e saj ka ditur të përfitojë nga regjizorët dhe aktorët e mëdhenj që ka Shkodra, që nga Esat Oktrova, Shllaku, Serafin Fanku, etj. Talentit, puna e saj, e shndrruan Tinkën në një Heroinë të vërtetë në fushën e artit".



Vlerësimi

FLASIN PËR TINKËN: shkrimtari Dritëro Agolli, gazetarja Sadije Agolli, regjisori Rikard Ljarja, aktorët Margarita Xhepa, Albert Vërria, Luftar Paja, Edi Luarasi, Roza Anagnosti

Dritëro Agolli: "17 dhjetori i Tinkës, si 28 tetori i Fishtës"

Sadija: Familja jonë e ka shenjtore aktoren Tinka Kurti

■ ■ ■ TIRANE

ZENEPE LUKA

Ditëlindja e 80-të e Tinkës është festë për të gjithë kolgët dhe miqtë e saj. Jeta e Tinkës që është e lidhur ngushtë me jetën e artit shqiptar dhe të atij brezi që besoj se shkruan pjesën më të artë, ata që janë vendosur në themelet e skenës dhe kinematografisë shqiptare. Dritëro Agolli thotë se "Në galerinë e madhe të artistëve të kinematografisë dhe teatrit, Tinka Kurti, është një yll, që gjithmonë, që gjithmonë do të ndritë me dritën e artit të saj, që e ka pasqyruar me aq dritë edhe kulturën tonë. Prandaj, net e gjithë krenohemi me Tinka Kurtin, që na bën më njerëzorë dhe më të dashur me njëri tjetrin në këtë botë me kaq shqetësime e tragjedi.

Ashtu edhe tani në këtë moshë, në këtë 80 vjetor, kur ne e shohim në kafe, lulishte, anë rrugë, ajo na përcjell që lloj faljeje, harmonie, por edhe optimizmin, duke na thënë: Duajeni njëri tjetrin, ore vëllezër.

Ndaj do të shtonja në këtë prononcim të shkurtër, pasi për këtë artiste të madhe dua të flas me orë të tëra, se në kalendarin e Artistëve, të ditëlindjeve të tyre, do të mbetet 17 dhjetorit, dita e 80 vjetorit të Tinkës,

ashtu sikurse si 28 tetori i Gjergj Fishtës, sikurse 13 tetori i Migjenit të madh. Agolli i ka urura në mënyrë të familjes, të miqve dhe artdashëve shqiptarë Tinka Kurtit: "Jetë të gjatë dhe gjithmonë të jetë e re, ashtu si arti që ka bërë ajo". Ndërsa bashkëshortja e shkrimtarit, gazetarja Sadije Agolli tha se: "Unë jam rritur me rolet e Tinka Kurtit dhe kujtoj me nostalgji që shkonim në teatër, kur mësonim se do të interpretonte Tinka. Familja jonë e ka si shenjtore aktoren e madhe, pasi gjatë gjithë karrierës së saj ka dhënë role, që kanë emocionuar artdashësin. Kujtoj kur kam qënë në Pirg të Korçës, kam takuar nënë Pashakon, që fliste me simpati të madhe për Tinkën, sepse e kishte mëshiruar në nivelin më të lartë rolin e nënë Pashakos. Është një artiste që i ka bërë ndër teatrit dhe kinematografisë shqiptare."



Në një ditëlindjet të Dritëro Agollit duke prit urimin e aktoreve. Me Sadijen dhe Drita Pelingun

Frashërin?" Për mua është një nga momentet më të bukura të karrierës sime si aktore, jo vetëm se kam partner një aktor të madh, porse isha një aktore e vërtetë, që shkela çdo bestytni për të realizuar rolin. Dhe këtë nuk e bënte çdo femër aktore.

Çfarë do të vlerësonit si ngjarje të veçanta në jetën tuaj?

-Nuk kanë të numëruar, është e pamundur të rreshtoj disa prej tyre, por po kujtoj fjalën vënia e emrit tim në kinemanë verore në Plazhin e Durrësit. U mbusha me emocione, pse jo vetëm ndjehesh e vlerësuar, por edhe për faktin se kur ceremoni të tilla bëhen kur je gjallë, gjë që nuk është traditë në vendin tonë, emocionet janë të shumfishta. Emrin tim e mban edhe shkolla e mesme e Lekbibajti, ku nuk mungoj të shkoj. Ndjehem krenare, jo vetëm se ndodhet në trevën ku unë jam rritur dhe kam dhënë kontributin tim si artiste, por më tepër sepse shkolla e këtij fshati është çelur nga Luigi Gurakuqi. Ajo ditë ishte e paharruar për mua. Tingujt e lahutës më kumbojnë në vesh tërë kohën. Pas ceremonisë u

bë një koncert i vogël. Një lahutar ia nisi këngës duke e shoqëruar me instrumentin që e përdorte mjeshtrërisht e duke kënduar me zë të lartë. Kujtoj rreshtin e parë... "Tinka Kurti, nderi jonë, Tinka jonë sa malet të rrojë."

Duke u ndalur në këtë pikë dua të them se i madhi Kadri Roshi iku dhe nuk e përjetoj një emocion të tillë. Unë nuk ndiej privilegj pse më bëhet për së gjalli, por vlerësoj dhe u jam mirënjohës të gjithë atyre që vlerësojnë karrierën time si artiste. Çast i paharruar do të mbetet për mua, kur bashkë dhe me kolege të tjera, që jemi në përbërje të Fondacionit "Nermin Vlora", ishim të pranishme në ditën e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Ishte një ditë e acartë, por që na ngroh shpirtin, ishte një ditë e shumëpritur. Kam fiksuar në foto çastin kur një shqiptar i ardhur nga Australia më vendosi një qylaf në kokë dhe

më mbështolli me flamurin e Kombit. E kam të shtrënjë atë foto. Dua të përmend edhe diçka tjetër të bukur, emocionuese, që tekta udhëtoja me avion në lartësinë 8000 metra, kur shkonim në Stamboll në kuvendin e 7-të të gruas së shquar që organizonte Fondacioni Nermin Vlora", festa përfshihe edhe 75-vjetorin e lindjes sime.

60 vite në skenë dhe sheshet e xhirimit. Si i ruani kujtimet?

-Janë aq shumë, sa kur i përmend dikush do të shprehë: "Ç'ja fut rrenës kjo Tinka" (qesh). Një të vërtetë gjysmat i kam mbyllur nëpër valixhe. Kur i shfletoj ndonjëherë, më kujtohet e ndjehem nëna ime, që i thoshte sime motre, Pinës (mjeshtrë sporti): Martohu Pina, se me vete do të marrësh një valixhe me medalje e kupa". Kjo është pasuria më e çmuar për njeriun. Edhe për mua do të duhej një kalë për të transportuar këtë "barrë" medaljesh dhe vlerësimesh që janë bërë në kohë të ndryshme.

Si e kaloni kohën e vetme?

-Djali im jeton larg, por unë e kaloj ditën mes artdashësve, vargu i të cilëve nën sapo hedh shkallët e pallatit tim. Telefonata të pafundme më urrejnë dhe më pyesin për shëndetin. Me kolegët dhe shoqet e skenës kalojmë një kohë të rëndësishme bashkë. Sigurisht, të ngryshes dhe gdhiesh vetëm nuk është e lehtë, por ja që emigrimi ma mori djalin e vetëm. Sikurse e shihni, unë kam një shpëtim të theksuar, pa komeditetin e kohës, por zonja e saj është një artiste që ka sakrifikuar për të lënë si pasuri 110 vite punë. 60 vjet në teatër dhe 50 vjet në kinematografi. Ndaj them që kjo shtëpizë e varfër, të mbetet një muze i pasur. Është, e vetmja pasuri që kam në këto 110 vite punë e sakrificë. Ia kam lënë amanet tim biri që kjo banesë të jetë derëçelur përjetësisht. Aty do të evidentohet "pasuria" ime, vlerësimet, fotot, kasetat e CD me filmat e mi, veshjet të roleve.

Tinka Kurti ju jeni artistja e parë që realizuat puthjen në film, madje në filmin e parë shqiptar. Si e keni përjetuar?

-Kjo më bën krenare. Nuk pata asnjë hezitim kur tek filmi "Tana", nën një pemë i dhashë puthjen partnerit tim, aktorit të madh Naim Frashëri. Është puthja e parë në historinë e filmit shqiptar dhe kjo më bën të ndjehem vërtetë mirë. Ishte koha e tillë, mentaliteti që pengonte për të realizuar skena të tilla. Megjithatë, edhe pse isha shumë e re, pasioni e bën aktorin të interpretoj edhe skena të tilla, që tashmë janë të zakonshme. Sigurisht që nuk ishte e lehtë. Madje ju them se për të bërë atë puthje, na u desh të realizonim 29 dubla dhe fatkeqësisht skenën e hoqën më pas. Zemërohem me vete dhe them: "Mirë atëherë që nuk lejonte koha dhe regjimi, po sot, përse nuk jepet puthja ime me Naim

Roza Anagnosti

Tinka është një aktore e shkëlqyer, me të gjitha parametrat, si zërin, plastikën, shikimi e gjithçka. Unë kam pasur një role me Tinkën tek "Nora", ajo ishte një nënë, që shpalosi një karakter, më pas ajo ishte Zyrakja, unë isha Rina. Për mua ishte një shans i madh që kasha në krah një aktore të madhe si Tinka Kurti, që më ka frymëzuar gjatë gjithë karrierës time. Ajo është një gur i rëndësishëm në themelet e Teatrit "Migjeni", por edhe e kinematografisë shqiptare. Tinka Kurti qëndron në krah të Naim Frashërit dhe Kadri Roshit me rolet e saj.



Albert Vërria:

"Tinka Kurti 80 vjeç? E pabesueshme! Ajo mbetet gjithmonë një vajzë e re, shumë vitale, që nuk rresht duke interpretuar role. Për talentin dhe vlerat e kësaj aktoreje të madhe, flet skena, flasin rolet, karriera e saj brilante. Para se t'i urrej 80-vjetorin, unë dëshiroj të shpreh edhe dy dëshira të mia për të. E para, që Tinka Kurti ta mbyllë karrierën e saj në skenë duke interpretuar rolin e Ledi Makbethit dhe tjetra që është private, të më lejojë ta puth me mall, miken time që e kam adhuruar të re, por edhe 80-vjeçare."



Depozita me afat **Alpha SMILE**

DHURATA JONË PËR JU

Me depozitën me afat 3 muor Alpha Smile, ne do t'ju bëjmë të buzëqeshni duke ju ofruar 4 dhurata rradhazi!

Alpha Smile është depozitë me afat 3 muor e cila ofron interesa të larta dhe mundësi rinovimi të depozitës suaj edhe 3 herë të tjera brenda vitit me të njëjtën normë preferenciale interesi.

Gjithashtu ju ofron komision **Zero*** për transfertat në mbërritje në Euro.

Alpha Smile
Dhurata jonë për ju.



Norma preferenciale interesi: 5.75% ALL | 4% EURO | 2% USD

*Oferta është e vlefshme deri më 15 Janar 2013



ALPHA BANK

☎ 042 240 477 🖱 www.alphabank.al

RILINDASI

Viti II - Nr:49

E diel, 16 dhjetor 2012

Kryeredaktore: Admirina PEÇI

Na ndiqni
edhe
online

www.shqiptarja.com

POEMA E FUNDIT E PERIKLI JORGONIT

Elida: E shkroi për Lukë Kaçajn, një natë para aksidentit

Roland Gjoza

K ishte qenë mik me Jorgo Billacin. Mik me Petraq Kolevicën. Mik me... të gjithë. Një ditë, andej nga '80-ta, më lexonte një poemë të Bajronit, "Gjauri". Më pëlqeu shumë, kish të mjaft freski, mund të rend për të thyer limën në të. E pikasi emocionin tim që bëri bojë dhe qeshi. E ka përkthyer Aurel Plasari... po nuk shtoi asgjë tjetër. Ishim në shtëpinë e tij, andej lart nga Kinostudioja, një dykatëshe me tullat, e pasuatuat. Jetonte mes një rrëmuje që më fort i bënte hije vetmisë së tij. Ishte divorcuar me gruan. Dhe pasqyrën e kishte të thyer. Krevati kishte një pështjellim prej njeriu që nuk e ka aleat gjumin. Kryet vezullimtar me një prirje për të pahësuar ballin, sytë e ëmbël ose me saktë ëmbëlakë ngaqë dukej sikur buronin me tepri mirësi, sytë e errët, kur të turrej për të dhënë një mësim të vësh-



Në foto:
(Majtas)
Perikli
Jorgoni
(Djathtas)
Perikli
Jorgoni me të
shogën
Elida
Jorgoni



tirë arti dhe ti ishte një kungull farës, po veçanërisht ajo bluja e ndritshme e tij me shumë diell që jepej thjeshtë për t'ia davaritur miku atë vetminë me akull Antarktide. Por kurrë nuk ia kuptoj lëngatën e vetmisë, sepse ai rronte në atë sferë që s'ka të bëjë as me bukën as me gjellën e sapo shtruar në tryezë, e cila i mungoi, po me shujtën e Apollonit, e kish të gjetur me kohë vrimën e Lizës dhe futej pa biletë në vendin e portëve të vdekur, poetëve më të mëdhenj që ka njohur njerëzimi. Ai kishte punë me Gëten, Shilerin, Holderlinin, Niçen, Emineskun, Safon, Seferis, Kavafis, Elitis, Rilke, Lorka, Jirzhi Volker etj. Në përkthimet e tij të përkora ndihej zhërvjelltësia e një mjeshtri valse me patina akulli.

Periklio ishte klasi i fundit finis, bohemi i shkëputur prej kohëve dhe moraleve të bekuara familjare, ai, aq shumë u dashurua me Faust...
vijon në faqen 14-16

KUJTIMET/ "Tirana më mbyt, në Durrës prek qetësinë"

Suzana Varvarica Kuka

I shoh lajmet kulturore të gazetave në internet dhe këtë e bëj në një orë të mëngjesit të vonë. Dje, me 14 dhjetor, këtë veprim të zakonshëm e bëra më

vonë se përherë dhe u trondita shumë kur pashë se profesori që njihje mbin dhjetë gjuhë të huaja dhe përkthyesi, Perikli Jorgoni ishte ndarë nga jeta, prej një aksidenti banal dhe fatal. U ndjeva keq, u trishtova jashtë mase, dhe

mendova sikur isha ai tjetri, njeriu i pajetë, Perikliu, që nuk e mendonte se jeta është çdo ditë bashkëdhënëse e aksidentit, e së papriturës, e cila të ndan lehtësisht nga të gjitha gjërat që kë nisur të bësh...
faqe 18

Prej 1000 vjetësh... Kodiku i Korçës nr. 93 në një botim dinjitoz

Botimi përbëhet nga tre vëllime: Kodiku i riprodhuar në faksimile, vëllimi dy gjuhësh shqip e greqisht me transkriptimin, studimin dhe përkthimin në gjuhën shqipe të ungjillit sipas Lukës, si dhe studimin në gjuhën angleze

Prof. Dr.
Aleksandër Meksi

Nisma për botimin tërësor të katërngjillit të Korçës në faksimile, transkriptimin, studimin përkatës dhe përkthimin në gjuhën shqipe, duhet të vlerësohet si një ngjarje kulturore me rëndësi të veçantë, që duhet të pasohet me të tjera të kësaj natyre. Ky botim i përbashkët i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe i Shoqërisë Ndërkonfesionale Biblike të Shqipërisë, nga ana e studiuesve Andi Rëmbeci e Sokol Çunga, nën mbikëqyrjen shkencore të profesor Agamemnon Celikas, është një kontribut

me shumë vlerë për shkencat shqiptare, që na jep mundësinë të njohim më mirë dhe me një kontakt të drejtpërdrejtë - si me një dokument shkencor, këtë Kodik katërngjillor të ruajtur deri vonë në Mitropolinë e Korçës.

Botimi luksoz dhe dinjitoz i kësaj veprë përbëhet nga tre vëllime të veçanta: Kodiku vetë, i riprodhuar në faksimile besnike e origjinalit, vëllimi dy gjuhësh shqip e greqisht me transkriptimin, studimin dhe përkthimin në gjuhën shqipe të ungjillit sipas Lukës, si dhe studimin në gjuhën angleze. Në këtë mënyrë kjo pasuri i bëhet e njohur gjithë botës shkencore dhe të interesuarve për të...
faqe 17



Ismail Qemali i Eltion Valles, portreti që porositi familja Vlora

Larg zhurmës institucionale, larg fetishizimit mediatic, ka qenë vetë familja Vlora që e ka porositur këtë portret, e pakënaqur nga përshfaqjet e deritanishme të kësaj figure sa të nderuar aq edhe të shfrytëzuar...
faqe 20

Kongresi i Drejtshkrimit, debatet prapakthim e verbëri

A kanë mbetur jashtë këtij fjalori fjalë të gegërishtes? Natyrisht se kanë mbetur. Dhe kanë mbetur jo vetëm të gegërishtes, po edhe të toskërishtes, edhe të të folmeve të tjera të të gjithë arealit shqiptfolës...

Shefkije Islamaj

Kongresi i Drejtshkrimit dhe çështje të leksikut

Nëse drejtshkrimi është fusha e normuar më me rreptësi e gjuhës standarde, leksiku është fusha më së lirshmi "e normuar". E nisëm kështu për të përfshur tezën që do të përvijohet në këtë kumtesë e cila jo vetëm vërteton një fakt të gjithënjohur, por lejon edhe mundësinë për t'iu kundërvënë atyre që thonë se Kongresi i Drejtshkrimit i bëri një padrejtësi të madhe e të palegueshme leksikut të dialektit verior, dialektit gegë, dhe se kjo u bë për qëllime thjeshtë politike dhe të tjera. Sot pas 40 vjetëve nga Kongresi i

Drejtshkrimit, i cilësuar nga mendjendriturit si ngjarja më e madhe kulturore në jetën e shqiptarëve përgjatë shekullit 20, diskutimi për vlefshmërinë e standardit për shqiptarët, diskutimi për vlefshmërinë e rrugës që është ndjekur për këtë standardizim dhe, më në fund, edhe diskutimi për përmbytjen e mospërmbytshjen e funksioneve komunikuese në të gjitha rrafshet nga ana e këtij standardi, shikuar nga perspektiva e së tashmes dhe e së ardhmes së shqiptarëve, duket jo vetëm prapakthyes, por më shumë se kaq, verbëri dhe mospasje vizioni për ecjen e shqiptarëve bashkë në kohën që po vjen...
faqe 18

IN | MEMORIAM

Roland Gjoza

vijen nga faqja 13

...bie fjala, sa, për t'iu bërë mik (se ai e kishte këtë merak, pa tu bërë mik nuk krijonte kurrfarë marrëdhënie me ty) shtynte kohën, mënyrën e jetesës, veset, ritualet njerëzore drejt atyre caqeve që kishin perënduar, gjithsesi për tu përshtatur me vdekjet grandioze. Pikërisht ngaqë kishte të bënte me të ikurit e mëdhenj, shenjat e vërteta ngushëllimtare për ta shtyrë njëfarësoj këtë jetë sizifiane, shpesh pa kuptim, dinte të krijonte ekuilibrin me zgjuarsinë dhe fuqinë e tij prej titani që ia kam njohur për së afërmi, paraqitej ne shoqëri si një i ftuar në një darkë të shquar, ku prej rendësisë që i jepte vetes, bënte kinse sikur po shkonte me pak vonesë. Ishte ashik i vetvetes, i trupit të tij. Shpesh kalonte nga Televizioni me atë hapin e tij të shpejtë, me çantën sportive mbi shpinë, përherë të mbushur tej mase, të shqyer vende-vende dhe kërkonte me sy miqtë. Pero, e thërrisja unë dhe e ftoja te Pergola, me pjergullat e rrushit kokërrmadh mbi tryeza. Vinte i biri i Fatos Kongolit që punonte kamerier atje me një tabaka në duar e me një palë gërsërë të mëdha dhe këpuste bistakë me rrush me një cipë veshulllore përsipër prej djersës mjaltoze. Ndërkaq, Perikliu mbushte duart me rrush dhe ai nuk i thoshte kurrëgjë, vetëm buzëqeshte dhe menjëherë bëheshin miq. E, c'kemi? e pyesja. Erdha të jap lajmin, thoshte me atë syrin prej satiri, përplot shndërritje gëzimi dhe ironie të mëshirshme. Hapte çantën dhe nxirrte një libër të Rilkes gjer-manisht. Po e përkthej, është ngjarje. Ikte papritur e vinte një ditë tjetër përsëri me atë fytyrë të qeshur, të kthyer nga dritaret e televizionit të mbushur me dokrra të përditshme, me supën e ushtarit të frontit politik. I shkrehte topat e mëngjesit? Ja, po bëjmë gati ato të drekës, i përgjigjesha. Gjithsesi e qeshura e tij s'kishte asgjë të keqe, përveç mëshirës, ngaqë ai e kishte mendjen tërësisht te librat që mbante në çantën e shqyer. Ç'ke atje? e pyesja. Ah, ngjarje botërore, Roland, po përkthej Niçen. Nxirrte librin dhe ma tregonte me atë djersë që e mbulonte menjëherë prej emocionit, ndërsa humba e ballit i shkëlqente, shoga, i llamburiste dhe sikur jepte e merrte me shkëlqimin lëbryrës të syve të tij blu që i kishin të gjitha dritat e jetës. Ishte i fundmi përkthyes i klasikeve, i poetëve të pavdekshëm, që kurdoherë sfidojnë modernitetet. Ishte mjeshtri i metrave poetike, i fjalës së zgjedhur shqipe, i asaj hollësisë që qendron te qëmtimi intuitiv, i ritmit dhe rimës levorashë. Ishte besniku më i madh i vargut të papërsëritshëm, magu i së papërsëritshmes që e nënshtroi me gjuhën e bekuar shqipe. Dhe asnjëherë nuk e ftuan në studiot politike ku mikrofonat ishin kthyer me kohë në topa artilerie. Ne ato studio gjallonte fama e ditës, fama e dyshimit e vipit të javës. Aty krekoseshin gjetat e parlamentit dhe pulat e spektakleve të kopjuar me dorë të lirë. S'kishte vend për zeje kaq të holla, për mjeshtri mjeshtrërisht, po vetëm për shtijare që e sillnin bojën me vete. Edhe njëherë që e përpoqa ta fus bren-



6 Prill 2011. 100 vjetori i ngritjes së flamurit shqiptar në Bratille të Deçiqit



Në foto: 14 tetor 2011 ne Kolesia / Kukes Perkujttohet 100 vjetori i shkollës së Kolesianit ne Kukes, Petro Luarasi, Blerina Spahiu, Perikli Jorgoni, Islam Spahiu

da, emisioni ishte blerë prej një karagoji që donte të shpallej i famshëm që me librin e parë. Nuk e gëzoi këtë fat Perua ynë, veç bariti poshtë atij dinozauri që e pa si një mizë. Pastaj ajo dita, më e trishtuara ditë që s'e heq dot nga mendja; Perua ngeci, kur e pyeta: C'kemi ndonjë të re? Aq u hutua sa unë nisa ta ndjej veten fajtor. Çanta, e fryre si deng, ia kishte përkulur njërin sup, aq shumë ishte e ngarkuar me libra. U ul te Pergola, mblodhi veten. Si u qetësua, pasi mbaroi dhe kafënë, hapi çantën dhe me tregoi c'mbante brenda: jo libra, jo, jo, aspak libra, po teshat e palara. S'kam ujë, Roland, u bë një jave, s'di ku t'i laj... Asnjëherë s'kisha menduar për Peron fizik, ekzistencial, që ka nevojë të hajë, të ndërrohet, të paguaje taksat, të ngriset me një kothere e të gdhiet me një varg të punuar hollë në flakën e mekur të qiririt. Nuk u ankua kurrë. I kishte të gjitha, kështu pandeje, sepse ai kishte dinjitetin e atyre që përkthente: Gëtes, Shilerit, Hajnes, Bilokut,... dhe kurrësi

s'mund t'i tradhtonte për një cikërrimë si buka që të mungon, si teshat që s'ke ku t'i lash. Nuk kam parë njeri që t'i kushtonte trupit, fizikut, muskujve, aq shumë frymëzime spartane dhe ia zbulova sekretin, ai e kishte talent atë punë, shëndetin, i cili nuk e la kurrë në baltë. Vetëm nëpër rrugë e shikoj Perikliun, aty-këtu, tutje-diku, ne atë perpetum mobile që ia kërkonte organizmi i tij i fortë. E kishte të brendshëm hedhjen e hapit, kërkimin e miqve ashtu rastësisht, te rasteve, takimeve efemere me pak flakërimë qiriri që s'mbanin, se ai ishte gjithmonë shkaktar i prishjeve, ngaqë e kishin marrë më qafë frau Gete, madame Flober, shija e përkorrë e tyre, ai sharm shkundullues që e shndërronte te vetëmjaftueshmë në mahnitje. E kishte këtë trill, për andej, por ne ia merrnim për këndeje, të gjithë gaboheshim me të. S'mjaftonte ajo ngrohtësi që të jepte, ajo zjarrmi miku që ia ndjeje, ai harxhohej andej, netëve te dritarja e pafshirë ndonjëherë, në vetminë e plotë të një magu, shkonte e tretej

me kënaqësi për miqtë e tjerë, të gjithë miq të vdekur, po atij i dilte për të gjallët dhe të vdekurit, ca me shume për të vdekurit. Luante futboll, lahej me ujë të ftohtë, bënte gjimnastike, ishte bir i një mjeku të shquar, dinte si të mjekohej, të mbahej i bukur. Perikliu ishte i bukur, kishte prerjen e statujave te heronjve të Praksitilit, kishte diçka nga antikiteti paraqitja e tij prej popullit të Iliadës. Perikliu e njoha më mirë kur punoja arsimtar në Pukë dhe paraqita në shtëpinë botuese "Naim Frasheri" librin e dytë me poezi: Hapësire. Shefi i poezisë ishte Isuf Nelaj, një mësues fshatrash që vargëzonte, një njeri që dukej sikur flinte në këmbë. Burë i urte, gjithmonë i frikësuar, sikur atdheut socialist pikërisht prej poezisë do t'i vinte hataja. Me thirrri në zyrë dhe më tha: Ke një bërthamë të mirë, një njëzetë poezi dhe më përmendi ato që në zhargon ne i quanim pasaportë për të kaluar libri. 70 poezitë e tjera, sipas tij, nuk vlenin. Redaktori kisha Perikliun. Ia hodhe, më tha, të pas-

Në foto: 13 mars 2011 në Durres, mbahet mesha në përkujtim të Peshkopit Fan Stilian Noli Para bustit se at Nikoll Kaçorrit. Petro Luarasi, Ali Korça, Gjon Kaçorri, Perikli Jorgoni dhe Elida Jorgoni



PERIKLI JORGONI, SI E Vitet e vetmisë, përkthimet,

Historia me Rukinën, magjepsja, bisedat, batutat e shumta dhe vargjet... Një ditë plot kujtime në Manastir...



Në foto: 17 Gusht 2011 ne kishen e Shen Merise, Elbasan, para bustit te Kostandin Kristoforidhit



NJOHA! poetët...



Petro Luarasi, Perikli Jorgoni

ka pranuar shume. C'thua, ia prita, ai kërkon të tjera si ato... Bëji, me tha, po ama të tjerat duhet të shkëlqejnë... A do të vish në Tiranë, apo jo? Roland, ia shtrojmë tek "Tymi", nja tre bërçolla për shoq, dy tre kriklla mbi fuçitë e birrave, në atë tymin këndellës ku t'i djeg sytë më fort pipëri i kuq i qoftëve... Marrim dhe qofte për inat të Isufit, qe s'di ç'është Tymi! U përpog i ziu Perikli të më fuste ndonjë cikël të dhembshur, nga ato që na bëjnë me fletë kur botohen, por s'qe e gjene. Dështoi me mua Perikliu. Dhe në ndonjë rast tjetër, ai prapë dështoi me mua. Por siç e merrni me mend këto ishin dështime të gjallësh qe iu shkollon fort dështimi, sukseset ishin gjithmonë andej, nga të vdekurit. Prandaj nuk e kishte mendjen këndej, i dashuri miku im, Perikli, se ai e kishte këtë kohën tonë vetëm për borderonë, ndërsa atë tjetër për dinjitetin e tij. Rasti do të na bashkonte të dyve në Festivalin e Poezisë në Strugë. Hotel Drim. Ai shejtan i fliste të gjitha gjuhët. Ku nuk i fuste hundët. Edhe kur dogjën flamurin tonë, siç

ndodhte atje çdo vit, ai do të protestonte me një grup shqiptarësh të Strugës, derisa flamuri të ngjitej përsëri atje në majën e shtizës përkrah flamurit amerikan. Shenjë e mirë kjo, Roland, ka për të na ecur. Por nuk na eci. Dështimi na ndiqte të dyve, po duke na përqafuar me dashuri. Ja, u shfaq ajo, Rukina brune, nje bukuri e përbindshme, që i la poetët, 120 poetë nga e gjithë bota, pa mend. Rukina të buzëqeshte, sikur të kishte dashnor. Shkruate poezi. Dihet, ato përfunduan shpejt në duart e Peros. Shkruaj për qejf, tha ajo arabisht. Dhe ai iu përgjigj në gjuhë e saj. Sa e bukur ishte! Nuk kisha pare femër më të bukur se ajo. Xhinde. Po me Peron tonë nuk shkonte fare. Ai s'donte t'ia dinte nga këto. Paraqitja treset prej fjalës, tek e fundit fjala e lidh zemrën, jo pamja. Dërdëlliste Pero dhe ajo vetëm qeshte. Po shkonim me traget për në Shën Naum të hanim dreke. Ai nuk i ndahej. Po edhe ajo nuk ndihej fare e bezdisur prej tij. Ajo dinte frëngjisht, se kishte mësuar në universitetin francez të Bejrutit,

kështu që u morën vesh me Këngët e Rolandit, të cilat ajo i dinte përmendësh. Po edhe ai ia bëri qejfin me Rembone, Preverin, Eluarin. Te dukej se edhe ajo nuk po i ndahej. Ai bablok, dyfishi i moshës së saj, me kokë të shogët, i piu para syve të mi katër shishe vere, pa u dehur. E merr vesh, më pëshpëriti, qenka gruaja e ambasadorit të Libanit në Shkup. Hiq dorë, i pëshpëriti. E pse të heq dorë, a ka pafajësi më të madhe se të flasësh për poezinë? Pero, ti kujton se ne të tjerët jemi gdhjenj, s'marrim vesh fare se ç'flitet, ti sapo i propozove. O, Roland, po të shkruarit e poezisë a nuk është akt propozimi? Atje, në skrivani, i propozojmë Muzës, këtu në Shën Naum, Rukinë që ta jep mu në lule të ballit. E kthehu dhe shihen e pestë. Ajo djallushkë vetëm i qeshte dhe e nxishte atë misterin e errët që s'dihet ç'lë pas. Prisja që Perua ynë të gremisëj diku, po ai s'donte t'ia dinte, i shënjuari dukej sikur ishte shenjtëruar në atë manastir ku të gjithë ndezem qirinj dhe ata ende digjeshin, ndërsa vera na

"Tirana më mbyt, në Durrës prek qetësinë"

Kur e pyesnin përse Perikli shkon e vjen në Durrës, e nuk rri në Tiranë. E kam dëgjuar të thotë se: "Atje e ndjej se jetoj. Ngrihen në mëngjes dhe bashkë me detin prek qetësinë. Atje jam për punë. Tirana më mbyt"....

Suzana Varvarica Kuka

Ishoh lajmet kulturore të gazetave në internet dhe këtë e bëj në një orë të mëngjesit të vonë. Dje, me 14 dhjetor, këtë veprim të zakonshëm e bëra më vonë se përherë dhe u trondita shumë kur pashë se profesori që njihte mbin dhjetë gjuhë të huaja dhe përkthyesi, Perikli Jorgoni ishte ndarë nga jeta, prej një aksidenti banal dhe fatal. U ndjeva keq, u trishtova jashtë mase, dhe mendova sikur isha ai tjetri, njeriu i pajetë, Perikliu, që nuk e mendonte se jeta është çdo ditë bashkëndhëtare e aksidentit, e së papriturës, e cila të ndan lehtësisht nga të gjitha gjërat që kë nisur të bësh. Trishtimi më bëri të kujtoj profesor Perikliun, me të cilin vendosëm një komunikim profesional të besueshëm dhe njerëzor. U ngrita nga tavolina e punës dhe mora dy librat që mi kishte dhuruar "Safon" dhe "Kavafis". Natyrisht kur e njej një njeri dhe ke bashkëpunuar me të, profesionalisht zbulon se diçka humbet ose më qartë t'i mbyll në veten tënde atë çka njeriu i njohur, ta kishte bërë pjesë të unit tënd. Ishte fundi i viteve '90 dhe ekspozitat në Galerinë Kombëtare të Arteve vinin si vrulli i një lumi, që dukej sikur po e hapte për herë të parë shtratin e tij dhe kjo i bënte intelektualët, njerëzit e dashur të pikturës dhe të skulpturës, vizatimit dhe grafikës, më pak ata të fotografisë, sepse ende nuk iu kishte ardhur koha e duhur, të vinin po me ritmin e tij. Ishte ekspozita e fundvitit dhe më kujtohet mirë "Onufri", vizioni i të cilit sapo i kishte nxitur debatet e të gjithë të intrusuarve për artet figurative, që po i drejtoheshin me të drejtë një emërtimi të ri, duke i cilësuar, arte pamore. Eh sa shumë ka për të shkruar historia e arteve, edhe të këtyre viteve që janë shumë të afërta, pasi dhe për këtë emërtim lindën debate të kuptimit dhe të mos kuptimit, të pranimit dhe të mos pranimit. Dhe në këtë kohë, dhe madje në atë ditë përrumit të "Onufri99", erdhi drejt meje profesori i disa gjuhëve, përthyesi im emër, që nga rinia jonë e një kohe të kapërcyer, sot, i ndjeri Perikli Jorgoni. Nuk e harroj energjinë e tij dhe një trashësi letre gjithmonë në dorë, ku kishte libra në gjuhë të huaj për t'i përkthyer, por edhe në shqip, të shqipëruara prej tij, të sapo dala



Në foto:
Perikli
Jorgoni

në treg, kur më tha: "A më njeh mua Suzana"? Se si më tingëlloi emri im, pasi ishte nga të pakët që më thërriste në emrin e gjatë. "Po profesor! Do të ishte turp mos t'iu njihja, pasi do të thotë se nuk kam lexuar asnjë përkthim tëndin. Por kjo nuk ka ndodhur. Natyrisht, sot, po iu flas për herë të parë dhe të falenderoj që më takuat". Diskutimi i parë i asaj dite me Prof. Perikliun ishte se ai e pranonte që artet figurative të cilësoshin arte pamore dhe argumentoi disa arsye. Nga ajo ditë i madhi gjuhëtar, përkthyes e njohës i disa gjuhëve më ofroi ndihmën e tij, se si të shpreheshin shumë më qartë dhe të përdor shumë më profesionalisht gjuhën shqipe te mendimet e mia. Gjurmët e punës së tij si redaktor shkencor dhe letrar janë në tekstin tim përfundimtar, te tre librat e mi, të llojit monografi, kushtuar artistëve shqiptarë. Korrektesa e tij e pallogaritshme në punë, nuk mateg me çmimin monetar, thuaj se punonte pa lekë, edhe pse pensioni i tij ishte i pakët. Idealist dhe energjik, i shpejtë dhe i pagabueshëm, korrigjues dhe mirënjohës, dashamirës dhe besues. I dasuruar me gjuhën dhe ata që dinin ta shkruanin.

Disa vite më parë ai u martua me një zonjë, që kujdesej dhe ndjehej e nderuar që ishte gruaja e tij. Të tre bashkë kemi pirë kafe shpeshherë. Vendosi të jetonte në plazhin e Durrësit. Më tregonin të dy, se familjet e tyre kishin vuajtur, se ishin familje të njohura, të pasura dhe patriotë të Shqipërisë. Ai ishte nip i Hilë Mosit, por ai vet ishte patriot edhe më i madh, sepse besonte tek të parët, por besonte dhe se vetëm duke qenë një patriot, mund të sjellësh përmirësim në jetën e shqiptarëve.

Dhe kjo e bënte të shkente në përkujtimin e çdo ngjarje, që kishin ndërmarrë patriotët e viteve të shkuara dhe në shumë rrethe të Shqipërisë dhe madje jashtë saj. Kur e pyesnin përse Perikli shkon e vjen në Durrës, e nuk rri në Tiranë. E kam dëgjuar të thotë se: "Atje e ndjej se jetoj. Ngrihen në mëngjes dhe bashkë me detin prek qetësinë. Atje jam për punë. Tirana më mbyt".

Mendoj se ai është një nga të diturit e shqiptarëve të kohës që po jetojmë dhe në mënyrë absolute të diturit e tjerë do ta kujtojnë gjithmonë, sepse në duart e tyre do kenë përkthimet e tij dhe në biblioteka do gjejnë emrin e tij. Vetëm se kam frikë se nganjëherë, përkthyesit harrohen. Le të shpresojmë se emri dhe personaliteti i Perikli Jorgonit të mos e ketë këtë fat.

ngjiste mbi shpinë një mijë flatra dylli. Ngjiteshim e binim. Veç Perua fluturonte e s'donte të ndalonte kurrkund. Më në fund kur po ktheheshim dhe ai mezi priste që ajo të pranonte, ranë dhe flatrat prej dylli të Peros sonë. Çuno, foli ajo shqip duke na lënë pa mend të dyve, unë jam evgjitëk pe Korçë! Kaq. Dhe u zhduk. Nuk e pamë më. Po dhe ai e harroi shpejt, se nuk e linte të tradhtonte shijen e lartë, frau Gete! Kishte punë me të vdekurit e mëdhenj që arriti t'i sjellë të gjallë në këtë jetën tonë me xhuke e blatishte.

Këtu në Nju Jork mora vesh se ai u nis për atje, thonë se të vdekurit e mëdhenj kanë mbetur të kënaqur prej punës së tij dhe e ftuan përgjithmonë, po veç nuk ia dinë hugin, që ai pi pa hesap dhe s'dehet, i prishet mendja dhe kushedi i propozon frau Gëtes, o Zot, i lutem me shpirt hyut, veç me këtë dështim përkohësisht mos e njollos, falja këtë paudhësi duke mbyllur ti i pari sytë dhe veshët, se ai djallush ç'ka për të bërë e bën!

Nju Jork 2012

VARGJET | AMANET

PERIKLI JORGONI

Poema e fundit e mbetur përgjysmë

Dhurata Hamzai

Vargje për baritonin Llukë Kaçaj. Data 11.12.2012, ora 20:15°

Një poezi e mbetur përgjysmë në ditën e fundit të jetës. Një natë para se të ndërronte jetë, Perikli Jorgoni ishte ulur, siç bënin shpesh, në tavolinën e punës me bashkëshorten Elidën. "Ai tha që do të bëj një poemë për Llukë Kaçaj, baritonin e famshëm", rrëfeu Elida në intervistën që dha më 14 dhjetor për "Shqiptarja.com", ditën e homazheve. Ish-te e dërmuar nga dhimbja, por mori zemër dhe premtoi se do të na e sillte poezinë e mbetur përgjysmë për botim, sapo të shkonte në shtëpi. Ajo tregon: "Ai e nisi dhe unë e shtypja në laptop. Përjetimet e tij ishin të fuqishme dhe ne hodhën aq sa mundi për të vazhduar ditën e nesërme, por ja që të nesërmen nuk mundi...". Në fund të poezisë automatikisht laptopi ka regjistruar orën e saktë, kur është ndërprerë puna me shkrimin e kësaj poezie për të vijuar ditën tjetër (Date modified: 11/12/2012 - 20:15°). Por atë ditë poeti nuk u kthye dot në shtëpi, për shkak të aksidentit tragjik. Vargjet për fatin tragjik të Llukë Kaçaj i kanë jehuar në kokë deri në çastin e fundit, sepse do të vazhdonte pjesën tjetër aty ku e kish lënë: "Bërtitën, u xhindosën, sikur po ngjante gjëma./Sikur shembj kupola e po i zinte brenda,..."

Elida Jorgoni nuk e kishte aq të lehtë të na e dërgonte këtë poezi, por gjeti forca dhe e mbajti fjalën. Poezia erdhi dje për gazetën "Shqiptarja.com" e shpërndarë me shënimin e saj: "Perikliu atë mbrëmje më tha se ishte mjaft i ngarkuar e se kish të shumë vargje, që i sillleshin në mendje. Më tha: "Kaç për sot dhe nesër ta përfundojmë Llukë Kaçajn". - Unë e pyeta, se çfarë tjetër ke në mendje? Ai më tha se kishte gati dy poema, për Papa Kristo Negovanin dhe për Papa Llambr Ballamaçin. Unë e pyeta, se kur të erdhi frymëzimi? Ai më tha se sot gjatë gjithë ditës e besoj, se do t'i plotësoj më mirë nesër. Unë i thashë, se Korça ka detyrime për Papa Llambron, se pllakën e varrit tek Varrezat e Dëshmorëve në Korçë e ka të thyer dhe se tek shtëpia e tyre, e tij dhe e të vëlait të masakruar nga banditët grekë në atë pranverë të vitit 1914, nuk ka një pllakë përkujtimore. Nga kjo shtëpi, trupat e dy vëllezërve priftërinj, të thelëzuar janë tërhequr zvarrë dhe në errësirën e natës, vrasësit i flakën në kodrën e Shën Ilias. Ai më tha, se do të interesohej për këtë në fillim të vitit 2013 dhe se do të bisedonte me kryetarin e Bashkisë të Korçës, Niko Peleshin. Mjerisht, la pa përfunduar poemën për Llukë Kaçajn dhe nuk i shkruam dy poemat për dy priftërinjtë atdhetarë shqiptarë...



Në foto: Perikli Jorgoni me të shoqen Elida Jorgoni

POEMA E DRAMËS TË SHPIRTIT

(Kujtimet të baritonit me famë ndërkombëtare, Llukë Kaçajt)

Perikli Jorgoni

1. Sa forcë karakteri edhe ç'durim i rrallë
Të duhet, mos përfillësh kaç zgjyrë, llohë e baltë,
Që vjen e të përplasen në zverk e në ftyrë,
Kur shpifja e mashtrimi të sulen bulçifryrë,
Kur laro e zuzarë, spurdhjakë e zagarë
Jetojnë në mes pallatesh si princa e pashallarë.
2. Si nuk të plasi zemra, s't'u ça plot mlllef prej dhimbje
Si zhgualli i breshkës, si boçja e një pishe,
Kur pe me sy papritur, me ngjethje e i habitur,
Mes skuthash e tinëzarësh finokë e të lajthitur
Dhe ndonjë shok a mike, që shpirti yt i pastër
Kujtonte se i kishte të besës e të afërt,
Se me ta shpesh ke qeshur, ke bredhur e ke pirë
Diku në një gosti, raki apo një birrë.
3. Nuk prisje që ky gjyq, i ngrehur e i shtirë,
Të nxirrte pa një njollë, shëndoshë e të dëlirë,
Kur trupin në qelitë kallkan në errësirë
Ta kishin rrahur rëndshëm, sa sytë t'i kishin nxirrë,
Ndaj brinjët e kokallat të themin e s'bëje gjumë
I shembur në mes rreckash plot pluhur edhe zhul.
4. Gjithçka do të duroje, edhe pse mjaft i tretur,
Me sy të futur thellë, pa gaz e si të mekur,
Mos dilje nëpër rrugë pa nder e si çofëtinë,
Sa njerëzve t'u ngjallje keqardhje e lemerinë,
Më mirë në llum kënetë, në puse e minierë,
Edhe pse larg muzikës, që fort deshe ngaherë.
5. Prandaj përpara gjyqit, që nisi të gjykonte,
Teksa gjindja e lodhur e shtangur po dëgjonte,
S'u theve si një degëz e njomë e për mëshirë
S'u lute i tmerruar nga kthina e zinxhirë,
Por kur pe nënë Tonen të mbledhur e të ngrysur,
Tek fshihte tinës lotët, tek rrekej për të mbytur
Rënkimet e gulçimet, që s'mund t'i ndrydhte brenda
Në shpirtin e munduar shkallmuar keq nga brenga,
Kur pe si Ana e dashur, ia plasi vajit e qeshi
Dhe ra përdhe si zogëz nga shqota e rrebeshi,
Nuk munde të përmbahesh, por brofe shpejt që pranë,
Ti ndodheshe, por rojet t'u turrën e s'të lanë.
6. Bërtitën, u xhindosën, sikur po ngjante gjëma,
Sikur shembj kupola e po i zinte brenda,.....

Date modified: 11/12/2012 - 20:15°

FAKSIMILET | TRASKRIPTIMI

Prof. Dr. Aleksandër Meksi

Nisma për botimin tërësor të katërrungjillit të Korçës në faksimile, transkriptimin, studimin përkatës dhe përkthimin në gjuhën shqipe, duhet të vlerësohet si një ngjarje kulturore me rëndësi të veçantë, që duhet të pasohet me të tjera të kësaj natyre. Ky botim i përbashkët i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe i Shoqërisë Ndërkonfesionale Biblike të Shqipërisë, nga ana e studiuesve Andi Rëmbeci e Sokol Çungu, nën mbikëqyrjen shkencore të profesor Agamemnon Celikas, është një kontribut me shumë vlerë për shkencat shqiptare, që na jep mundësinë të njohim më mirë dhe me një kontakt të drejtpërdrejtë - si me një dokument shkencor, këtë Kodik katërrungjillor të ruajtur deri vonë në Mitropolinë e Korçës.

Botimi luksoz dhe dinjitoz i kësaj vepre përbëhet nga tre vëllime të veçanta: Kodiku vetë, i riprodhuar në faksimile besnike e origjinalit, vëllimi dy gjuhësh shqip e greqisht me transkriptimin, studimin dhe përkthimin në gjuhën shqipe të ungjillit sipas Lukës, si dhe studimin në gjuhën angleze. Në këtë mënyrë kjo pasuri i bëhet e njohur gjithë botës shkencore dhe të interesuarve për të.

Është më të vërtetë një kënaqësi të kesh në dorë dhe në bibliotekën personale këtë botim me një cilësi të lartë, që jep pamjen e vërtetë faqe për faqe të Kodikut të Korçës 93, për të gjykuar për të, për vlerat e tij, për miniaturat, për shkrimin e bukur.

Studiimi në vetvete përbëhet nga tre pjesë. Pjesa e parë me titull "Këqyrje tekstologjike e paleografike" bënë një paraqitje të rilindjes bizantine gjatë dinastisë maqedonase dhe vendi i kodikut të Korçës në këtë mjedis kulturor, vijohet me një paraqitje të historisë së kodikëve të Arkivit Qendror Shtetëror, flitet mbi gjininë e katërrungjillshit bizantin dhe këtë të Korçës. Një vend me rëndësi në këtë pjesë i është lënë analizës kodikologjike, shkrimit, libër-lidhjes dhe për shënimet e mëvona në kodik.

Kodiku i Korçës 93, sipas autorëve të këtij botimi i takon fillimit të shek. X dhe është karakteristikë për atë periudhë. Ai përbëhet nga 308 fletë pergamene me përmasa 153 x 120 mm. Ai është pjesë e koleksionit të dorëshkrimeve mesjetare që ruhen në Arkivin Shtetëror. Kodiku i përket shek. X, është i shkruar në formë kryq, një dukuri e rrallë dhe një nga shembujt më të vjetër të kësaj gjinie. Shkrimi i përket tipit Bouletée, një shkrim gërmëvögël i rrumbullakët, i realizuar bukur dhe i përdorur gjerësisht në dorëshkrimet bizantine të shek. X. Tek titujt e kapitujve dhe tek gërmat nistore, shkruar përdor modele shkrimi gërmëmdhenj të një periudhe më të hershme. Kodiku është shkruar nga tre shkruar të një dy periudha kohe. Duket qartë se shkruar i të katër ungjijve i përket gjysmës së parë të shek. X; kurse dy të tjerët, që kanë shuar disa fashikuj në fund, nisur nga tipologjia e shkrimit, janë të shek. XIII. Bazuar në karakteristikat paleografike dhe kodikologjike, vendi i kopimit rezultoi të kenë qenë punisht të libërshkruesve të Kostandinopojës, ndërsa vendi i përdorimit të tij, Korça.

Pjesa e dytë, "Miniaturat e dekoret", me autorë Ioannis Vitaliotis, Andi Rëmbeci dhe Sokol Çungu, trajton miniaturat dhe zbukurimoret e Kodikut. Siç dihet në manuskriptet e periudhës mesjetare, zbukurimi i tyre është përberës e vlerave të tyre, si një aspekt i lidhjes së përdoruesit me tekstin dhe hyjnorën, ku



Kodiku i Korçës 93, (Pamje e jashtme)



Kodiku i Korçës 93, f 6v (Tabela e Eusebit)




Kodiku i Korçës 93, f 226v (Ungjillori Joan)

PREJ 1000 VJETESH...

Kodiku i Korçës nr. 93 në një botim dinjitoz

Botimi përbëhet nga tre vëllime: Kodiku i riprodhuar në faksimile, vëllimi dy gjuhësh shqip e greqisht me transkriptimin, studimin dhe përkthimin në gjuhën shqipe të ungjillit sipas Lukës, si dhe studimin në gjuhën angleze



Në foto: Pjesë nga transkriptimi dhe përkthimi shqip

pamja kishte rëndësi të veçantë. Ato në këtë katërrungjill të Korçës, janë në 6 fletë pergamene, ku paraqiten Kanonet e Eusebit në një formë tradicionale e mjaft elegante. Përsa i përket miniaturave të katër ungjillorëve, realizimi i tyre është sipas tipit ikonografik. Veç tyre kemi zbukurimet mbititullore dhe shkronjat nistore. Në spektrin e ngjyrave mbizotëron ari, ndërsa kombinohet edhe kafa e kuqe, jeshilja e errët dhe e kaltra. Motivet gjeometrike dhe bimoret të dekoreve mbititullore zhvillohen mbi sfond të kaltër apo jeshile të errët. Gërmat nistore të punuara artistikisht ndjekin, në përgjithësi, të njëjtin stil.

Studiuesit tregojnë se këto janë të fazës së parë d.m.th të njëkohshme me vetë dorëshkrimin (tekstin) dhe i takojnë shekullit të X-të, ato dallohen për përdorimin e gjerë të artit,

krahësuar me ngjyrat e tjera. Ky stil dekorimi paraqet ngjashmëri me grupin e kodikëve me zbukurime blu-ar, sipas K.Weitzman, stil i lidhur me punishtet e Kostandinopojës të fundit të shek. IX dhe fillimit të shek. X. Dekoret që përmbajnë elementet e rozetës dhe lulen dorëzonë na drejtojnë për nga shek. X dhe po nga Kostandinopoja, apo zonat përreth. Përsa i përket miniaturave të ungjillorëve ato me mjaft gjasë janë të shekullit të XIII-të. Po kështu dekori i thjeshtë i shtesave të mëvonshme në fund të Ungjijve (Sinaksari dhe Menologu) i përkasin fundit të shekullit të XIII-të.

Pjesa e tretë, "Transkriptimi paleografik i Ungjillit sipas Lukës", ka për autorë Andi Rëmbecin dhe Sokol Çungën të cilët na shpjegojnë se ai është kryer sipas rregullave të standardizuara metodologjike, duke ruajtur drejtsh-

krimin, theksin, shenjat e pikësimit si në origjinal, ndërsa fjalët e bashkuara u ndanë dhe shkronjat e emrave të përveçëm u shkruajtën të mëdha. Shënojmë se është për të vlerësuar që si në përkthimin në shqip ashtu dhe në transkriptimin në gjuhën e origjinalit është ruajtur forma e kryqit si në Kodik. Çdo ndryshim shënohet me shenja dalluese për studiuesit.

Ja vlen të nënvizohet fakti se një botim faksimile i këtij lloji e cilësie është i pari në historinë e botimeve dokumentare në Shqipëri, për gatitur me bashkëpunimin e institucioneve vendase. Fusha e botimeve të burimeve historike sipas standardeve shkencore është pak e lëvruar në Shqipëri, qoftë për shkak të së kaluarës së izoluar, qoftë për shkak të mungesës së përvojës dhe mundësive. Botimi i këtij Kodiku, si një prej më përfaqësuesve në rang botëror të asaj vepërimit intelektual të spikatur gjatë njëzës prej periudhave më të lulëzuara kulturore të periudhës Bizantine, veç rëndësisë së vet shkencore, vjen të shërbejë si një kontribut në promovimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore në Shqipëri. Vlera e këtij botimi qëndron edhe në studimin e tij që nxjerr në pah vlerat, vendin e tij në artin mesjetar, datimin, përfaqësimin dhe ndikimet, e gjithë kjo meritë e autorëve, që duhen përgëzuar dhe inkurajuar për ta vazhduar këtë punë edhe pse të vështirë.

Botimi në këtë formë e me cilësi i Katërrungjillit të Korçës përbën një ngjarje me rëndësi të veçantë në jetën kulturore të vendit, një pasuri që vjen tek në prej njëmijvjetësh dhe bëhet pronë e të gjithëve. Tashmë kushdo mund ta admirojë, ta studiojë në origjinalitetin e tij. Është një botim i vyer, që urojme të jetë i pari por jo i fundit për këtë gjini, pra të pasohet dhe me të tjerë Kodikë.

Kodikët që kanë arritur deri në ditët tona përbejnë një thesar si dëshmi e kulturës së një vendi që i përdori në shekuj, i ruajti sepse i vlerësoi. Ata na ndërojnë jo vetëm me vlerat e tyre por edhe me këtë vlerësim.

Tiranë 12 dhjetor 2012

GJUHA | DISKUTIMET

KONGRESI I DREJTSHKRIMIT

Debatet për standartin, prapakthim e verbëri

Shefkije Islamaj

Kongresi i Drejtshkrimit dhe çështje të leksikut

Nëse drejtshkrimi është fusha e normuar më me rreptësi e gjuhës standarde, leksiku është fusha më së lirshmi "e normuar". E nisëm kështu për të përfshur tezën që do të përvijohet në këtë kumesë e cila jo vetëm vërteton një fakt të gjithënjohur, por lejon edhe mundësinë për t'u kundërvënë atyre që thonë se Kongresi i Drejtshkrimit i bëri një padrejtësi të madhe e të palejueshme leksikut të dialektit verior, dialektit gegë, dhe se kjo u bë për qëllime thjesht politike dhe të tjera.

Sot pas 40 vjetëve nga Kongresi i Drejtshkrimit, i cilësuar nga mendjendriturit si ngjarja më e madhe kulturore në jetën e shqiptarëve përgjatë shekullit 20, diskutimi për vlefshmërinë e standardit për shqiptarët, diskutimi për vlefshmërinë e rrugës që është ndjekur për këtë standardizim dhe, më në fund, edhe diskutimi për përmbyshjen e mospërmbyshjen e funksioneve komunikuese në të gjitha rrafshet nga ana e këtij standarti, shikuar nga perspektiva e së tashmes dhe e së ardhmes së shqiptarëve, duket jo vetëm prapakthyes, por më shumë se kaq, verbëri dhe mospasje vizioni për ecjen e shqiptarëve bashkë në kohën që po vjen.

Duke ndjekur tezën e ngritur për diskutim në fillim shtrohet pyetja: a e ka normuar Kongresi i Drejtshkrimit leksikun, në të vërtetë e ka sanksionuar përdorimin a mospërdorimin e një pjesë të leksikut të shqipes? A ka qenë e mundur kjo? E para që duhet të thuhet është: shumëfunksionaliteti dhe shtresëzimi i gjuhës standarde janë kriteret më të rëndësishme për "normimin" e leksikut. Këto dy kriterë nuk janë marrë dhe as nuk po merren parasysh në mënyrë kritike në debatet shkencore e joshkencore. Kjo ka sjellë gjyime jo të drejta dhe argumentime të pamëshetura shkencërisht për normën tonë gjuhësore, rrjedhimisht edhe për normën leksikore.

Brenda këtyre diskutimeve, më së shumti u debatuan e po debatohen drejtshkrimi, paskajorja dhe leksiku. Nëse i pari, pra drejtshkrimi, "përfitoi" nga ky debatim e aktualizim edhe disa propozime konkrete, në të shumtën e herës të paarsyetuara shkencërisht dhe praktikisht, në Këshillin Ndërkademi të Gjuhës, i cili u krijua këtu e tetë vjet më parë, në rend të parë, si rrjedhojë dhe si presion pikërisht i këtyre debatëve, e dyta, paskajorja pret në radhë për t'u bërë çështje e "nxehtë" po në këtë Këshill. Mund të thuhet, madje, se ende nuk janë hapur të gjitha çështjet që pretendohen të hapen e të "zgjidhen", dhe për më tepër priten edhe rrjedhoja të tjera të këtyre debatimeve, jo vetëm në rrafshin e drejtshkrimit, po sidomos edhe në rrafshin morfo-sintaksor. Çështja e tretë leksiku nga këto debate mund të duket se do të dalë më së lehti, pikërisht pse çështja e leksikut nuk

A kanë mbetur jashtë këtij fjalori fjalë të gegërishtes? Natyrisht se kanë mbetur. Dhe kanë mbetur jo vetëm të gegërishtes, po edhe të toskërishtes, edhe të të folmeve të tjera të të gjithë arealit shqipfolës...



Pamje nga sallja, ku u mbajt Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe

mund të krahasohet me çështjet e fonetikës dhe gramatikës, ndërsa paragykimet për këtë të fundit rrëzohen lehtësisht. Çështja e leksikut i takon më shumë dijes së linguitikës njohëse a kognitive dhe vetëm ajo mund të sqarojë më së qarti lidhjet e leksikut me normësinë, rrjedhimisht edhe me drejtshkrimin, dhe për arsye se kjo çështje nuk ka të bëjë me asnjë lloj normësie të caktuar a të paracaktuar në Kongresin e Drejtshkrimit. Si e tillë kjo çështje kërkon diskutim e jo debatim dhe gjithësi në nivele profesionale-gjuhësore me platforma që do ta shohin problemin realisht e jo me argumentime joshkencore, paragykime politike, ideologjike, kra-

standarde janë shumë më të veçanta sesa në nënsistemet e tjera të gjuhës, si fonetika, gramatika e fjalëformimi, së paku për katër arsye themelore: A) për shkak të veçantisë së normës leksikore; B) për shkak të raporteve të leksikut të standardit me leksikun e gjuhës në përgjithësi C) për shkak të dinamikës dhe të lëvizjeve të mëdha e të shpejta në leksik me gjithë qëndrueshmërinë e normës drejtshkrimore e gramatikore, dhe D) për shkak të ndikimit të drejtpërdrejtë e të menjëhershëm të zhvillimeve e të ndryshimeve historike, ekonomike, shoqërore, madje edhe politike ose të politikave të zbatuara në planin i fiksimit gjuhësor".

"varfërimin substancial" të shqipes pa këtë leksik. Me këtë rast po tumir një mendim të Ardian Vehbiut, i cili u sillt shpesh këtyre debateve. Citoj: "Fakti më i dukshëm, më absolutisht i rëndësishëm, që u shpëton nga padija ose nga mendja e keqe - ihtarëve të "pasurimit" të standardit me fjalë geqe të lëna deri më sot jashtë, është se dy kryedialektet e shqipes dallojnë mes tyre sidomos në fonetikë dhe gramatikë, por jo dhe aq në leksik; dhe se këto dialekte i kanë shumë fjalë, me qindra në mos mijëra, të përbashkëta mes tyre - duke filluar nga fjalë të rëndomta, si pishë, dorë, mend, gjej, shkoj, i mirë, kot, dje, etj.; pa përmendur pastaj që variacioni leksikor brenda një kryedialekti ose dallimet leksikore midis të folmeve (të themi, e folmja e Zadrimës dhe e folmja e Drenicës), shpesh është po aq i theksuar, në mos më tepër, se variacioni leksikor midis kryedialekteve." Dhe se "dallimet leksikore ndërdialektore luajnë rol të parëndësishëm në mënyrën si strukturohet dhe si funksionon leksiku i sotëm normativ i shqipes; para së gjithash, ngaqë folësi përgjithësisht nuk mund ta dijë se nga ç'dialekt ka hyrë një fjalë e caktuar në standard, përveçse po të jetë specialist dialektolog." Po e plotësoj mendimin e drejtë të Vehbiut se leksiku i shqipes është përfutur në kontekstin mbidialektor të shqipes dhe paraqitet si një sistem që po zhvillohet përmes burimeve të ndryshme: krijimit, huazimit, shfrytëzimit të burimeve dhe të mjetëve fjalëformuese të shqipes të të dyja dialekteve dhe të folmeve të tyre. Standarti i shqipes nga aspekti leksikor shpreh potencial për zgjerim e zhvillim e jo mbyllje e frenim. Ja dhe një arsye që vërteton vështirësinë e kodifikimit të një norme të rreptë leksikore.

Natyrë e standardsisë dhe e neutralitetit në fushën e leksikut, ashtu si edhe mundësitë e gjuhës standarde shqipe në rrafshin e leksikut, më së miri shfaqen në prodhimin letrar, në prodhimin e publicistik, në prodhimin shkencor, në prodhimin leksikografik, shkurt në punën e shkrimtarit, të publicistit, të gazetarit, të shkencëtarit, të përkthyesit, të leksikografit, të terminologut, të redaktorit gjuhësor, e kështu me radhë, me një fjalë të të gjithë atyre që me gjuhën shënojnë, krijojnë dhe zhvillojnë botën tonë. Përpjekja për ta normuar leksikun në kuptimin e përjashtimit, siç parakupton koncepti "normë", në të vërtetë do të thotë përpjekje për të vënë në kalë dhe për të moduar përvojën e një bashkësie gjuhësore, prandaj është e gjykuar të dështojë para se të fillojë të zbatohet. Kjo ndodh edhe në rast të përpjekjes për



Gjatë diskutimeve të Kongresit të Drejtshkrimit 1972



Delegatët e Kongresit të Drejtshkrimit 1972

hinore, e të tjera. Se cilat janë problemet e leksikut të shqipes lidhur edhe çështje të normës leksikore na e sqaron drejt e qartë, pos të tjerëve, leksikologu ynë i shquar, prof. Jani Thomai në referatin e paragjitur po në këtë Këshill për çështje aktuale të leksikut të shqipes, në të cilin midis të tjerash thotë se "Problemet e leksikut në shqipen e sotme

E trajtuar kështu çështja e leksikut të shqipes ligjëson edhe moskodifikimin e asnjë rregulle të ngurtë e të rreptë për leksikun e shqipes në Kongresin e Drejtshkrimit të Shqipes dhe konfirmon absurditetin e diskutimeve për "lënie anash". Si thuhet qëllimisht të leksikut të gegërishtes për rrjedhojë edhe

zbatim të dhunshëm. Hartuesit e rregullave të drejtshkrimit të shqipes e kanë ditur mirë këtë fakt.

Në debatet për leksikun shkohet edhe më tutje. Edhe fjalori i gjuhës së sotme shqipe bashkë me plotësimet që ka njohur deri më 2006 cilësohet si përjashtues i një pjesë të

RËNDËSIA | EKONOMIKE

SHQIPERIA ETNIKE

Pse duhet t'i bashkohen Shqipërisë Ohri e Prespa


Pjesa e katërt e dokumentave/ Komisioni i promemories që u përgatit për Ministrinë e Jashtme Italiane në 1941, analizon rëndësinë ekonomike të zonës së liqenjeve...

Kjo është pjesa e katër e dokumenteve, shkëputur nga promemoria që u përgatit për Ministrinë e Jashtme Italiane në 1941. Promemoria do i dërgohej Musolinit, për projektin e Shqipërisë së Madhe. Promemoria u përgatit nga një komision me këto anëtarë: Fejzi Alizoti, Mustafë Merlika-Kruja, Xhemil Dino, Dhimitër Berati e Tahir Shtylla. Në këtë pjesë që po botojmë sot analizohet rëndësia ekonomike e zonës së liqenjeve Ohër e Prespë për Shqipërinë dhe është përfshirë në shtojcën nr.3.

PARASHITJESË BASHKANGJITUR SHTOJCËS N°3 RËNDËSIA EKONOMIKE E ZONËS SË LIQENJEVE TË OHRIT E TË PRESPËS PËR SHQIPËRIË

"Zona e liqenjeve është pak e banuar, qëndrat e një farë rëndësie janë qytetet e Ohrit dhe fshati i Strugës mbi liqenin e Ohrit, veç Resnjës pak në veri të liqenit të Prespës. Në brigjet e Prespës, në ata të Ventrokut, një krah i hershëm i liqenit të Prespës, nga i cili është ndarë nga një rryp toke i formuar nga material i hedhur rishtas, ka pak fshatra me pak qindra banorë. Nuk ka një rëndësi të madhe kjo zonë e liqenjeve në vështrimin demografik e, sidoqoftë, bëhet fjalë për vënd që kanë një popullsi të përbërë nga bullgarë e shqiptarë me pakica vllahe. Rëndësia e krahinës nuk shtohet nga rezervat prodhuese të territorit, mbasi bëhet fjalë për zona malore e, si të tilla, pa kultura të leverdisëshme, me përjashtim, ndoshta të ultësirës së vogël lyshtrorë të Strugës, në të cilin rrjedh Drini i Zi, që zbraz liqenin e Ohrit. "Krahina ka një rëndësi të dukshme për të tjerat arsye. Liqejt e Ohrit, të Prespës, të Ventrokut e të Maliqit, prej të cilëve vetëm ky i fundit gjendet në territorin e aktualisht Shtetit shqiptar në Konferencën e Londrës, përbëjnë rezervat të mëdha ujore prej të cilave, nëpërmjet derdhjeve sipërfaqësore ose rrugësh nën tokësore, ushqehen lumenjtë më të mëdhenj të Shqipërisë, ujrart e të cilëve derdhen në detin Adriatik. "Për të dhënë një idë të rëndësisë së këtyre rezervuarëve, mjafton të kujtojmë se liqeni i Ohrit ka një sipërfaqe prej 270 km² dhe ujra me thellësi deri në 287 m.; ato të Prespës apo të Ventrokut, nëse ndryshojnë nga Ohri për thellësitë e ujrave që shkojnë nga 7m. deri përtej 50 m., nuk ndryshojnë për sipërfaqet që madje, të marra së bashku, rezultojnë më të mëdha se liqeni i Ohrit, duke qënë të përlloragitura në rreth 320 km²; liqeni i Maliqit ka një sipërfaqe pak më të madhe se 30 km². Këta pellgje të mëdhenj janë ata nga ku burojnë Drini i Zi, Devolli, e ndoshta, nëpërmjet rrjedhjesh të nëndeshme, edhe Shkumbini. Këta lumenj janë më të rëndësishmit e Shqipërisë Qëndrore e, gjatë rrjedhjes së tyre kanë qënë shënuar rrugët historike të depërimit të gjindjes latine në gësisullin ballkanik. Drini, ndër të gjitha rrjedhjet ujore të Shqipërisë, është ai që ka më shumë se gjithë të tjerët karakterin e vërtetë të një lumi. Drini, që buron nga liqeni i Ohrit, përshkon për rreth 20 km. luginën e Strugës që bën pjesë në territorin e dhënë serbëve mbas luftës së vitit 1913, vazhdon më pas nëpër Dibër, duke shënuar kufirin mes Shqipërisë e Serbisë; nga Dibra hyn përfundimisht në truallin shqiptar për t'u derdhur, mbas bashkimit me Drinin e Bardhë e degë të ndryshme, në Adriatik në jug të Shkodrës. Në pjesën që përshkon ultësirën e shkurtër lyshtrorë të Strugës ndeshen guzmët e punimeve hidraulike të epokës romake. "Regimi i ujrave të gjithë zonës së liqenive mbledhen tek Devolli dhe Drini e shkojnë drejt Adriatikut, është i madh interesi i Shqipërisë së paruarur që kjo zonë, mundësisht, të jetë e përfshirë në kufijtë e saj. "Nga një studim i përgjithshëm, aq sa mund të jetë i mundur në harta jo shumë të sakta dhe me një shkallë 1 : 200.000, do të kishim

këto të dhëna për pellgjet ujëmbledhëse të liqenive të ndryshëm : liqeni i Ohrit ka rreth 1750 km², liqejt e Prespës dhe Ventrokut rreth 1350 ; liqeni i Maliqit më shumë se 800 km². Reshjet në Shqipëri janë të bollshme, matjet e kryera gjatë bregdetit nga Fisherit dhe Filipsoni, që janë vërtetuar nga matjet e kryera edhe gjatë pushtimit tonë, japin një mesatare më të lartë se 1000 mm. Krahina e liqenive, për lartësinë e saj, i përket zonës mesatare malore. Liqeni i Prespës është 857 m. mbi nivelin e detit, e në po të njëjtën lartësi është liqeni i Ventrokut ; liqeni i Maliqit është pak më pak se 800 m., ai i Ohrit është 657 m.; të logaritmet mesatarja vjetore e reshjeve në këto zona mbi 1000 metra nuk duhet quajtur një llogari e tepruar. Kemi pra : bollëk ujrash nga reshjet, gjërisht spikateshë pellgje ujëmbledhëse dhe një sipërfaqe shumë të madhe të pellgjeve natyrore me rezervat të thellësive të mëdha, të tilla që mbajnë disa qindra milionë metro³ ujë. "Siç u tha më sipër, këto liqenja ushqejnë burimet e lumenjve nëpërmjet derdhjes sipërfaqësore ashtu si dhe nëpërmjet shtresave të ujrave të nëndeshëm, të ndihmuara nga natyra karstike e tokës. Duke shqyrtuar rrjedhat e këtyre lumenjve, në krahasin me kuotat e liqenive, zbulohen disnivele të mëdha që bëjnë të mundur krijimin e burimeve të mëdha energjish hidraulike në pak kilometra të rrjedhjes. Nuk është rasti të sjell këtu të dhëna e llogari mbi mënyrën më të mirë për të përdorur disnivelet e liqenive e të lumenjve, që pata mundësi të vërtetoj me ndihmën e teknikëve të kompetencave të padiskutueshme. Mjafton të përmendim se mund të arrihen shifra shumë të larta nga përdorimi i mundshëm e i shkallëzuar i ujrave si forca lëvizëse të tilla që mund të kalojnë 300.000 kuaj fuqi." Sot gjithkush e sheh se, duke mos patur arsye të natyrës popullore që të kundërshtojnë bashkimin e zonave të liqenive me



Prespa e vjetër

Shqipërinë e pavarur; kjo zonë duhet të përfshihet në territorin shqiptar. " Nëse fjalë të mëdha e të vogla kërkojnë, për arsye të karakterit ekonomik, të shtrijës kufijve e tyre politikë, edhe se nuk përputhen saktësisht me ata etnikë, për të përfshirë pellgje mineralësh apo elementë të tjerë që sigurojnë mjetet e tyre të prodhimit e me to një jetë të begatë nga pikpamja ekonomike, do të ishte një padrejtësi e dukshme t'i hiqte Shqipërisë një territor që i përket gjeografikisht e në të cilin, duke përdorur forcat e shumta lëvizëse, do të përfitonte një pjesë të madhe të mirëqenies së ardhme. Forcat lëvizëse ujore që, të kthyerat në energji elektrike, mund të shfrytëzohen në krahinat e liqenive e të lumenjve me të cilat lidhen, përveç se lehtësojnë zgjidhjen e problemeve të komunikimit hekurudhor, mund të përbënin elementin e parë për një transformim të shpejtë të strukturave ekonomike të Vëndit, veçanërisht

ishtë nëse me transportet në largësi do të përdoreheshin gjatë zonave bregdetare, në afërsi t'atyre porteve që më mirë mund të shërbejnë për impiantet të karakterit industrial. Popullsia e pakët, e shpërndarë në zonat e lartpërmendura, do të mirëpriste të bënte pjesë në Shtetin shqiptar edhe se e kombësisë të ndryshme si bullgare, shqiptare apo rumune." Siç shihet, një bashkëndodhje (koindicence) e lumtur interesash do t'i lejojte Italisë, që duke mbrojtur pavarësinë dhe integritetin shqiptar, të bënte mbrojtjen më të mirë të politikës së saj ; mirësisë e çështjes shqiptare, e bazuar mbi arsye të padiskutueshme drejtësie dhe bazash kombëtare të pakundërshtueshme, do t'i jepte Italisë mjetin për t'a paraqitur çështjen në një fushë ideale që do t'ishte shumë e dobishme dhe tërheqëse. (Nga një përkutjesë e shkurtër përmbledhëse, e shkruar për përdorim të Dërgatës Italiane në Konferencën e Paqes në Paris nga i nderuari Françesko Faci, Komisari Civil Italian për Gjykostrënnë e Shqipërinë Jugore më 1917, dhe e kopjuar nga libri i G. A. Kolona di Cesaro me titull "Italia në Shqipërinë Jugore" (Faqe 68 - 73)

madhe të leksikut të Veriut. Nuk është gjuha standarde fjalori i vitit 1980, as plotësimet e tij të mëvonshme, sepse nuk është e mundur të paraqitet e gjithë pasuria e saj në një fjalor. Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, i quajtur "Fjalori i Kongresit" nga kundërshtuesit e standardit, pos fjalës të përbashkët të të dyja dialekteve, që është pjesa e kryesore e fjalorit, pjesa më e madhe absolute, ka përfshirë edhe mjaft njësi leksikore me përcaktuesin dialektizma të ngushta, që shpesh janë të burimit të huaj, turk, grek e sllav, e që i gjejmë në të dyja dialektet. Fjalori ka përfshirë gjerësisht materialet gjuhësore të gegërishtes nga vepra e Fishtës dhe nga veprat e autorëve të tjerë gegë, nga fjalori i Bashkimit e nga fjalorë të tjerë të arealit gegë. Një hetim më i hollë në këtë rrafsh e dëshmon fare mirë këtë pohim. Mund të shtrohet pyetja : a kanë mbetur jashtë këtij fjalori fjalë të gegërishtes? Natyrisht se kanë mbetur. Dhe kanë mbetur jo vetëm të gegërishtes, po edhe të toskërishtes, edhe të të folmeve të tjera të të gjithë arealit shqiptolës, deri edhe të atyre të arbëreshëve të Greqisë, të arbëreshëve të Italisë e të Zaris dhe më gjerë, sepse nuk ka qënë dhe nuk është e mundur as të përfshihen të gjitha dhe as të mblidhen të gjitha fjalët a shprehjet. Nuk është leksiku i gjuhës standarde tërësia e fjalëve të një fjalori sado i madh e përfshirës të jetë ai, sepse kjo është pamundur të realizohet. Edhe kriteret e përzgjedhjes gjithmonë mënjanojnë numër të caktuar të fjalëve, siç ka ndodhur edhe me fjalorët që kemi : u është dhënë përparësi fjalëve vendëse para fjalëve të huaja, fjalëve me shtrirje më të gjerë para atyre me përdorim shumë të rrudhur, neologjizmeve para huazimeve e kështu me radhë. Konsideroj se ky nuk është problemi që duhet të na shqetësojë. Ka problem të tjera që lidhen me leksikun e leksikografinë shqipe që mund të konsiderohen të ngutshme dhe jo lehtë të zgjidhshme

Në këtë përvjetor të Kongresit të Drejtshkrimit kur po organizohet Kjo Akademi gjerësisht e problematikes që mund të shtrohet e të diskutohet sot i kalon kufijtë e kësaj akademie shkencore. Kjo problematikë do të mund të përfshinte trajtimet që lidhen jo vetëm me aspektin e normës dhe të normës, të rregullave të drejtshkrimit, të rëndësisë dhe të kuptimit të këtij Kongresi për shqiptarët në perspektivën e sotme e të mëtejshme gjuhësore, për njohjen dhe zbatimin e rregullave të drejtshkrimit, por edhe trajtimet që lidhen posaçërisht me leksikun (tërsinë e fjalëve) dhe fjalëformimin e shqipes, me leksikografinë (teorinë dhe praktikën e hartimit të fjalorëve të tipave të ndryshëm) shqipe, me përfshirjen e leksikut popullor (dialektet e krahinor) me vlerë letrare potenciale në Fjalorët e gjuhës së sotme shqipe (1980) dhe në fjalorë të tjerë të shqipes a me shqipen, me pasurimin e mëtejshëm të leksikut të saj, me terminologjitë e shqipes, me sfidat në kontekstin e ri shoqëror-politik, me letërsinë artistike, me për prijet e reja zhvilluese në gjitha rrafshet e stilet e gjuhës, e kështu me radhë.

Mund të sjellim përfundim se gjuha standarde për këto afro 40 vjet ka dëshmuar se i përmbush mirë funksionet e një gjuhe të përbashkët mbarëkombëtare dhe ajo nuk mund të identifikohet me idiomën mbi bazën e së cilës është ndërtuar. Si e tillë ajo paraqet pasurinë e përbashkët gjuhësore, brenda së cilës janë mbrojtur forma, struktura, morfema, leksema, frazeologji e ndërtime të mbarë shqipes në vertikalen e horizontalen e saj. Dhe, në këtë pasuri kanë hien të gjithë shqiptarët, sepse ajo është krijuar përgjatë historisë së tyre të përbashkët dhe në proceset e sotme të zhvillimit të tyre dinamik në të gjitha fushat e jetës. Ajo është pasuruar dhe po pasurohet edhe përmes lëvizjeve dhe komunikimit ndërshtetërisht shumë të dendur dhe shumë domethënës sot.

Pristinë, 7.12.2012

ART | PAMOR

ISMAIL QEMALI

I ELTION VALLES

Portreti që porositi familja Vlora

Astrit Cani

Artisti Eltjon Valle më fton me më tregue pikturën e tij të fundit. Vizitojmë apartamentin tij, në skaj të lagjes 'Isola' të Milanos, ku muret janë të mbuluar nga kuadrot e tij me format të madh, në tonalitete të errëta, shpesh monokromatike. Këtu lart mbërrijnë veprat të cilat autori i ndjen më afër, ato që meritojnë të rrinë veç, larg angarisë së ateljesë. Herën e fundit që kam parë një seri prej tij, ishte një inventar i shkrimtarëve të mallkuar të shekullit XX, ku secili mund të njihet shkrimtarin e vet. E vetmja gjë që ka mbetur e pranishme edhe sot, nga ajo 'recherche' e dikurshme, është përdorimi i naftës në telajot e tij, me bazë bojrash vaji. Hedhja e bazës ose 'grunti' bëhet gjithmonë me bojra klasike. Më vonë vjen retushimi me olio di pietra ose petrolio. Elementi naftë për Valen, është një mënyrë me sondue femininë e vet, në jugun industrial. Dhe femënia është obsesioni i çdo artisti. Duke ia shtuar naftën, piktura e tij refuzon me qenë e bukur tout court. Ajo të imponohet me mënyra të tjera. Sikundër në mënyrë magjike një femini mund të jetë fatlume, pa qenë e bukur. Piktura e tij të imponohet në radhë të parë me dimensionin e saj urban, pa asgjë nuk i lihet rastit. Valle e vazhdon kërkimin e tij në të gjitha përthyerjet e postmodernizmit, duke kërkuar udhën e tij në peisazhin apokaliptik. Megjithatë herë pas here, ai ndjen nevojën t'i kthehet akademisë.

Këtë radhë ka marrë përsipër një subjekt pa të dytë, personalitetin më në zë dhe më të padiskutueshëm, flamurtarin e Rilindjes sonë, Ismail Qemalin. Larg zhurmës institucionale, larg fetishizimit mediatic, ka qenë vetë familja Vlora që e ka porositur këtë portret, e pakënaqur nga përshfaqjet e deritanishme të kësaj figure sa të nderuar aq edhe të shfrytëzuar. Nismëtar i projektit shprehjet i kënaqur me rezultatin, dhe uron ta shohë në qarkullim sa më shumë, deri sa kjo e përshfaqje të tjera si kjo t'ia zënë vendin atyre të realizmit socialist. Për filatelistët urojme ta kemi edhe në ndonjë seri pullash. Ka ende shumë punë me arritë tek ndryshimi i perceptimit edhe për këtë ikonë kombëtare.

Shumica e shqiptarëve e njohin atë nëpërmjet filmit, i cili, pavarësisht aktorit të pazëvendësueshëm që e luan, e rëndon gjithçka me një retorikë prapavepruese, që e prish vërtetësinë realiste të kohës dhe vendit, 'hic et nunc'-un aristotelian. Më shumë se gjithçka, na intereson me hetue pikëpikëje e përmasës njerëzore me përmasën historike të asaj bëmë. Nga libri i edituar e botuar prej Darling I. Vlora, përmendim një citat që na jep nga afër kalimin e vështirë drejt destinacionit që bëhet destin. Nga kujtimet e delegatit Dh. Zograf:

"...Vlora nga Durrësi nëpër det mban 5-6 orë, po nëpër tokë, në

dimër mban 4 ditë me kuaj të mirë. Ç'kemi parë dhe ç'kemi bërë në këtë udhë bëhet një roman më vete. Fushët e Muzeqesë, të mbytura me ujë, dukeshin si nonjë det pa anë dhe i kemi shkruar kaluar 5-6 orë më këmbë në ujë gjer mbi gju, asisoj dhe udhë të gjata me baltëra të thella që mezi nxirrte këmbën kali. Për tu vënë re ish guximi, kurajua, fytyra e ëmël dhe e pandryshueshme e plakut Ismail Qemali, i cili shkonte gjithnjë përpara. Një njeri i pamësuar në ato vise, jo plak si Ismail Qemali, po shumë më i ri, sikur në flori ta veshësh, s'ta bën atë udhëtim. Po patriotizmi dhe gazi i punës së shenjtë që kish nisur, e mbushte me kura-jo që të marrë atë udhë të gjatë. Duke parë guximin e plakut të shtrenjtë, na forcohej edhe neve zemra që të kapërcejmë gjithë ato rreziqe, të cilat kur i kujtojmë sot na zë tmerr. Ç'ka bërë Ismail Qemali sot për Shqipërinë, ç'nder i do bërë dhe ku duhet ngritur emri i tij, atë mund ta gjykojë vetëm ai njeri që di dhe pa veprat e tij..."

...Poezia e fortë e realitetit. Shprehja "gazi i punës së shenjtë" flet për atë nivel realiteti ku aksioni bëhet poezi. Një poezi që duhet vazhduar. Ismail beu ka qenë kapiteni i parë i kësaj anijeje që quhet Albania. Të na falni që po i përmendim emrin ndërkombëtar, por i shkon anijeve një i tillë. Ai që i pari që vërtetoi se kjo anije e vogël lundron, dhe i siguroi asaj njohjen dhe përnjohjen ndërkombëtare. Ka pasur kohë kur një pjesë e vetë shqiptarëve e kanë sekuestruar këtë anije, dhe mu si Robinson Crusoe pas anijembytes e kanë plaçkitur atë, anijen e vet. Dritëshkurtëve kjo i është dukur racionale, thuase mund të çohet në shpi atdheu copa-copa. Por është e kundërta, duhet të vendoset shtëpia në një atdhe, atëherë begatohet shtëpia e atdheu bashkë. Robinsoni e plaçkit anijen e vet, pasi ajo nuk lundron më, e nuk mund ta shpëtojë dot, i duhet thyeshit për mbijetesë. Por anija jonë Albania do lundojë sot e mot e do ketë prapë kapitenë si Ismail beu. Piratët qysh sot kanë fillur të kthehen në papagaj.

Me cinizëm prej kritiku, them se arsyeja përse Valle e ka qarë portretin e Ismail Qemalit, vjen prej distancës nga historia dhe kompleksiteti i saj. Dora e tij lëviz me ritmin



Ismail Qemali tablo e Eltjon Valles

e emocionit, pa ngërçin e ideologjisë. Sikundër ka aktorë që e qajnë tekstin pikërisht sepse nuk e kuptojnë atë, dhe vetëm kështu ata bëhen vetë teksti. Por Valle e ka ndërjet subjektin e vet, s'e ka duruar dot gjatë, e ka rrokur me penelata të shkathëta, ku gjithsesi ndihet një emocion që ka lidhje me sekretet e gjakut të të parëve. Dhe kështu kemi një portret të formatit mesatar (100 me 70), të punuar mbi një fotografi të përsosur të vitit 1910, prej arkivit të familjes. Kuptohet, që shtimi i imazhit në pikturë, i jep atij shumë më tepër jetë, ngasa do t'i jepte një zmadhimi i thyeshit e resmes origjinale.

Mbi mur, prapa një gramafoni kinse butaforik, fytyra e plakut të urtë duket sikur buzëqesh dhe na jep bekimin, a thua se mirësia e tij na shenket edhe mirësia jonë, sikur po na dhuron pak nga ai dinjitet duke e ngjallur atë brenda nesh, ku ka qenë i topitur për shumë kohë.

I thirrur gati para përgjegjësisë,

për të realizuar portretin Valles i duhet të shfrytëzojë gjithçka që i ka marrë shkollës shqiptare dhe akademisë italiane që ka frekuentuar në vitet e vështira të formimit të tij. Për gruntin dhe flamurin, ai kërkon të kuqen, por nuk mjaftohet patriotikisht me atë të Onufrit, kërkon Tintoretton, mjeshttrin e kahershëm. Mosnjohja e historisë nga ana e piktorit, i jep kësaj pikturë një pafajsi të rrallë dhe e çliron nga çdo akademiçizëm e njëherësh nga çdo ideologji. Valle pikturon njeriun prej mishi dhe ashti dhe gestin e tij.

Nuk është këtu vendi të flasim për modernitetin dhe tagrin shumëpërmasor të figurës së Ismail Qemalit. Si individ, pavarësi-bërësi jonë ka edhe një tregues tjetër shumë të rëndësishëm, se është ndër shqiptarët me zhvillimin më të mirë psiko-fizik të kohës. Na duket i dorës së parë fakti se ai ishte një figurë që po të mos kishte bërë Shqipërinë do të kishte punuar për Turqinë mod-

erne, e mbase kontributi i tij direkt do t'i ishte shpërblyer familjes së tij aty. Por sikur ai të kishte zgjedhur të bënte për Turqinë, familja e tij sot do të ishte mbase më e kamur, më e madhe dhe më e respektuar, por nuk do të ishte më shqiptare. 'Amor fati' e deshi për të dhe për ne që pas lavdisë të vinte kupa e hidhur. Një poet amerikan ka thënë: find what you love and let it kill you.

Na frymëzon matura, drejtpeshimi dhe personaliteti i shëndetshëm i Ismail beut (për anglishtdashësit: lord Qemali). Ai nuk anon kurrkah. Kudo ku shkon është shqiptar, nuk është as lindor as perëndimor. Njerëz si ai europianizuan edhe Turqinë. Po të ishim si ai nuk do t'imitonim, nuk do ta bënim me anue anijen tonë, duke vrapuar herë kah perëndimi herë kah lindja. Kështu do t'ishim as lindorë as perëndimorë, pra edhe lindorë edhe perëndimorë. E në këto kohëra të globalizimit ne do t'ishim mediatorë të shkëlqyer të këtyre dy Botëve, që janë e njejtja botë. Pra në vend që të ishin perëndimi dhe lindja dy gurët e mokrës që na grijnë qëmoti, do të ishin dy burimet tona që na furnizojnë padë me energji sociale. Do të ishte e vetmja mënyrë për mos e e fetishizue veten, siç kemi fetishizuar të gjitha ikonat tona.

Portreti e ka vazhduar rrugëtimin e tij. Janë bërë shumëfishime të sh-tytura dhe është shpërndarë edhe elektronikisht. Diaspora e shqiptarëve të Kosovës e ka pritur Dardëlingun dhe nderuar atë me qytetari nderi. Kuptohet që për stërnipin e Ismailit, ky është një vlerësim frymëzues. Ne shqiptarët e simbas-Londrës nuk e harrojmë amë, se ishte stërgjyshi i tij që na e dha qytetarinë bashkë me nderin. Nuk do të lejojmë e as nuk do të ndodhë që piratët të na i marrin të dyja.

Sot ky portret është pjesë e koleksionit privat të zotit Renato Skënderi. Me prani të kahershme në atdheun e pikturës, ai i ndih me sa mundet artit të ri shqiptar...Të gjitha formimet janë të tepërta dhe e lëmë portretin të flasë.

Na intereson ta ndjekim udhëtimin e portretit. Jemi shumë kureshtarë të shohim si do festohet në familjen Vlora 100 vjetori. Si një Vit-i-Ri Shekull-i-Ri?...

Pavarësisht është një realitet që duhet vazhduar pa ia prishur poezinë.



Masakra

Lajmi

Një 9-vjeçarë shqiptare nga Kosova është në mesin e nxënësve që i mbijetuan masakrës me armë të premtën në një shkollë fillore në Konektikat, SHBA. Vanesa dhe i vëllai, Mërgim Bajraliu tregojnë si e përjetuan masakrën.

NEWTOWN

Amerika është nën shock pasi mëngjesin e 14 dhjetorit një djalë vrau mamanë e tij në shtëpi dhe më pas qëlloi mbi 20 fëmijë dhe 6 të rritur në një shkollë fillore në shtetin e Konektikatit, 80 km në verilindje të New Yorkut, më pas vrau veten. Vanesa Baraliu, shqiptare nga Kosova ishte ndodhur në ato momente në shkollën "Sandy Hook" ku ndodhi masakra, por fatmirësisht ka arritur të shpëtojë. Në masakër mbetën të vdekur 28 persona, përfshi dhe autorin i cili i vetëvra. Personi i maskuar, i cili më pas u identifikua si Adam Lanza, 20 vjeç me një jelek antiplumb dhe mbante dy pistoletë, vrau veten pasi kreu masakrën në shkollë.

Masakra në Newtown, të Konektikatit, është masakra e katërt në 5 muaj që kanë tronditur SHBA-në dhe nxënësit e shkollës fillore publike, "Sandy Hook School", ku studionin fëmijë të moshës 5-10 vjeç, janë viktimat me moshë më të vogël.

RRËFIMI I VANESËS

Në shkollën "Sandy Hook School" ku ndodhi masakra ka qenë edhe një vajzë 9-vjeçare shqiptare e Kosovës e cila i ka shpëtuar masakrës. Mërgim Bajraliu 17 vjeç në profilin e tij në facebook tregonte se kishte qenë në shtëpi kur dëgjoi krismat dhe më pas shkoi në shkollë me mamanë e tij. Bajraliu tha se motra e tij Vanesa Bajraliu 9 vjeç nuk është lënduar dhe tani gjendet në shtëpi. "Isha në leksionin e artit, dëgjua rreth 20 të shtëna, mësuesja na mbylli derën. Pastaj shkuam në zyrën e saj dhe kërkoj që të njoftohet policia. Dëgjoni më të shtëna, dhe të bërtitura. Pashë një polic shumë policë në korridorin e shkollës me armë. Na morën dhe na nxorën përjashta. Na thanë të mbanin njëri tjetrin për dore dhe të mbyllim sytë. I hapëm vetëm kur ishim jashtë. Isha e frikësuar, të gjithë dridheshim." - dëshmoi Vanesa për mediat amerikane.

VËLLAI I VANESËS


Mërgim Bajraliu, 17-vjeçari shqiptar tregon momentet sesi kishte vrapuar drejt shkollës ku mësonte dhe motra e tij 9 vjeçare. "Dëgjua të shtëna, sirena dhe bashkë me nënën time vrapua drejt shkollës për të parë se çfarë po ndodhte. Kur mbërritëm 3 fëmijë dolën nga shkolla. Njëri prej tyre kishte fytyrën me gjak. Ata

VANESA "Isha në leksionin e artit, dëgjua rreth 20 të shtëna, mësuesja na mbylli derën. Pastaj shkuam në zyrën e saj dhe kërkoj që të njoftohet policia.

MËRGIMI "Dëgjua të shtëna, sirena dhe bashkë me nënën time vrapua drejt shkollës për të parë se çfarë po ndodhte

9-vjeçarja shqiptare: 'Na nxorën policët symbyllur'

I vëllai Mërgim Bajraliu tregon momentet pas masakrës



Në foto: (Majtas) Vanesa Baraliu, shqiptare nga Kosova që ndodhej në shkollën ku ndodhi masakra (djathtas) Vrasësi Adam Lanza



ishin shumë të zbehtë dhe të tmerruar. Ishte shumë tragjike. Unë me mami filluam të qanim" - tha Mërgim Bajraliu në një dëshmi dhënë një televizioni amerikan.

ARMËT E KRIMIT

Autoritetet amerikanë thanë se kanë gjetur armë të tjera zjarri, gjatë kohës që ushtronin kontroll në shkollë fillore, kur dje mbetën të vrarë 27 persona. Në shkollë janë gjetur edhe 3 armë, ndërkohë që më parë ishin gjetur dhe një pistoletë Glock, një Sig Sauer dhe një armë të kalibrit 223 në makinën që kishte përdorur vrasësi.

MËSUESËT E VRARË

Tre mësuese u vranë në shkollën fillore të Sandy Hook, duke u përpjekur të shpëtonin fëmijët nga vrasësi i cili ishte dhe djali i një prej kolegeve të tyre, mësuese në kopësht. Autoritetet kanë identifikuar tre nga 8 të rriturit që mbetën të vdekur të premtën, Dawn Hochsprung, drejtoreshen e shkollës, 47 vjeçe, psikologjen e shkollës Mary Sherlach, 56 vjeçe

dhe 27 vjeçaren, Victoria Soto, mësuese. Dailymail tregon se Soto sakrifiko veten e saj duke u vendosur përballë fëmijëve, për t'i mbrojtur nga plumbat.

VIZITA PARA MASAKRËS

Sipas disa raportimeve, Adam Lanza, që kreu masakrën mbi një shkollë fillore në SHBA, e kishte vizituar këtë shkollë një ditë përpara masakrës të së premtës.

Ai ishte grindur të enjten me katër pjesëtarë të stafit të shkollës, tre prej të cilave tani kanë vdekur.

Një mësuese e katërt, që ka mbijetuar, nuk ishte dhe në shkollë. Ajo është marrë në pyetje nga hetuesit. Akoma nuk dihet se përse ata u zunë me djalosin, por hetuesit thonë se dëshmia e mësueses do jetë një copëz e rëndësishme informacioni për hetimet. Autoritetet policore kanë konfirmuar se Lanza ka hyrë me forcë në shkollë ditën e premtë. Mësohet se ai e ka vrarë drejtoreshën në momentin kur ajo po lajmëronte nxënësit në interkom. Më përpara ai kishte vrarë edhe mamanë e tij, Nancy Lanza.

Kjo e fundit e kishte marrë djalosin e saj më përpara në një poligon dhe e kishte mësuar se si të qëllonte me armë zjarri përpara se ai t'ia kthente asaj armën duke e ekzekutuar bashkë me dy duzina fëmijësh. 52 vjeçarja Nancy Lanza ishte një koleksioniste armësh dhe kishte blerë pesë armë, të gjitha të regjistruara në Konektikat.

Pronari i një firme armësh tha se ajo e çonte djalosin në poligon dhe ishte shumë krenare për armët e saj. "Ajo i dashuronte armët," tha ai për Reuters. Djali i saj e qëlloi me armë në fytyrë. Ai ishte autik dhe vuante nga sindroma Asperger, që e bënte atë të pandjeshëm. Ai ishte një tip i izoluar dhe nuk kishte miqësi. Të afërmit thonë se e kishte vuajtur shumë divorcin e mamasë së saj.

Presioni mbi presidentin Barack Obama për të marrë një vendim për kontrollin e armëve po rritet. Dy muaj më parë vetë Obama bëri të ditur se ka ndërmend që të mbajë armët larg duarve të personave me probleme mendore.

FAKTET E MASAKRËS

■ **VIKTIMAT** - 28 të vdekur, përfshi dhe autorin, Adam Lanza, nëna e tij Nancy Lanza, drejtoresha e shkollës Daen Hochsprung dhe 20 fëmijë të moshës 5-10 vjeç identiteti i të cilit ende nuk është bërë i ditur.

■ **I DYSHUARI** - 20 vjeçari Adam Lanza, një student me rezultate të larta. Një zyrtar policie tha se ai mund të ketë pasur orregullime të personalitetit. Ai u rrit në një lagje të pasur ku jetonin njerëz me pozita të larta në punë. Për momentin nuk është hedhur asnjë dritë mbi motivet e vrasjes.

■ **SKENA** - Policët u thanë fëmijëve të mbyllin sytë teksa kalonin pranë kasaphanës që ishte shkakuar në klasat e tyre, sistemi intercom ka regjistruar të gjithë ulërimat në të gjithë shkollën, të shtënat dhe, ata që binin në tokë, si zhurma e një kanaceje që bie. Fëmijë duke qarë janë nxjerrë nga shkolla në rresht duke u mbajtur dorë për dore ndërsa prindërit në panic vraponin drejt shkollës për të gjetur fëmijët e tyre. Dëshmitarët thanë se vrasësi nuk tha asgjë

■ **KU VDIQEN** - Shumë prej viktimave u gjetën në dy klasa. Ndërsa nëna e Adam, Nancy Lanza u gjet e vdekur në shtëpi. Fëmijët ishin të moshës 5-10 vjeç

■ **ARMET** - Dy pistoletë, një e tipit Glock dhe tjetra e tipit Sig Sauer u gjetën brenda në shkollë. Ndërsa një gjysmë automatik e kalibrit A. 223 u gjet prapa makinës me të cilën Lanza hyri në shkollë. Mamaja e Lanzas kishte 4 armë të regjistruara, ndërsa babai i tij 2. Janë gjetur dhe dy pushkë të tjera por nuk sqarohet se ku.

■ **FAMILJA** - Nancy, mamaja e Adam njihej si një prind i kujdesshëm. Ajo u divorcua nga Peter Lanza, një nëndrejtor i zyrës së takses dhe jetonte në Stamford. I vëllai i Lanzas, Ryan 24 vjeç punonte në Manhattan dhe është marrë në pyetje nga policia pranë shtëpisë së tij në New Jersey, por nuk është i dyshuar. Fillimisht policia e identifikoi atë si autor i vrasjes por më pas dyshimet ranë.

■ **QYTETI** - Neëton, qyteti 300 vjeçar është një kartolinë për Neë England, dhe krenohet për garën në lumenjtë të Klubit të Luanëve dhe për shpëtimin e rosakëve prej gome për bamirësi, dhe është shtëpia e pemëve të Krishtlindjeve. Komedia "Adam's Rib" Spencer Tracy-Katharine Hepburn u filmua në këtë qytet.

■ **HISTORI** - Masakra është e treta në historinë amerikanë dhe një prej më të rëndave në botë. Në 2007 një burrë vrau 33 personan në Universitetin Teknologjik të Virxhinias, më pas vrau veten. Masakra më e rëndë në këto 20 vjet që tronditi botën ishte ajo e Norvegjisë në 2011 ku mbetën të vrarë 77 persona.



Homazhe në shkollën "Sandy Hook"

Viktima

Të shtëna tragjike edhe në Nevada e Alabama

Autoritetet e rendit kanë bërë të ditur edhe për dy seri të shtënash publike në Shtetet e Bashkuara, prej 20-vjeçari, Adam Lanza, vrau të premtën 27 persona në një shkollë fillore në Konektikat. Në Las Vegas të Nevadas, po ashtu të premtën, një burrë ka qëlluar për vdekje një grua në hyrje të një hoteli, duke bërë që klientët të largohen të terrorizuar. Personi i armatosur më pas ka qëlluar veten dhe ka vdekur. Ndërkaq, dje në mëngjes, në Birmingham të Alabamas, një person i armatosur ka plagosur dy anëtarë të personelit në një spital, si dhe zyrtarin e policisë, i cili u është përgjigjur thirrjeve për ndihmë. Një polic tjetër thuhet se ka qëlluar sulmuesin e dyshuar dhe e ka vrarë.

Koment

Shqipëria, BE dhe 23 qershori



NGA AFRIM KRASNIQI

vijon nga faqja 1

... përgjegjëse është qeveria. Do të rrëzojmë murin e izolimit, sic rrëzuam atë të korrupsionit, tha ajo. PS gjithashtu e kishte gati fjalimin: përgjegjëse është qeveria. Do ta rrëzojmë atë që të rrëzojmë pengesën e integritetit, tha ajo. Dy palët shpallën bindjen se me 23 qershor shqiptarët do të ndërrshkojnë palën tjetër dhe se pas asaj dite Shqipëria nis bisedimet për statutin kandidat në BE. Si përherë në tranzicion, si në çdo krizë apo dështim tjetër politik, dhe me mbyllje si në një përrallë fëmijësh, PD dhe PS humbën përsëri shansin tonë të integritetit, iu rikthyen politikave paralele dhe interes electoral dhe kështu, dëshmuar se dallimet midis tyre janë minimale kur bëhet fjalë për vizionin e tyre për interes qytetare, shoqërisë dhe ato shtetërore.

Kur flitet për përgjegjësi natyrisht PD dhe qeveria ka peshën kryesore. Ato janë votuar të qeverisin, dhe jo të të përdorin gjithmonë alibinë e votës së opozitës për dështimet e tyre. Një forcë e përgjegjeshme thotë: nuk i kam votat, - kërkon bashkëpunim ose u drejtohet qytetarëve për një mandat të plotë drejtimi. PD nuk e bën as njërin dhe as tjetrin. Sepse nuk do bashkëpunim dhe sepse e di se vota qytetare është dukshëm kundër. Ato nuk kanë një platformë të qartë reformash, nuk kanë vullnet politik, nuk kanë liri veprimi midis tyre, nuk kanë vision dhe kështu, nuk kanë qëllim as interes të sillen ndryshe. Janë në pushtet dhe duan të qëndrojnë në pushtet. Me çdo kusht. Edhe pa qeverisur, edhe pa mbajtur përgjegjësi, edhe duke ofruar si zgjidhje sundimin pa bezdinë e opozitës.

Nëse PD e donte integrimin mund ta ofronte falas Fierin, rregulloren e parlamentit dhe gjithçka tjetër teknike, por ajo nuk e bëri këtë, përkundrazi. Sepse për të mandati i Fierit është një mandat plus në zgjedhjet e ardhshme parlamentare, rregullorja e parlamentit është një avantazh në keqpërdorimin e kuvendit si institucion denigrimi dhe mitingu politik. PD dështoi në luftën antikorruksion, asnjë zyrtar nuk ndodhet në gjykim, ministra e politikanë të rangjeve të larta u amnistuan ose u cilësuan "për procedurë" të pafajshëm, raportet ndërkombëtare e krahasuan qeverisjen e sotme njësoj të korruptuar si ajo e Nanos më 2004-2005, kur PD organizonte mitingje massive në sheshin "Skënderbej" kundër "padronos" dhe për të rrëzuar murin e korrupsionit. Sot padrino I ri është kryeministër, padrino e vjetër është aleat i tij politik, kryeministri i ma-

fias është aleati I tij në qeveri dhe muri I korrupsionit është bërë dy herë më I lartë. Duke mos pasur situatë të mirë ekonomike, duke mos pasur një bilanc suksesi qeverisë, as rezultate në antikorruksion dhe as imazh pozitiv popullor, as aleatë të besueshëm dhe as vision për zgjidhjen e problematikave të vendit, as energji positive dhe as fuqi të reformohet dhe të ndryshë, PD dhe kryeministri e dinë se nuk kanë kartë tjetër elektorale përveç ikjes nga këto analiza dhe fokusimin tek oratoria ideologjike e populiste e armikut në prag, e bllokimit të ëndrrës evropiane, e opozitës së bllokut dhe e pucistëve që duan kokën e doktorit. Tipike shqiptare, ballkanike, komuniste dhe mesjetare, por tipike edhe për formimin dhe vizionin personal të kryeministrit, një simbol i mentalitetit populist e komunist në politikë.

E njëjta logjikë vlen edhe për opozitën. Ajo heshti për Gerdecin për interes të ftesës në NATO, por kur pa se qeveria përdori flamurin e NATO-s për të vjedhur vota në zonat rurale dhe për të vrarë katër qytetarë të pafajshëm në mes të bulevardit, vendosi të refuzojë lëshimet për në BE. Fieri ka rëndësi por nuk është dhe nuk mund të jetë faktor dhe as kusht dominant. Shumë më dominant do të ishte psh, kërkesa që politika të akuzuar për korrupsion të dilnin përpara drejtësisë, që të mos kishte konsensus dypalësh në amnistimin e autorëve të tragjedisë së Gërdecit, që të kemi rotacione cilësore në institucionet kushtetuese, që sistemi i drejtësisë të mos shndërrohet në seksion partie të Laprakës, që Shqipëria të kishte një president konsensual, etj, gjë që nuk ndodhi. Ajo e kaloi me një drekë vere

skandalin financiar të ministrave dhe drejtuesve të mazhorancës, mori pjesë në procesin e betimit presidencial, miratoi në heshtje Kodin Zgjedhor ndërrshkues për partitë e reja (të djathta) dhe favorizues për pushtetin, dhe një ditë të bukur vjeshtë u kujtua se në Fier qënka blerë e trafikuar vota e disa këshilltarëve.

Sicc ndodh gjithmonë, asnjë person përgjegjës politik nuk tha të vertetën e plotë, nuk pranoi përgjegjësi, nuk pati akte dorëheqjeje dhe as pendimi, thjesht retorikë denigruese ndaj tjetrit dhe gjetje e alibive të radhës, për dështimin e radhës. Një dhuratë e pamerituar e politikës së vjetër për qytetarët sh-

qiptarë në 100 vjetorin e shtetit dhe në prag të festive të fundvitit. Një humbje tjetër shansi për Shqipërinë, një imazh tjetër negativ për forcën reaguese të shoqërisë shqiptare dhe një investim tjetër minues ndaj themeleve të shtetit dhe interesave të vendit. Në vend të interesave afatgjata kombëtare dhe të integritetit PD dhe PS zgjedhën interes afatshkurta elektorale. Ata refuzuan BE për një mandat militant në shumë në Fier apo Kukës, duke e zhvendosur debatin politik nga çështjet e mëdha qytetare tek përplasjet pa sens, denigruese, personale dhe thellësisht populiste. Për ata nuk ka rëndësi çfarë duan shqiptarët, cili është interesi madhor, çfarë e bash-

kon Shqipërinë me Evropën, sa ka e vijon të ketë rëndësi karriera personale e Berishës dhe Ramës, një mandat më shumë në qershor 2013, një aleat pazari si LSI që vetshpallet në ankand që tani, pa ofruar asgjë tjetër përveç votave të trafikuar të pushtetit.

Ky model i vjetër dështimesh, alibish, manipulativ dhe izolues, kjo politikë dhe këto sjellje parademokratike, pa zivion dhe përgjegjësi, edhe njëherë bënë që Shqipëria të refuzohet, me të drejtë, nga BE. Ata kërcënojnë njëri tjetrin me votën e 23 qershorit. Qytetarët janë në heshtje, të dënuarit e mëdhenj, pa zë dhe pa forcë përfqësimit, jashtë BE dhe të sunduar e trajtuar si kavië mitingjesh nga individë e parti që nuk kanë pasur dhe as kanë asgjë humane dhe evropiane në identitetin dhe sjelljen e tyre politike. Koha është që ata të mendojnë, të reflektojnë, të flasin, të votojnë dhe të dëgohen. Jo nëpër mitingje, por në institucione, dhe mbi të gjitha përmes votës së fshehtë. Pushteti i votës është pushteti më i madh, dhe kur ajo grabitet nuk përbën më lajm grabitja edhe e pronës, vendeve të punës, pasurisë publike, të drejtave qytetare dhe aspiratave integruese. Ndaj duhet kthyer pushteti i votës që të kthehen të gjitha; prona, qeverisja e mirë, administrate publike, pasuritë publike, të drejtat qytetare dhe të jetësohet edhe integrimi real në BE. Ndaj 23 qershor duhet të ndërrshkojë, jo një palë më shumë përgjegjëse, por çdo palë përgjegjëse, çdo politikan përgjegjës dhe çdo sigël abuzuese partiake që ka fyder dhe tashme tenton të privatizojë ardhmerinë e vendit dhe qytetarëve të braktisur evropian të Shqipërisë.

23 qershori është larg dhe afër, dhe në çdo rast është e duhet të jetë një ditë me pritshmëri të mëdha: - për dhënie fund të modeleve të keqeverisjes përmes votave të vjedhura; për dhënie fund të praktikave të politikës konfliktuale, bllokuese, denigruese dhe penalizuese për vendin; për ndërrshkimin me votë të sundimtarëve mesjetarë që për interesa të tyre e lanë Shqipërinë jashtë dyerve të BE-së; për kthimin e institucionit të votës, të rotacionit të elitave dhe të elitave në vendimarrje, për një model të ri qeverisjeve në funksion të qytetarit dhe shtetit. Një pretendim utopik? Jo aspak. Me votë janë rrëzuar regjimet komuniste e diktatoriale, ndaj me votë mund të rrëzohen edhe regjimet autoritariste dhe të korruptuara. Thjesht, kjo kërkon qytetarë të lirë, me respekt për veten dhe me kurajë civile, si dhe oferta alternative qytetare, që traditën e zgjedhjes së të keqes më të vogël e zëvendësojnë me atë të zgjedhjes së të mirës më të madhe. 2013 e ofron mundësinë të jetë dita e fundit e tranzicionit dhe e para ditë reale drejt BE-së, dhe me siguri, pas asaj date, dy prej tyre ose të tre së bashku (Berisha, Rama, Meta) do të duhet të kthehen nga pushtetarë sundues në qytetarë normale, jashtë politikës aktive ose pa pushtetin e diktimit të vendimarrjes në emër të qytetarëve, që asnjëherë nuk i përfllin.



[SHQIPTARJA.com]

NE VERSIONIN DIXHITAL

KURSENI!

Lexojeni gazetën në
iphone



në kompjuter

Në adresën: www.shqiptarja.com



ipad

SHKARKON FALAS
APPTË SHQIPTARJA.COM
NGA APPLE STORE

DUKE BLERË
ABONIMIN,
JU MUND
TË LEXONI
GAZETËN QË
NGA ORA 2:00
E MËNGJESIT,
DHE PAGUANI
MË PAK



KUPA E SHQIPERISE



Grupi B

Në "Niko Dovana" do të vendoset se kush do të vazhdojë luftën për në gjysmëfinale Teuta apo Flamurtari, pasi kanë humbur ndeshjen e parë. Kjo është prova e parë për trajnerin Gjoka. Ndërsa në Ballsh, cili do të fitojë midis Bylisit dhe Lacit do të kalojë në gjysmëfinale pas Skënderbeut.

Skënderbeu fiton, kalon në gjysmëfinale

Sot në Durrës, Teuta-Flamurtari

TIRANE

DYLBER BALLA

Lajmi

Ekipi i Skënderbeut ka kaluar në gjysmëfinale pas fitores përballë ekipit të Kukësit me rezultatin e thellë 4-2. Ndërsa Kastrioti është rikthyer në garë pas fitores me Shkumbinin, ndërsa sot Teuta dhe Flamurtari do të vendosin se kush do të vazhdojë luftën për më tej, humbja nuk lejohet. Bylisi dhe Laci janë pranë kalimit në gjysmëfinale.

Skënderbeu është i papërmbyajtshëm, nuk di të ndalet as në Kupën e Shqipërisë duke fituar me rezultatin e thellë me verilindorët e Kukësit 4-1. Në raundin e dytë të çerekfinaleve, "Ujqërit e Dëborës" treguan brenda pak ditësh edhe njëherë supermacinë e tyre përballë ekipit të trajnerit Cungu. Terreni në të cilin u zhvillua ndeshja kryesore e grupit A, ishte mjaft i vështirë si pasojë e reshjeve të dendur atë dëborës, që kishin zbardhur fushën. Por "Ujqërit e Dëborës" nuk i ndal as dëbora, pas 9' minutave lojë, sulmue-

si i talentuar Plaku jep një pasim me kokë për Arapin që godet fluturimthi duke zhbllokuar shifrat. Kukësi nuk pranon rezultatin dhe kërkon të reagojë duke sulmuar, gjë të cilën e bën shumë mirë në minutën e 27' duke barazuar shifrat e ndeshjes në 1-1 me Hoxhën. Gjithsesi gëzimi i veriorëve nuk zgjat shumë, pasi Pejic çon topin

në rrjetë vetëm 1 minutë më pas. Pjesa e dytë fillon aty ku përfundoi e para, pasi Pejic realizon golin e dytë personal dhe të tretin për Skënderbeun. Në fund ka vend edhe për një gol të Shkëmbit që të gjurmën e tij në këtë takim duke çuar në 4-1 rezultatin. Vetëm 10 minuta para përfundimit Popovic shënon golin e dytë për

Kukësin, që vlen vetëm për statistika. Në takimin tjetër të grupit A, rezultati është po i njëjtë pasi dhe Kastrioti triumfoi 4-2 përballë Shkumbinit. Golat për ekipin e Krujës u shënuan nga Gocaj, Tanushi, Karapici dhe Caca, kurse për Shkumbinin realizoi Magani dhe Gjata. Pas ndeshjeve të dyta të Kupës në grupin A, Skënderbeu udhëheq me 6 pikë duke kaluar automatikisht në gjysmëfinale, ndërsa Kukësi dhe Kastrioti do të vendosin në ndeshjet e treta se cili do të kalojë më tej. Sot do të luhen dy ndeshjet e grupit B, Bylisi-Laci dhe Teuta-Flamurtari. Në "Niko Dovana" do të vendoset se kush do të vazhdojë luftën për në gjysmëfinale Teuta apo Flamurtari, pasi kanë humbur ndeshjen e parë.

Premier Liga

United e City fitojnë, humbet Liverpooli

Manchester United ka fituar me rezultatin 3-1 ndaj Sunderlandit në "Old Trafford" duke mbajtur distancën prej gjashtë pikësh ndaj Manchester Cityt. Robin Van Persie realizoi pas 16 minutash pas asistit të Ashley Young, pas tri minutash Tom Cleverley dyfishoi shifrat. Në pjesën e dytë ishte Eayne Rooney që trefishon rezultatin në minutën e 59'. Golin e nderit për miqtë në minutën e 72-të e shënoi



Frazier Campbell. Kjo ishte fitorja e pestë radhazi për Manchester United, që ka 42 pikë në renditje. Manchester City ka fituar në transfertë 1-3 me Newcastle me golat e Agueros, Garcias dhe Tures, duke mbajtur hapin e United. Surprizë ka qenë humbja e Liverpoolit në shtëpi me rezultatin 1-3 me Astron Vilën. Ndërsa ndeshja midis ekipit të Çelsit dhe Southamptonit është shtyrë duke mos u zhvilluar.

La Liga

Sonte super ndeshja Barça-Atletiko



Presidenti i Realit të Madridit, Florentino Perez i ka dalë në mbrojtje trajnerit Jose Murinjo pas sulmeve të fundit. Bosi i madrilenëve në një komunikim me mediat me rastin e Krishtlindjeve ka deklaruar se "Ne kemi fatin që të kemi në gjirin tonë trajnerin më të mirë në botë. Murinjo është

duke punuar fort për arritjen e objektivave. Kam shumë besim te stafi që në fund të edicionit do të arrijë objektivat në kampionat, Champions League dhe Kupë. Murinjo kohët e fundit ka duruar shumë sulme në mënyrë të padrejtë, theksoj që gëzon mbështetjen time të plotë" përfundon Perez. Ndërkohë

që Spanja sonte do të shijojë një super ndeshje midis Barcelonës dhe Atletiko Madridit. Blaugranët janë në vendin e parë të shkëputur nga Atletiko, e cila kërkon të jetë surpriza e këtij edicioni. Shpresat e Atletikos së drejtuar nga Simeone janë të sulmuara me i kërkuar në Evropë aktualisht, Radamel Falcao.

Lazio-Inter

Klose thyen zikaltërit në Olimpiko

Ndeshja Lazio-Inter ka dhuruar shumë emocione në Olimpiko, në fund fati i ka buzëqeshur ekipit të Petkovici që fiton. 90' minutat kanë qenë të ekuilibruara me sulme dhe kundërsulme. Në pjesën e dytë të dy ekipet hidhen në sulum, Interi ka pasur disa mundësi të arta me Casanon dhe Militon, por portieri i Lazios ka bërë mrekullinë. 10' minuta nga fundi, lacialët befasojnë Interin me Klosen që shënon duke i dhuruar tre pikë të çmuara ekipit të tij, ndërsa Interi thyhet pas disa rezultateve pozitive.

HOROSKOPI

Dashi



Ata që janë në çift do e ngrejë në piedestal të dashurisë zemrën e tyre edhe pse të afërmit do kështojnë të bëjnë kujdes. Tregohuni më të arsyeshëm nëse nuk doni të lëndoheni.

Demi



Dielli do ndikojë së tepërmi tek jeta juaj në çift dhe do e ngrohë atë. Do e keni më të lehtë të komunikoni dhe të kuptoheni me njëri-tjetrin. Për beqarët pritet të ndodhë gjithkaka.

Binjakët



Kujdes! Mos ngatërroni profesionin me çështjet e zemrës gjatë kësaj dite nëse nuk doni të keni probleme. Nga ana tjetër mos kërkonit më shumë liri sesa duhet.

Gjorja



Kjo ditë do jetë e favorshme për zemrat e vetmuara sesa për ata në një lidhje. Ekzistenca juaj do ndryshojë njëherë e përgjithmonë. Çiftet do kalojnë një ditë të qetë dhe pa ndonjë problem.

Luani



Ju që jeni në një lidhje do keni disa kontradikta me partnerin tuaj sot dhe kjo do iu mërzojë pa masë. Mundohuni të mos e humbisni për asnjë moment dialogun.

Virgjëresha



Pas një periudhe jo shumë të mirë për jetën në çift, sot çdo gjë do ndryshojë pozitivisht. Bashkëpunimi do të përfortohej dhe do mendoni për një të ardhme së bashku.

Peshorja



Shtojni dozën e fantazisë sot në jetën tuaj në çift dhe do e shihni që çdo gjë do shkojë më së miri. Partneri do t'ua plotësojë dëshirat. Beqarët edhe pse nuk do kërkojnë me ngulim dashurinë.

Akrepi



Sektori i dashurisë do jetë i qetë dhe nuk do ndodhë asgjë e vecantë gjatë kësaj dite. Beqarët nga ana tjetër do takojnë një person për të cilin zemra do iu rrahë fort.

Shigjetari



Klima në çift do jetë mjaft pasionante dhe sensuale gjatë kësaj dite. Kënaqësia do jenë të mëdha sidomos në mbrëmje. Partneri do iu bëjë të ndiheni si mbi re.

Bricjapi



Ata që janë në një lidhje do fillojnë të bëjnë plane për të ardhmen. Mendohuni mirë për gjithçka para se të merrni vendime të rëndësishme. Beqarët do kryejnë një takim emocionues.

Ujori



Do luani sot me ndjenjat e dikujt që iu do sinqerisht dhe shpeshherë do tregoheni egoistë. Herë do jeni të kenaqur nga situata në të cilën ndodhni.

Peshqit



Edhe pse në disa momente komunikimi në çift do të zbehet, pritet që përgjithësisht dita të jetë e mirë. Do benit mirë të mos ua vini veshin atyre që do iu thonë të tjerët.

ASTROLOGE
MERI SHEHU
0900 673 4000

LAJME
NGA BOTA

■ **Clinton pëson "tronditje"**
Sekretarja amerikane e Shtetit, Hillary Clinton, e cila të hënën ka anuluar udhëtimin në Afrikën e Veriut dhe Gjirin Persik, për shkak të virusit në stomak, ka pësuar një "tronditje", pasi i ka rënë të fikët. Departamenti amerikan i Shtetit ka bërë të ditur se Clinton po shërohet në shtëpi dhe se është nën vëzhgimin e mjekëve. Ndihej i saj, Philippe Reines, ka thënë se Clinton ka qenë e dobët për shkak të virusit, kur i ka rënë të fikët. Mësohet se Clinton do të punojë nga shtëpia gjatë javës së ardhshme.

■ **Dhjetëra të arrestuar në Moskë e Shën Petersburg**
Policia në Moskë ka arrestuar dhjetëra protestues dhe disa liderë të opozitës, për të penguar tubimet masive jashtë selisë së Shërbimit Federal të Sigurisë. Bëhet e ditur se 40 persona janë arrestuar në kryeqytet, ndërsa 26 në Shën Petersburg. Liderët e opozitës, Sergei Udaltsov, Aleksei Navalny, Ilya Yashin dhe Ksenia Sobchak, kanë qenë në mesin e të arrestuarve. Ata më pas janë liruar pa ndonjë akuzë. Protestuesit, të mbledhur në temperatura të acarta, janë kapur sepse kanë mbajtur shirita të bardhë, kanë bartur shenja politike ose kanë brohoritur slogane kundër presidentit Vladimir Putin.

■ **Irani: Raketat "Patriot" kërcënojnë luftë botërore**
Shefi i ushtrisë së Iranit, gjenerali Hassan Firoozabadi, ka thënë se vendosja e raketave "Patriot" në kufirin Turqi-Siri mund të çojë në "luftë botërore", e cila "do ta përpinte Evropën". "Secila raketë 'Patriot' është një shenjë e zezë në hartën e botës, që ka për qëllim të shkaktojë luftë botërore", ka thënë Firoozabadi. Turqia i ka kërkuar NATO-s në muajin nëntor që të vendosë sistemin "Patriot" të mbrojtjes, të dizajnuar për të hedhur poshtë aeroplanët apo raketat.

■ **Mandela operohet nga guri në tëmth**
Ish-lideri i Afrikës së Jugut, Nelson Mandela, është operuar sot nga guri në tëmth, një javë pasi është shtruar në spital. Agjencitë lokale të lajmeve bëjnë të ditur se Mandela i është nënshtruar operacionit në mënyrë endoskopike. "Procedura ka kaluar me sukses dhe Mandela po shërohet", citojnë mediat deklarimet nga kabineti i presidentit të Afrikës së Jugut, Jakob Zuma.

■ **Egjipci voton në referendum për Kushtetutën**
Egjiptianët do të votojnë nëpërmjet një referendumi për draft-kushtetutën, e cila ka përcarë vendin dhe ka nxitur protesta të dhunshme. Kundërshtarët e saj thonë se është hartuar në mënyrë të dobët dhe në favor të islamikëve. Rreth 250 mijë personel i rojeve të sigurisë janë shpërndarë në vend gjatë këtyre votimeve, të cilat do të hapen në 08:00 me orën lokale (07:00), për pjesën e parë të referendumit me dy faza.

■ **Policia australiane: Hartat e Apple të rrezikshme për jetë**
Policia në qytetën australiane Mildura ka filluar t'ua tërheqë vërejtjen motoristëve që të mos mbështeten në hartat e iOS 6, sepse kjo mund të jetë e rrezikshme për jetët e tyre, duke iu bashkuar kështu kritikave të shumta në adresë të aplikacionit të Apple, i cili ka zëvendësuar hartat e Google në këtë iOS të ri.

KËTË FUNDVIT, HAPNI SYTË PËR BONUSET PORTOKALLI



Shumëfishim shpejtësie për të gjithë
abonentët e Abissnet pa ndryshim çmimi.

Dhe jo vetëm kaq!

Bëni abonim për 12 muaj, dhe përfitoni Bonusin e GEPARDIT*, 2 muaj plus!

Modem Wireless + Instalimi të përfshira në ofertë.

BËHET			përjetoni shpejtësinë
ishte			
2Mbps	x3	6Mbps	
4Mbps	x2	8Mbps	
8Mbps	x2	16Mbps	

abissnet
INTERNET SERVICE SOLUTIONS

*Bonusi i GEPARDIT si ofertë vlen për të gjithë abonentët e rinj dhe ata ekzistues që bëjnë abonim 1 vjeçar.

Oferta zgjat deri më 31 Dhjetor 2012.

• Alba Malltezi
Drejtores e Përgjithshme
e Free and Fair Media Group

• Anila Basha
Drejtores e Shqiptarja.com
• Arben Rozdhani
Kryeredaktor

Politika: Jakin Marena
Ekonomia: Gene Kondi
Kronika: Hajbon Hasani

Sociale: Esmeralda Keta
Kulturë: Admirina Peçi

Design: Altin Aliaj
Genti Manelli
Website: Suela Gera
Indrit Maraku

Departamenti i Marketingut:
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Shpërndarja:
Saimir Zenelaj
cel: +355696060418
Ermal Kacaniku
cel: +355696088847

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: A.K shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë